



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
Universiteti i Shkodrës "Luigj Gurakuqi"
SENATI

Nr. 4130/ prot.

Shkodër, më 19. 12. 2022

V E N D I M

Nr. 267 , datë 19 . 12 .2022

**"Për miratimin e raportit vjetor të veprimtarisë mësimore-shkencore dhe
financiare të USH-së për vitin akademik 2021-2022"**

Në mbështetje të Ligjit nr. 80/2015, dt 22.07.2015 "Për Arsimin e Lartë dhe Kërkimin Shkencor në Institucionet e Arsimit të Lartë në Republikën e Shqipërisë", neni 32 dhe 38; Statutit të USH-së neni 17, pika 6, gërma "II", Udhëzim Nr.5, datë 19.02.2018 "Për përcaktimin e elementeve përbërës të raportimit vjetor dhe afatit për raportim të IAL-ve", i ndryshuar, Senati Akademik dhe Bordi i Administrimit, në mbledhjen e përbashkët të datës 19.12.2022

Vendosi:

1. Të miratojë raportin vjetor të veprimtarisë mësimore-shkencore dhe administrative për vitin akademik 2021-2022 në Universitetin e Shkodrës, "Luigj Gurakuqi".
2. Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

KRYETARE E SENATIT
AKADEMIK

Prof. dr. ~~Suzana~~ GOLEMI



KRYTAR I BORDIT
TË ADMINISTRIMIT

Adrian LEKA



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
UNIVERSITETI I SHKODRËS "LUIGJ GURAKUQI"



Nr. 4130 Prot

Shkodër, më 19.12.2022

**RAPORTI VJETOR I VEPRIMTARISË MËSIMORE DHE
SHKENCORE PËR VITIN AKADEMIK 2021-2022 NË
UNIVERSITETIN E SHKODRËS "LUIGJ GURAKUQI"**



Analiza vjetore e procesit mësimor dhe kërkimor zhvillohet në kuadrin e realizimit të objektivave të Planit Strategjik dhe akreditimit të programeve të studimit të Universitetit të Shkodrës “Luigj Gurakuqi”. Pas analizës së punës mësimore dhe shkencore në departamente, mbështetur në dokumentacionin që është dorëzuar pranë Drejtorisë së Kurrikulave nga departamentet, qendrat kërkimore-shkencore të USH-së, po pasqyrojmë disa nga rezultatet kryesore të veprimtarisë mësimore dhe shkencore për vitin akademik 2021-2022.

Raporti synon të evidentojë drejtimet kryesore që përfshijnë veprimtarinë e organeve vendimmarrëse hapjen e programeve të reja dhe qëndrueshmërinë e programeve tashmë në zbatim, prurjet e reja dhe krijimin e kushteve të përshtatshme të mësimdhënies dhe mësimnxënies, përshtatshmërinë e rregulloreve të programeve të studimit me kërkesat gjithnjë në rritje të tregut të punës në rajonin e Shkodrës, ngarkesat mësimore dhe burimet e literaturës si dhe drejtimet kryesore të aktivitetit kërkimor dhe shkencor të stafit akademik të universitetit.

I-VEPRIMTARIA MËSIMORE

Analiza e veprimtarisë mësimore bazohet në udhëzimin Nr. 5, dt. 19.2.2018 “Për përcaktimin e elementeve përbërës të raportimit vjetor dhe afatet për raportimin të IAL-ve” dhe përqëndrohet në këto drejtime:

- 1. Objektivat e mësimdhënies për vitin akademik 2021-2022 në përputhje me misionin dhe strategjinë e zhvillimit të USH-së;**
- 2. Të dhëna mbi programet e studimit;**
- 3. Ndryshimet në rregulloret e programeve të studimit;**
- 4. Të dhëna për Njësinë e Sigurimit të Brendshëm të Cilësisë;**
- 5. Të dhëna mbi gjurmimin e studentëve që kanë përfunduar studimet. Alumni dhe këshillimi i karrierës;**
- 6. Përfaqësimi i studentëve në organet drejtuese të IAL-së dhe në Njësinë e Sigurimit të Brendshëm të Cilësisë ;**
- 7. Angazhimi i personelit akademik (staf akademik me kohë të plotë dhe me kohë të pjesshme);**
- 8. Infrastruktura në shërbim të mësimdhënies;**
- 9. Bashkëpunimet ndërinstucionale në nivel njësie bazë apo njësie kryesore si dhe projektet e zbatuara në funksion të përmirësimit të cilësisë së mësimdhënies në programet e studimit që mbulon njësia;**
- 10. Të dhëna mbi studentët;**
- 11. Pritshmëritë dhe objektivat (parashikimet) për vitin 2022-2023 në lidhje me mësimdhënien, kërkimin shkencor dhe inovacionin për secilën njësi;**
- 12. Analiza SWOT.**



1-OBJEKTIVAT E MËSIMDHËNIES PËR VITIN AKADEMIK 2021-2022 NË PËRPUTHJE ME MISIONIN DHE STRATEGJINË E ZHVILLIMIT TË USH

Edhe këtë vit akademik programet e studimit kanë qenë në përputhje të plotë me misionin dhe objektivat e Universitetit të Shkodrës.

Duke iu referuar raporteve të sjella nga fakultetet misioni dhe objektivat e tyre duke i përgjithësuar janë si më poshtë:

- Formimi profesional i studentëve në mësimdhënie e në profilet përkatëse që studiojnë;
- Formimi i aftësive krijuese dhe garantimi i cilësisë në mësimdhënie;
- Aftësimi i studentëve nga ana profesionale jo vetëm që të shërbejnë me dinjitet në pozicionin e tyre të punës, por edhe të kontribuojnë në zgjidhjen e situatave të ndryshme gjatë ushtrimit të profesionit;
- Përshtatja e planeve mësimore dhe e programeve të lëndëve me kërkesat e tregut të punës;
- Shfrytëzimi i infrastrukturës mësimore dhe përmirësimi i vazhdueshëm i saj, për të dhënë ndihmesë më të madhe në realizimin e procesit mësimor në përputhje me kërkesat që shtron stadi i ecjes së Arsimit të Lartë në sistemin e ekonomisë së tregut;
- Ngritja profesionale e stafit akademik pa të cilën nuk mund të arrihen të tjerat;
- Nxitja e kërkimit shkencor.

Realizimi i objektivave në të gjitha programet e studimit është reflektuar në përmirësimin e programeve ekzistuese të studimit duke synuar rritjen e tyre cilësore dhe sigurimin e vlefshmërisë në tregun e punës.

2-TË DHËNA MBI PROGRAMET E STUDIMIT

a- Programe ekzistuese

Gjatë vitit akademik 2021-2022 Universiteti i Shkodrës ka ofruar 63 programe studimi:

- Bachelor 28,
- Master i Shkencave 13,
- Master Profesional 18,
- Program i Integruar i ciklit të dytë Master i Shkencave 1,
- Programi studimi me karakter profesional 2,
- Cikli i tretë “Dokoratë” 1.



Tabelë nr 1. Programet e studimit për vitin 2021-2022

| Nr. | Fakulteti | Departamenti | Programi i studimit | VKA Hapje | Dokument Licensimi | ECTS |
|--|---|------------------------------|--------------------------------|--|--|----------|
| I. | Fakulteti i Shkencave të Edukimit 7-BA 3-MP 3-MSH | Psikologji - Punë Sociale | Bachelor në "Psikologji" | N/A | Shkresë MAS Nr. 4276 prot, datë 01.07.2004 | 180 ECTS |
| Bachelor në "Punë Sociale" | | | | VKM Nr.560, datë 12.08.2005 | 180 ECTS | |
| Master i Shkencave në Psikologji Klinike" | | | VKA Nr. 189, datë 24.06.2011 | UMASH Nr. 395, datë 10.08.2011 | 120 ECTS | |
| Master i Shkencave në Psikologji Organizative" | | | VKA Nr. 189, datë 24.06.2011 | UMASH Nr. 395, datë 10.08.2011 | 120 ECTS | |
| Master Profesional "Shërbimet Sociale" | | | | Urdhër nr. 334, datë 17.09.2021, nr. prot. 4993, datë 17.09.2021 | 60 ECTS | |
| Bachelor në për "Mësuesi Arsimin Fillor" | | | | VKM 167 , datë 28.05.1991 | 180 ECTS | |
| Bachelor në për "Mësuesi Arsimin Parashkollor" | | | VKM 332, datë 13.05.1996 | 180 ECTS | | |
| Master i Shkencave në "Mësuesi në Biologji-Kimi me Profil Minor në Karriera dhe Aftësimi për Jetën". | | | UMAS VKM 652, datë 14.09.2011 | 120 ECTS | | |
| Master Profesional në për "Mësuesi Arsimin Fillor" | | VKA Nr. 401, datë 26.10.2012 | UMASH Nr. 598, datë 07.12.2012 | 120 ECTS | | |
| Edukim Fizik dhe Sporte | | Bachelor në "Edukim Fizik" | N/A | Shkresë MASH Nr. 2742 prot., datë 27.04.2006 | 180 ECTS | |



| | | | | | | |
|--|-----------------------------------|--------------------------|--|------------------------------------|--|---------------------------------|
| | | | dhe Sporte” | | | |
| | | | Master Profesional në “Mësuesi në Edukim Fizik dhe Sporte” | N/A | VKM Nr. 1212, datë 11.12.2009 | 120 ECTS |
| | | Departamenti i Arteve | Bachelor në “Pikturë dhe Grafikë” | VKA Nr. 57, datë 29.06.2015 | UMASH Nr. 272, datë 20.07.2015 | 180 ECTS |
| | | | Bachelor në “Pedagogji Muzikore” | VKA Nr. 58, datë 29.06.2015 | UMAS Nr. 272, datë 20.07.2015 | 180 ECTS |
| | Fakulteti i Shkencave Natyrore | Infermierisë | Bachelor në “Infermieri Përgjithshme” | N/A | Shkrese MASH Nr. 784/1 prot, datë 05.06.2001 | 180 ECTS |
| | | | Bachelor në “Infermieri (Mami)” | N/A | Shkrese MASH Nr. 3955 prot, datë 01.06.2007 | 180 ECTS |
| | | | Bachelor në “Fizioterapi “ | N/A | Shkresë MASH Nr. 3954 prot, datë 01.06.2007 | 180 ECTS |
| | | | Master Profesional në “Psikologji Shëndeti” | VKA Nr. 376, datë 17.09.2012 | UMASH Nr. 503, datë 18.10.2012 | 60 ECTS |
| | | Biologji – Kimisë | Bachelor në “Biologji Kimi” | | VKM Nr.150 prot., datë 18.04.1957 | 180 ECTS |
| | | | Master Shkencor në “Biologji Mjedisore” | VKA Nr. 45, datë 27.10.2009 | VKM Nr. 1162, datë 25.11.2009 | 120 ECTS |
| | | | Master Profesional në “ Mësuesi në Biologji – Kimi” | N/A | VKM Nr. 1291, datë 24.09.2008 | 120 ECTS |
| | | Fizikës | Bachelor në “Fizikë” | N/A | Vendim Nr 4/1 i Ministrit, datë 15.01.1999 | 180 ECTS |
| | | | Master Profesional në “Mësuesi në Matematikë - Fizikë” | N/A | VKM Nr. 1291, datë 24.09.2008 | 120 ECTS |
| | | | Matematikës | Bachelor në | N/A | VMASH Nr. 4, datë 15.01.1999 |



| | | | | | | |
|--|---|-----------|---|------------------------------|--|----------|
| | | | “Matematikë” | | | ECTS |
| | | | Bachelor në “Informatikë” | N/A | Shkresë MASH Nr.2571/1 prot, datë 19.07.2002 | 180 ECTS |
| | | | Bachelor në “Informatikë” në gjuhën angleze | | Urdhër nr. 365, datë 01.07.2022 Nr. prot. 3321/3, datë 08.07.2022 | 180 ECTS |
| | | | Master Profesional në “Mësuesi në Informatikë me Profil Minor në Matematikë “ | VKA Nr. 107, datë 29.10.2010 | UMASH Nr. 506, datë 8.11.2010 | 120 ECTS |
| | | | Master Profesional në “Mësuesi në Matematikë me Profil Minor në Informatikë” | VKA Nr. 107, datë 29.10.2010 | UMASH Nr. 506, datë 08.11.2010 | 120 ECTS |
| | | | Programi studimi me karakter profesional “Teknik Sistemesh dhe Rrjetesh Kompjuterike” | | Shkresë MASR Nr. 2327/1 prot., datë 03.07.2020 Urdhër nr. 190, date 03.07.2020 | 120 ECTS |
| | Fakulteti i Shkencave Shoqërore | Gjuhësisë | Bachelor në “Gjuhë Letërsi” | | VKM Nr.150 prot., datë 18.04.1957 | 180 ECTS |
| | 5-BA 2-MP 3-MSH 1- program me karakter profesional 1-doktorature | Letërsisë | Bachelor në “Gazetari dhe Komunikim” | N/A | Shkresë MASH Nr. 2743 prot., datë 27.04.2006 | 180 ECTS |
| | | | Master Profesional në “Mësuesi në Gjuhë – Letërsi” | | VKM nr. 1291, datë 24.09.2008 | 120 ECTS |
| | | | Master Shkencave në “Studime Thelluara Gjuhësi” | N/A | VKM Nr. 619, datë 11.06.2009 | 120 ECTS |
| | | | Master Shkencave në | N/A | VKM Nr. 619, datë 11.06.2009 | 120 ECTS |



| | | | | | | |
|--|------------------------------|----------------|--|------------------------------|--|----------|
| | | | “Etnokultura dhe Letërsia Shqipe” | | | |
| | | Historisë | Bachelor në “Histori” | N/A | Shkresë MASH Nr. 1127 prot. datë 20.02.2006 | 180 ECTS |
| | | | Bachelor në dhe “Histori trashëgimi kulturore” | | Shkresë MASR Nr. 4063 prot. datë 21.07.2021 Urdhër nr. 272, datë 21.07.2021 | 180 ECTS |
| | | Gjeografisë | Bachelor në “Gjeografi” | N/A | Shkresë MASH Nr. 1127 prot. datë 20.02.2006 | 180 ECTS |
| | | | Master i Shkencave “Studime Regjionale Gjeografi” | VKA Nr. 461, datë 03.05.2013 | UMASH Nr. 212, datë 31.05.2013 | 120 ECTS |
| | | | Master Profesional në “Mësuesi në Histori – Gjeografi” | N/A | VKM Nr. 1212, datë 11.12.2009 | 120 ECTS |
| | | | Programi studimi me karakter profesional “Udhërrëfyes Turistik dhe Menaxhues i Itinerareve Turistike për Rajonin Verior” | | Shkresë MASR Nr. 2712/1 prot. datë 03.07.2020 UMASH Nr. 196, datë 03.07.2020 | 60 ECTS |
| | | QSA | Doktoratë në “Gjuhë Shqipe” | | UMASH Nr. 498, datë 07.10.2011 | |
| | Fakulteti i Gjuhëve të Huaja | Gjuhë Angleze | Bachelor në “Gjuhë Angleze” | N/A | VKM Nr. 300, datë 21.06.1994 | 180 ECTS |
| | 4-BA 4-MP | | Master Profesional në “Mësuesi në Gjuhë Angleze” | N/A | VKM Nr. 1291, datë 24.09.2008 | 120 ECTS |
| | | Gjuhë Gjermane | Bachelor në “Gjuhë Gjermane” | N/A | Shkresë MASH Nr. 960 prot. datë 11.03.1996 | 180 ECTS |



| | | | | | | | | |
|--|-----------------------|--|---|----------------------------------|-------------------------------|---|--------------------------------|----------|
| | | Master Profesional në "Mësuesi Gjuhë Gjermane" | në në | N/A | VKM Nr. 1291, datë 24.09.2008 | 120 ECTS | | |
| | | Romanistikës | Bachelor në "Gjuhë Frënge" | në | VKM Nr.560, datë 12.08.2005 | 180 ECTS | | |
| | | | Master Profesional në "Mësuesi Gjuhë Frënge" | në në | N/A | VKM Nr. 1333, datë 01.10.2008 | 120 ECTS | |
| | | | Bachelor në "Gjuhë Italiane" | në | N/A | VMASH Nr. 146, datë 04.08.1998 | 180 ECTS | |
| | | | Master Profesional në Mësuesi në "Gjuhë Italiane" | në në | N/A | VKM Nr. 1333, datë 01.10.2008 | 120 ECTS | |
| | Fakulteti Ekonomik | | | | | | | |
| | 3-BA 4-MP 4-MSH | Financë – Kontabilitetit | Bachelor në "Financë Kontabilitet" | në | N/A | Shkresë MASH Nr. 4390 Prot. datë 23.10.2000 | 180 ECTS | |
| | | | Master Shkencave në "Kontabilitet" | në | VKA Nr. 189, datë 24.06.2011 | UMASH Nr. 395, datë 10.08.2011 | 120 ECTS | |
| | | | Master Shkencave në "Financë" | në | VKA Nr. 189, datë 24.06.2011 | UMASH Nr. 395, datë 10.08.2011 | 120 ECTS | |
| | | | Master Profesional "Financë Bankë" | në | VKA Nr. 376, datë 17.09.2012 | UMASH Nr. 503, datë 18.10.2012 | 120 ECTS | |
| | | | Master Profesional "Menaxhimi Financiar, Kontabiliteti dhe Kontrolli Administratën Publike" | në dhe në | | UMASR Nr. 702, datë 19.10.2018 | 60 ECTS | |
| | | | Administrim Biznes | Bachelor në "Administrim Biznes" | në | N/A | VKM Nr. 349, datë 10.08.1992 | 180 ECTS |
| | | | | Master | në | VKA Nr. 189, datë | UMASH Nr. 395, datë 10.08.2011 | 120 ECTS |



| | | | | | | |
|--|---------------------------------|---|--|------------------------------|---|----------|
| | | | Shkencave në "Administrim Biznesi" | 24.06.2011 | | ECTS |
| | | | Master Profesional në "Administrim Biznesi" | VKA Nr. 376, datë 17.09.2012 | UMASH Nr. 503, datë 18.10.2012 | 120 ECTS |
| | | Turizëm | Bachelor në "Turizëm" | | MAS vendim 1803/1 datë 05.06.2001 | 180 ECTS |
| | | | Master i Shkencave në "Menaxhimi i Turizmit të Qëndrueshëm" | N/A | VKM Nr. 1370, datë 10.10.2008 | 120 ECTS |
| | | | Master Profesional në "Trashëgimi Kulturore dhe Menaxhim Turizmi" | VKA Nr. 376, datë 17.09.2012 | UMASH Nr. 503, datë 18.10.2012 | 120 ECTS |
| | Fakulteti i Drejtësisë | Departamenti i të drejtës ndërkombëtare dhe Europiane | Program i integruar studimeve të ciklit të dytë "Master i Shkencave" në "Drejtësi" | | Urdhër nr. 191, datë 03.07.2020 Nr. prot. 2329/2, datë 03.07.2022 | 300 ECTS |
| | 1. BA 3-MSH (2-MSH+1 integruar) | | Bachelor Drejtësi (viti II&III)----- | N/A | VKM Nr. 349, datë 10.06.1992 | 180 ECTS |
| | | | Master i Shkencave "E Drejta Kushtetuese dhe Administrative" | VKA Nr. 59, datë 08.01.2010 | VKM Nr. 682, datë 25.08.2010 | 120 ECTS |
| | | | Master i Shkencave "E Drejta Private dhe e Biznesit" | VKA Nr. 52, datë 09.11.2009 | VKM Nr. 1162, datë 25.11.2009 | 120 ECTS |



b-Programet e reja

Si aspekt shumë të rëndësishëm të strategjisë së zhvillimit e konsolidimit të Universitetit duhet të veçojmë synimin për konsolidimin dhe pasurimin e mëtejshëm të programeve aktuale të studimit Bachelor dhe Master si dhe hapjen e programeve të reja

Në FSHSH në vitin akademik 2021-2022 u hap programi i studimit Bachelor në *“Histori dhe trashëgimi kulturore”*. QSA e cila ka aplikuar për riorganizimin e programit të studimit të ciklit të tretë Doktoraturë në *“Gjuhë shqipe”* pas fazës së dytë të miratimit nga MAS, është në pritje të rihapjes së tij.

Këtë vit u miratua edhe hapja e programit të ri të ciklit të parë *“Gjeografi dhe zhvillim territori”* dhe e Masterit të Shkencave *“Studime në histori dhe kulturë shqiptare”*, por për shkak të kohës së shkurtër për promovim nuk ka patur regjistrime.

Në FSHE, me Urdhërin e MAS, nr. 334, datë 17.09.2021, pranë departamentit të Psikologjisë e Punës Sociale, u miratua hapja e programit të studimit të ciklit të dytë Master profesional në *“Shërbimet sociale”* i cili u aktivizua në vitin akademik 2021 – 2022 duke diplomuar dhe studentet e parë në sezonin e verës.

Arritja më e madhe për FE gjatë këtij viti ka qenë ardhja në datë 4.4.2022 e urdhërit të hapjes së programit të Doktoraturës në *“Ekonomi dhe Turizëm të Qëndrueshëm”* të mbështetur nga projekti MARDS në kuadrin e programit ERASMUS +. Departamenti i Turizmit si departament aplikues dhe Fakulteti Ekonomik kanë plotësuar të gjitha rekomandimet e ardhura nga MAS për hapjen e këtij programi studimi. Me datë 14 Nëntor Rektorja e USH-së ka hapur thirrjen për aplikime të brezit të parë të doktorantëve në këtë program studimi.

Në FSHN, si rezultat i përpjekjeve disavjeçare drejtuesit dhe pedagogët e departamentit Biologji – Kimi, kanë ideuar një program profesional 2 vjeçar *“Teknik ushqimi”* dhe një program Bachelor në *“Shkencat e Ushqimit dhe Teknologji”*. Ky departament po përgatitet të aplikojë edhe për hapjen e programit të Doktoraturës në Shkenca Mjedisore. Departamenti i Fizikës aplikoi gjatë vitit 2021-2022 për programin 2 vjeçar profesional *“Specialist i lartë elektrik”*, ndërsa Departamenti i Matematikës për programin e studimit Master profesional (njëvjeçar) në *“Zhvillim programesh të avancuara”* në bashkëpunim me Universitetin Politeknik të Le Marche, Ancona, Itali. Të dy këto programe janë miratuar nga MAS dhe janë në vitin e parë të zbatimit të tyre.

Një risi jo vetëm për FSHN por edhe për Universitetin është miratimi i zhvillimit të procesit mësimor edhe në gjuhën angleze në dy programe studimi: Bachelor në Biologji – Kimi dhe Bachelor në Informatikë.

Gjatë vitit 2021-2022 të gjitha fakultetet kanë punuar shumë për hartimin e dokumentacionit të programeve të reja të studimit, por megjithë përpjekjet nga 21 aplikime vetëm 9 programe studimi u miratuan nga MAS dhe kanë filluar procesin mësimor në vitin akademik aktual:

1. Bachelor në *“Gjeografi dhe Zhvillim Territori”*,
2. Bachelor në *“Informatikë”* në Gjuhën Angleze,
3. Bachelor në *“Biologji- Kimi”* në Gjuhën Angleze,
4. Master profesional në *“Mësues Muzike”*,



-
5. Master profesional në “ Mësues i Artit Pamor”,
 6. Master profesional në “ Zhvillim programesh të avancuara”,
 7. Master i Shkencave në “ Studime të historisë dhe kulturës shqiptare”,
 8. Program studimi me karakter profesional “ Specialist i Lartë Elektrik “,
 9. Doktoraturë në “ Ekonomi dhe turizëm të qëndrueshëm.

Hapja e programeve të reja në profilet përkatëse që vijnë në përshtatje me kërkesat e tregut të punës, mbetet detyrë dhe nënvizohet në analizën vjetore të të gjitha fakulteteve.

c-Realizimi i programeve të studimit

Programet e studimit janë në përputhje të plotë me misionin dhe objektivat e Universitetit të Shkodrës i cili e harton politikën e vet në përputhje me politikat kombëtare dhe bën përpjekje për të siguruar koherencë me programe të ngjashme studimi të universiteteve të tjera në vend, në rajon e më gjerë.

Realizimi i programeve me cilësi, përditësimi i tyre, hapja e programeve të reja dhe orientimi i tyre drejt tregut të punës, janë disa nga aspektet kryesore të analizës së punës mësimore në universitet. Edhe këtë vit akademik përmirësimi i programeve ekzistuese të studimit është parë me synim forcimin cilësor të tyre dhe sigurimin e vlefshmërisë në tregun e punës.

Në të gjitha fakultetet programet janë realizuar plotësisht. Pedagogët kanë treguar seriozitet në zbatimin e programeve mësimore të lëndëve përkatëse. Ka një konceptim bashkëkohor të leksioneve dhe të seminareve nga ana e pedagogëve si në drejtim të përmbajtjes, ashtu edhe të mënyrës së organizimit, përmes pjesëmarrjes aktive të studentëve, duke i nxitur ata të diskutojnë dhe të japin mendime lidhur me temat e trajtuara në leksione e seminare. Edhe përdorimi i mjeteve të teknologjisë për shpjegimin e leksioneve ka ndikuar në rritjen e cilësisë së zhvillimit të tyre dhe në rritjen e pjesëmarrjes së studentëve në diskutime. Prezantimi i temave nga pedagogët përmes programit poëer-point, ka qenë një mundësi tjetër për motivimin e studentëve dhe rritjen e interesit të tyre për punën mësimore dhe rritjen e frekuentimit të leksioneve.

Në vijim po paraqesim disa nga faktorët që kanë ndikuar në realizimin me sukses të programeve të studimit:

➤ Hartimi dhe përditësimi i planeve mësimore

Nga të gjitha departamentet është synuar që planet mësimore të jenë në përputhje me udhëzimet e MASR dhe aktet nënligjore, lidhur me raportin e drejtë të shpërndarjes së orëve të studimit auditor/studim individual, raportin e drejtë të krediteve mes leksioneve dhe orëve të seminarit, si dhe numrin e vlerësimeve. Sipas raporteve të fakulteteve vërehet se është bërë një



punë serioze sa i përket përditësimit të planeve mësimore të programeve të të dy cikleve të studimit. Është punuar që të ruhet sa më shumë numri i provimeve në planet mësimore sipas Udhëzimit 41, duke pasur parasysh faktin që studentët të mos kenë mbingarkesë provimesh ose shlyerje modulesh. Në raportin e FSHSH-së theksohet se edhe këtë vit akademik njësitë bazë kanë punuar për rishikimin e programeve të studimit, sidomos të atyre të ciklit të parë, duke zvogëluar në minimum ngarkesën me lëndë, por edhe duke mbajtur në konsideratë përmbushjen me dije bazë, për masën e studentëve që synojnë të specializohen në mësuesi.

Problematika me numrin e madh të lëndëve e për rrjedhojë edhe të detyrimeve për shlyerjen e tyre, lidhet kryesisht specifikat që kanë programet e studimit të departamentit të infermierisë të FSHN-së. Përvoja e këtij viti duke reduktuar numrin e lëndëve në programet Bachelor tregoi se ndërhyrjet qenë efektive dhe nuk krijuan vështirësi qoftë në zhvillimin e leksioneve dhe seminareve, qoftë edhe në provime.

Në FE gjatë vitit 2021-2022 është bërë përmirësimi deri në masën 20% për ndryshimin e planeve mësimore të programeve të studimit të ofruara nga FE që fillojnë në vitin akademik 2022-2023.

Përditësimi i programeve mësimore të lëndëve për të qenë koherentë me literaturën bashkëkohore, evoluimet shkencore dhe kërkesat e tregut të punës përbën një nga synimet e përhershme dhe më të rëndësishme në të gjitha njësitë bazë të USH-së. Në të gjitha raportet pasqyrohen përpjekjet e stafit akademik për përmirësimin e mësimdhënies duke shfrytëzuar tekstet e hartuara nga pedagogë të USH, literaturën e huaj si dhe burimet e internetit. FE citon në mënyrë të veçantë literaturën e sjellë nga Prof.Ted Oefke të siguruar nga marrëveshja me SCC, nga biblioteka digjitale, nga INSTAT, raportet të WTTC (Këshilli Botëror i Udhëtimeve dhe Turizmit), informacione të OBT(Organizata Botërore e Turizmit), GIZ, AIDA etj.

➤ **Ngarkesat mësimore dhe mbulimi i programeve të studimit me staf akademik**

Gjatë vitit akademik 2021-2022 vëmendje i është kushtuar edhe shpërndarjes së **ngarkesave mësimore**. Çdo fillim viti akademik departamentet diskutojnë dhe miratojnë ngarkesën mësimore vjetore e cila përditësohet gjatë vitit sipas nevojave të tyre. Disa nga problemet e diskutuara janë studimi dhe përmirësimi i shpërndarjes i ngarkesës mësimore të pedagogëve me kohë të plotë dhe kohë të pjesshme sipas udhëzimeve përkatëse, problemi i mbingarkesës dhe rekrutimi i pedagogëve me kohë të plotë dhe kohë të pjesshme. Pothuajse të gjithë pedagogët PAE e kanë realizuar 100% ngarkesën mësimore vjetore të planifikuar. Pjesa më e madhe e tyre ka realizuar edhe 200 orë suplementare që lejon udhëzimi nr.29, datë 10.9.2018. Ka ndodhur në ndonjë rast që për arsye specifike të departamentit nuk janë zbatuar udhëzimet sa u përket limitit të orëve suplementare dhe numrit të lëndëve për t'u zhvilluar në një vit akademik.

Mbulimi i programeve të studimit kryesisht me personel akademik efektiv ka qenë një nga prioritetet e punës në fakultete. Është për t'u theksuar fakti se gjatë këtij viti akademik janë rekrutuar pedagogë në fakultete të ndryshme, me synimin për të përmirësuar raportin pedagog i brendshëm/pedagog i jashtëm në mbulimin e programeve të studimit. Megjithatë ka ende



programe studimi që nuk e realizojnë rekomandimin nr 3, datë 24.01.2020 të vendimit të Bordit të Akreditimit sipas të cilit “ Institucioni duhet të sigurojë mbulimin e ngarkesës mësimore në programet e studimit të ciklit të parë nga stafi akademik efektiv në masën të paktën 70%”. Departamenti infermierisë, për specifikat që prapaqesin programet e studimit Bachelor, e ka këtë vështirësi prej vitesh. Megjithatë, këtë vit përqindja është më e lartë në krahasim me vitin e kaluar. Pasqyrat e mëposhtme japin në përqindje raportin mes stafit efektiv dhe atij me kohë të pjeshme.

Tabelë nr 2. Matrica për vitin akademik 2021-2022

| Fakulteti | Programi i studimit | Totali i orëve i programit të studimit | Orë mbuluar nga ped. Brendsh të departamentit | Orë mbuluar nga ped. Brendsh të departamenteve të tjera të USH-së | Orë mbul. ped. jashtëm | % e Pedagogeve me kohe te plote | % e Pedagogeve me kohe te pjeshme |
|------------------------------------|--|--|---|---|------------------------|---------------------------------|-----------------------------------|
| F.Gjuhëve të Huaja Bachelor | Gjuhë Angleze | 1722 | 1617 | 105 | 348 | 79.8% | 20.2% |
| | Gjuhë Gjermane | 1974 | 1763 | 150 | 60 | 96.6% | 3.4% |
| | Gjuhë Frënge | 1285 | 586 | 105 | 180 | 70.8% | 20.2% |
| | Gjuhë Italiane | 2164 | 1732 | 165 | 267 | 82.4% | 17.6% |
| Master Profesional | Mësuesi në Gjuhë Angleze | 1052 | 722 | 330 | 0 | 100% | 0% |
| | Mësuesi në Gjuhë Gjermane | 1223 | 788 | 435 | 0 | 100% | 0% |
| | Mësuesi në Gjuhë Frënge | 1223 | 642 | 390 | 191 | 84.3% | 15.7% |
| | Mësuesi në Gjuhë Italiane | 1223 | 893 | 330 | 0 | 100% | 0% |
| Fakulteti ekonomik Bachelor | Financë - Kontabilitet | 2000 | 1137 | 430 | 433 | 78.35 | 21.65 |
| | Administrim – Biznes | 1965 | 760 | 550 | 655 | 67 | 33 |
| | Turizëm | 1882 | 671 | 695 | 516 | 72.6 | 27.4 |
| Master Profesional | Financë - Bankë | 1200 | 892 | 90 | 218 | 81.83 | 18.17 |
| | Menaxhimi Financiar, Kontabiliteti dhe | 600 | 490 | 45 | 65 | 89.17 | 10.83 |



| | | | | | | | |
|--|--|------|------|-----|------|--------|-------|
| | Kontrolli në Administratën Publike | | | | | | |
| | Administrim Biznes | 1200 | 855 | 165 | 180 | 85 | 15 |
| | Trashëgimi Kulturore dhe Menaxhim Turizmi | 1200 | 545 | 295 | 360 | 70 | 30 |
| Master Shkencor | Kontabilitet | 1200 | 780 | 120 | 300 | 75 | 25 |
| | Financë | 1200 | 715 | 165 | 320 | 73.3 | 26.67 |
| | Administrim Biznesi | 1200 | 750 | 210 | 240 | 80 | 20 |
| | Menaxhim i Turizmit të Qëndrueshëm | 1185 | 569 | 325 | 291 | 75.4 | 24.6 |
| Fakulteti i Shkencave të Natyrës Bachelor | Infermieri të përgjithshme | 2179 | 1012 | 102 | 1065 | 51.1% | 48.9% |
| | Mami | 2159 | 1078 | 102 | 1081 | 49.9% | 50.1% |
| | Fizioterapi | 2171 | 1162 | 155 | 854 | 60.60% | 39.4% |
| | Biologji - Kimi | 1930 | 1562 | 200 | 168 | 91.3% | 8.7% |
| | Fizikë | 675 | 315 | 360 | 0 | 100% | 0% |
| | Matematikë | 1943 | 1263 | 162 | 525 | 73% | 27% |
| | Informatikë | 1988 | 1272 | 180 | 491 | 75% | 25% |
| Master Profesional | Psikologji Shëndeti | 645 | 260 | 150 | 235 | 63.5% | 36.5% |
| | Mësuesi në Biologji – Kimi | 1428 | 1063 | 320 | 45 | 96% | 4% |
| | Mësuesi në Matematikë-Fizikë | 1300 | 583 | 435 | 282 | 78% | 22% |
| | Mësuesi në Informatikë me Profil Minor në Matematikë | 1263 | 393 | 330 | 570 | 55% | 45% |
| | Mësuesi në Matematikë me Profil Minor në Informatikë | 1293 | 483 | 210 | 600 | 54% | 46% |
| Master Shkencor | Biologji Mjedisore | 1035 | 965 | 0 | 70 | 93% | 7% |



| | | | | | | | |
|---|--|-------------------------------------|-----------------------|-----------------------------|---------------------|-------|-------|
| Programi studimi me karakter profesional | Teknik sistemesh dhe rrjetesh kompjuterike | 1197 | 905 | 0 | 292 | 75.5% | 24.5% |
| Fakulteti i Shkencave Shoqërore Bachelor | Gjuhë - Letërsi | 1946 (letërsia) | 950 | 60 | 0 | 100% | 0% |
| | Gazetari dhe Komunikim | 1927 | 1227 | 400 | 300 | 98 | 3 |
| | Histori | 3000 ¹ (në auditor 1164) | 1350 (në auditor 655) | 100 (në auditor 39) | - | 100% | 0% |
| | Histori dhe trashëgimi kulturore | 1500 ² (në auditor 660) | 825 (në auditor 315) | 500 (në auditor 270) | 175 (në auditor 75) | 88% | 12% |
| | Gjeografi | 1138 | 994 | 144 | - | 100% | - |
| Master Profesional | Mësuesi në Gjuhë - Letërsi | 1202 | 482 | (Psikologji - pedagogji)320 | 0 | 100% | 0 |
| | Mësuesi Histori - Gjeografi | 4500 (në auditor 1724) | 625 (në auditor 315) | 3725 (në auditor 1349) | 150 (në auditor 60) | 75% | 25% |
| Master Shkencor | Studime shqiptare dhe etnokulturore, profili “Studime të Thelluara në Gjuhësi” | | | | | | |
| | Studime shqiptare dhe etnokulturore, profili “Etnokultura dhe Letërsia Shqipe” | | | | | | |
| | Studime Regjionale në Gjeografi | 1100 | 913 | 32 | 155 | 85% | 15% |
| Programi studimi me karakter | Udhërrëfyes Turistik dhe Menaxhues i | 725 | 305 | 90 | 330 | 55% | 45% |

¹ Në vitin akademik 2021-2022 në programin e studimit “Histori” për vitin e parë nuk ka pasë studentë të regjistruar.

² Në vitin akademik 2021-2022 programi i studimit “Histori dhe trashëgimi kulturore” është program i ri dhe si rrjedhojë është realizuar vetëm plani mësimor i vitit të parë.



| | | | | | | | |
|--|--|--------|-------|-----|-----|--------|--------|
| professional | Itinerareve Turistike për Rajonin Verior | | | | | | |
| F.Shkencave të Edukimit Bachelor | Psikologji | 1914 | 1347 | 195 | 374 | 70.30% | 29.70% |
| | Punë Sociale | 1974 | 1254 | 180 | 540 | 63.50% | 36.50% |
| | Mësuesi për Arsimin Fillor | 1955 | 815 | 960 | 180 | 90.80% | 9.20% |
| | Mësuesi për Arsimin Parashkollor | 2110 | 600 | 955 | 555 | 73.70% | 26.30% |
| | Pikturë dhe Grafikë | 2200 | 1529 | 60 | 611 | 72.00% | 28.00% |
| | Pedagogji Muzikore | 2168 | 1140 | 578 | 450 | 80.00% | 20.00% |
| | Edukim Fizik dhe Sporte | 2057 | 1170 | 555 | 332 | 83.85% | 16.15% |
| Master Profesional | Shërbimet Sociale | 493 | 493 | 0 | 0 | 100% | 0 |
| | Mësuesi në lëndët Edukim Fizik dhe Sporte | 1273.5 | 924.5 | 349 | | 100% | |
| | Mësuesi për Arsimin Fillor | 990 | 450 | 480 | 60 | 94% | 6% |
| Master Shkencor | Psikologji Klinike | 686 | 416 | 90 | 180 | 74% | 26% |
| | Psikologji Organizative | 686 | 281 | 180 | 225 | 67.20% | 32.80% |
| | Mësuesi në Biologji-Kimi, me Profil Minor në Karriera dhe Aftësimi për Jetën | 1200 | 200 | 882 | 120 | 90% | 10% |
| F. Drejtësisë Bachelor | Drejtësi (viti II&III) | | | | | | |
| Master Shkencor | E Drejta Kushtetuese dhe Administrative | | | | | | |
| | E Drejta Private dhe e Biznesit | | | | | | |
| Program i Integruar i ciklit të dytë Master i Shkencave | Drejtësi | | | | | | |



Bazuar në të dhënat e mësipërme, po nuk e plotësojnë mbulimin me PAE në masën 70%:

evidentojmë programet e studimit që

Fakulteti Ekonomik

- BA në Administrim – Biznes 67%

• Fakulteti i Shkencave të Natyrës

- BA në Infermieri 51.1%,
- BA në Fizioterapi 60.60%,
- BA në Mami 49.9%
- MP në Psikologji Shëndeti 63.5%.
- MP në Mësuesi në Matematikë me Profil Minor në Informatikë 54% ,
- MP në Mësuesi në Informatikë me Profil Minor në Matematikë 55%,

• Fakulteti i Shkencave Shoqërore

- Programi studimi me karakter profesional “Udhërrëfyes Turistik dhe Menaxhues i Itinerareve Turistike për Rajonin Verior” 55%

• Fakulteti i Shkencave të Edukimit

- BA në Punë Sociale 63.50%
- MSH në Psikologji organizative 67.20%

➤ Praktikant mësimore e profesionale

Praktikat profesionale dhe ato pedagogjike që zhvillohen në të dy ciklet e studimit, në kontekstin universitar marrin rëndësi të veçantë pasi i përgatisin studentët për integrimin profesional. Ky aspekt përfshin punën që bëhet në *labororet* e programeve të studimit të shkencave të natyrës, *praktikat në terren* në programet e studimit të shkencave shoqërore si dhe *praktikat pedagogjike* në programet e mësuesisë. Gjatë periudhës së praktikës të përcaktuar sipas specifikës së secilit program studimi, studentët mbikqyren dhe vlerësohen nga pedagogët sipas metodologjisë përkatëse. Edhe këtë vit, pedagogët e studentët janë impenjuar seriozisht në plotësimin e objektivave të praktikës mësimore e profesionale.

Në **FSHE**, në departamentet e Mësuesisë, Edukimit fizik dhe Arteve praktika profesionale është organizuar mbi bazën e planit e programit mësimor për praktikën në disa shkolla të



qytetit të Shkodrës. Veprimtaria vëzhguese e studentit ka qenë e orientuar në mënyrë profesionale përmes përgatitjes së portofolit për çdo student, çka përbën një hap të ri lidhur me mënyrën e vëzhgimit dhe të vlerësimit të praktikës profesionale. Studentët kanë treguar gatishmëri, korrektësi dhe seriozitet në ndjekjen e gjithë procesit mësimor.

Edhe departamenti i Psikologjisë e Punës Sociale e ka realizuar praktikën me studentët në zbatim të marrëveshjeve me institucionet përkatëse si: Bashkia Shkodër, Vau Dejës, Lezhë, Malësi e Madhe, Shërbimi social shtetëror, OFF e ndryshme, etj.

Studentët e **FSHSH-së** që ndjekin programet e studimit të ciklit të dytë Mësuesi i zhvilluan praktikat profesionale pranë shkollave 9 vjeçare dhe të mesme (në bazë të marrëveshjes me ZVA-Shkodër), sikurse studentët e Masterit shkencor në Gjeografi i kanë zhvilluar praktikat pranë Bashkisë Shkodër, Bashkisë Koplík, Hipotekën e Shkodrës, Bashkisë Lezhë, Njësisë Administrative Bushat, si dhe organizata qeveritare dhe joqeveritare, si: GO2, Aarhus, Agroturizëm “*Marku*” etj. Departamenti i Historisë ka marrëveshje me: Muzeun Historik të Shkodrës, Muzeun e Fotografisë “*Marubi*”, Drejtorinë Rajonale të Trashëgimisë Kulturore - Shkodër, Bibliotekën “*Marin Barleti*” – Shkodër për praktikën profesionale apo atë mësimore në terren.

Falë marrëveshjes me Zyrën Vendore Arsimore Shkodër edhe studentët e ciklit të dytë Master profesional në Mësuesi të katër degëve të **FGJH-së** praktikën profesionale e kanë zhvilluar në shkollat e mesme dhe 9vjeçare në lëndën gjuhë e huaj anglisht, italisht, frëngjisht dhe gjermanisht.

Në **FE** lënda “Praktikë Profesionale” është realizuar mbi bazën e bashkëpunimit të ngushtë me institucionet shtetërore, si Bashkia, Drejtoria Rajonale e Tatimeve, Gjykata e rrethit, biznese private, OJF-të etj. Vlen të theksohet se studentëve u është krijuar mundësia nga pedagogët e praktikës të ndjekin nga afër biznese të ndryshme të sukseshme jo vetëm të rajonit të Shkodrës por dhe më gjërë. Departamenti i Turizmit ka realizuar për herë të parë në FE dhe USH vlerësimin e cilësisë së zhvillimit të praktikës ku studentët vlerësojnë strukturën dhe angazhimin e subjekteve të praktikës. Një arritje tjetër e Departamentit të Turizmit është dërgimi i 6 studentëve të Turizmit për të zhvilluar intershipin njëvjeçar në Amerikë (nga Bachelor në Turizëm) falë bashkëpunimit të suksesshëm të FE-së me SCC dhe këmbënguljes së Prof. Ted Oefke për realizimin e këtij intershipi.

Studentët e programeve Bachelor në Biologji – kimi dhe ata të Masterit Shkencor në Biologji Mjedisore të **FSHN-së**, i zhvillojnë praktikat mësimore në terren në Rajonin e Veriut dhe më gjërë (në zona të mbrojtura dhe në parqe kombëtare) për të fituar njohuri më të thelluara shkencore dhe profesionale për florën dhe faunën e vendit tonë.

➤ **Angazhimi në mësimdhënie i pedagogëve PAK të kualifikuar dhe specialistë të terrenit**

Është për t'u përmendur dhe vlerësuar kontributi i pedagogëve të jashtëm në të gjitha programet mësimore që ofron Universiteti i Shkodrës. Gjatë vitit 2021-2022 stafi akademik me kohë të pjesshme ka qenë i përbërë nga mësues, pedagogë dhe specialistë të fushave të ndryshme nga rajoni i Shkodrës dhe më gjërë.



3-NDRYSHIMET NË RREGULLORET

E PROGRAMEVE TË STUDIMIT

Gjatë vitit akademik 2021-2022 ka pasur ndryshime në rregulloret e studimit të **Fakultetit të Gjuhëve të Huaja**, të **Fakultetit Ekonomik** dhe të **Fakultetit të Shkencave të Natyrës**.

Departamenti i Gjermanistikës ndërmori këto ndryshime:

- Në nenin 24, pika 6 në fund të fjalisë shtohet “përveç rasteve të parashikuara në nenin 27 pika 4”;
- Në nenin 37 pika 6, ndryshon si vijon “Diplomimi me punim diplome për sistemin Bachelor bëhet nga studentët që kanë notën mesatare jo më pak se 8 (tetë). Diplomimi i studentëve të programit “Master Profesional mbyllet me provim përfundimtar formimi ose punim diplome; nota mesatare për punim diplome caktohet me vendim departamenti”.

Departamenti i Gjuhës Angleze ka bërë ndryshime që lidhen me detyrimet përmbyllëse të ciklit të dytë të studimeve 2022-2023:

- Studentët e ciklit të dytë të studimeve do të kryejnë detyrimet përmbyllëse të këtij cikli me mbrojtje teme diplome;
- Nota mesatare që lejon studentët e ciklit Bachelor të kryejnë detyrimet përmbyllëse të këtij cikli duhet të jetë 8.

FE ka bërë ndryshime në rregulloren e Departamentit të Turizmit në nenin ‘Transferim studimesh’ ku përcaktohet se pranohen transferime në programe studimesh të njëjta ose të ngjashme dhe në të njëjtin cikël studimesh, në cilat vite studimi bëhet transferimi i studimeve dhe në cilën periudhë të vitit akademik. Po kështu është shtuar një pikë në këtë nen për të rregulluar këtë proces edhe në programin e Doktoratës. Rregullimet në këtë nen ndikojnë në cilësinë e realizimit të programeve të studimit.

Në **FSHN** janë bërë ndryshime të vogla në rregulloren e programin e studimit Master i Shkencave në “*Biologji Mjedisore*”, për shkak të faktit që dega Biologji mjedisore ka një ndërthurje të gjerë të disiplinave të ndryshme biologjike, dhe meqënëse ky program studimi e reflekton këtë karakter, është zgjeruar pak edhe gama e profileve që mund të pranohen për të ndjekur këtë master.

4- TË DHËNA PËR NJËSINË E SIGURIMIT TË BRENDSHËM TË CILËSISË

Në bazë të ligjit nr.80/2015“*Për arsimin e lartë dhe kërkimin shkencor në institucionet e arsimit të lartë në Republikën e Shqipërisë*”, neni 103, dhe në bazë të nenit 24 të Statutit të Universitetit të Shkodrës, është krijuar Njësia e Sigurimit të Brendshëm të Cilësisë(NJSBC) e cila monitoron kufijtë e autonomisë akademike dhe administrative, vlerëson rezultatet e veprimtarive mësimore dhe kërkimore-shkencore. Për sigurimin e brendshëm të cilësisë çdo vit akademik janë krijuar NJSBC në nivel Fakulteti dhe NJSBC në nivel të programeve të studimit, ku në përbërje të çdo grupi të NJSBC është një ekspert i jashtëm dhe një student.




Zyra e Sigurimit të Cilësisë dhe e vlerësimit të standardeve harton raportin e vlerësimit të brendshëm të USH në bazë të të dhënave të mbledhura nga fakultetet. Këtë vit është hartuar Paketa e Instrumenteve Matës të Cilësisë në USH e përbërë nga 8 pyetësorë drejtuar studentëve dhe stafit akademik të cilët do të masin periodikisht cilësinë me anë të vlerësimit dhe vetëvlerësimit që ka si funksion kryesor të monitorojë dhe vlerësojë cilësinë e USH në bazë të udhëzuesit të ASCAL dhe kodit të cilësisë. Pyetësorët pritet të miratohen këto ditë me vendim të Senatit Akademik.

Zyra e Sigurimit të Cilësisë koordinon gjithashtu punën në mbështetje të njësive akademike për procesin e riakreditimit institucional dhe të riakreditimit të programeve të studimit, bazuar në udhëzimet dhe standardet e ASCAL. Gjatë këtij viti është bërë aplikimi për akreditimin e disa nga programet e studimit të Fakultetit Ekonomik, Fakultetit të Shkencave të Edukimit dhe Fakultetit të Shkencave të Natyrës. Konkretisht është bërë aplikimi për akreditimin e këtyre programeve studimi: *Bachelor në Financë-Kontabilitet, Bachelor në Administrim-Biznes, Bachelor në Turizëm, Bachelor në Mësuesi për Arsimin Fillor, Bachelor në Mësuesi për Arsimin Parashkollor, Bachelor në Psikologji, Bachelor në Punë Sociale, Bachelor në Edukim Fizik dhe Sporte, Bachelor në Matematikë, Bachelor në Biologji-Kimi, Bachelor në Informatikë.* Gjatë kësaj periudhe Zyra e Sigurimit të Cilësisë ka qenë e angazhuar me vënien në dispozicion të informacioneve të kërkuara nga ASCAL për akreditimin e programeve. Çdo fillim viti Zyra e Sigurimit të Cilësisë përditëson të dhënat në AMS për programet e studimit, për pedagogët me kohë të plotë dhe ata me kohë të pjesshme. Çdo fundsemestri Zyra e Sigurimit të Cilësisë dhe e Vlerësimit të Standardeve, në bazë të Statutit të USH-së, neni 24, pika 2 ka për detyrë ligjore të realizojë para sezonit të provimeve pyetësorin studentor për cilësinë e mësimdhënies për lëndët e çdo programi studimi i cili përdoret edhe si evidencë në Raportet e Vlerësimit të Brendshëm që hartojnë departamentet përkatëse për procesin e akreditimit. Sa i përket 10 programeve në proces akreditimi, ky pyetësor për semestrin e dytë të vitit akademik 2021-2022 u vendos të bëhej fizikisht në auditore për të siguruar pjesëmarrje sa më të mirë të studentëve Në total pyetësori ka pasur një pjesëmarrje prej 40%, shifër e cila është e konsiderueshme si matës cilësie mbi lëndën dhe pedagogun. Përgjigjet kanë pasur marzh pozitiv në mbarë fakultetet.


5-TË DHËNA MBI GJURMIMIN E STUDENTËVE QË KANË PËRFUNDUAR STUDIMET. ALUMNI DHE KËSHILLIMI I KARRIERËS

Gjatë periudhës Tetor 2021- Shtator 2022, Zyra e Alumni ka plotësuar database me të dhëna për secilin alumn. Në këtë vit akademik janë 808 studentë të diplomuar në Bachelor, 146 studentë të diplomuar në Master Shkencor, 322 studentë të diplomuar në Master Profesional si dhe 29 studentë të diplomuar në Programe me karakter Profesional. Zyra e Alumni e merr informacionin në lidhje me studentët e diplomuar nga sekretaritetë mësimore për secilin fakultet. Gjithashtu gjurmimi i alumnëve realizohet nëpërmjet adresave të tyre elektronike si dhe numrave të telefonit.


Përqindja e punësimit të diplomuarve është e paraqitur në formë grafikësh si më poshtë:



Punësimi(%) i Alumni në Drejtorinë e Shëndetit Publik



Punësimi(%) i Alumni në USH



Punësimi (%) i Alumni në Bashkinë e Shkodrës

Zyra e Këshillimit të Karrierës në bashkëpunim me të gjitha fakultetet ka organizuar Ditët e Hapura 2022, duke qënë në komunikim të vazhdueshëm me përgjegjësit e arsimit të mesëm në:



Has, Vau Dejës, Kukës, Kurbin, Lezhë, Malësi e Madhe, Mirditë, Pukë-Fushë Arrëz, Shkodër dhe Tropojë. Informacionet që u janë përcjellë maturantëve janë afishuar në faqen ëeb të Universiteti të Shkodrës, e cila ka një hapësirë dedikuar atyre.

Takimi i parë është zhvilluar në Dibër në një panair të zhvilluar nga Dhoma e Tregtisë dhe e industrisë në bashkëpunim me Ministrinë e Arsimit me datë 15 Mars 2022, për të vazhduar më tej në Lezhë, Mirditë, Kukës, Tropojë, Pukë e Shkodër. Në këto takime secili fakultet ka patur përfaqësuesit e tij, në mënyrë që maturantëve t'u shpjegohej dhe t'u jepej përgjigje për secilin program studimi për të cilin ishin të interesuar. Pjesëmarrja dhe interesi i maturantëve ka qënë relativisht e lartë.

Krahas aktiviteteve në rang universiteti, FE këtë vit akademik promovimin e programeve të studimit për 2022-2023 e ka zhvilluar në ambientet e fakultetit përmes organizimit të aktivitetit të përvitshëm "Mirë se vjen Maturant" me maturantë nga shkollat e mesme të rajonit të Shkodrës. Janë zhvilluar takimet e planifikuara nga USH si dhe takime të tjera të planifikuara nga MAS në Kukës e Lezhë. Promovimi është bërë gjithashtu përmes rrjeteve sociale, shpërndarjes së posterave e fletëpalosjeve dhe takimeve me faktor të interesit. Interesi i të rinjve përmes kësaj mënyre promovimi ishte i paktë.

Krahas promovimit të programeve të studimit të USH-së, Zyra e Këshillimit të Karrierës dhe Alumni në bashkëpunim me Këshillin Studentor kanë organizuar në maj 2022 leksionin e hapur me temë: "Sfidat e vendit përballë ikjes së të rinjve dhe shpopullimit", mbajtur nga gazetari Marin Mema dhe aktivisti Aurel Kujtimi.

6-PËRFAQËSIMI I STUDENTËVE NË ORGANET DREJTUESE TË IAL-SË DHE NË NJËSINË E SIGURIMIT TË BRËNDSHËM TË CILËSISË

Studentët kanë përfaqësuesit e tyre në çdo organ vendimmarrës të Universitetit të Shkodrës dhe kanë të drejtë të shprehin mendimet dhe propozimet e tyre rreth kurrikulës, programeve të studimit dhe rregulloreve.

Studentët e USH-së përfaqësohen në Senatin Akademik sipas përqindjeve të caktuara në ligj dhe komisionet e përhershme sipas IAL-së dhe statutit. Përfaqësuesit e studentëve marrin pjesë në mbledhjet e SA dhe shprehin mendimet dhe propozimet e tyre rreth kurrikulës, programeve të studimit dhe rregulloreve.

Studentët kanë një anëtar edhe në çdo Njësi të Sigurimit të Brëndshëm të Cilësisë në nivel Fakulteti dhe në nivel programi studimi si dhe në Komisionin për garantimin e standardeve të cilësisë në USH.

Këshillat Studentorë të Fakulteteve përbëhen nga tre anëtarë dhe Këshilli Studentor Institucional përbëhet nga 5 anëtarë. Kryetarët e këshillave studentorë në fakultete dhe këshilli studentor institucional zgjidhen direkt nga studentët votues me parimin që kandidati që merr më shumë vota automatikisht do të jetë kryetar i këtyre këshillave. Këshilli studentor bashkëpunon ngushtë me zyrën e këshillimit në karrierë dhe alumni. Ky këshill merr të gjitha sugjerimet, ankesat, kërkesat nga studentët dhe ua përcjell strukturave të USH-së. Në këtë mënyrë studentëve u krijohet mundësia të paraqesin në organet drejtuese të universitetit, mendimet dhe opinionet e tyre në lidhje me veprimtarinë akademike dhe shkencore. Këshillat Studentorë kanë të drejtë t'u drejtohen organeve drejtuese të universitetit dhe fakulteteve për të shprehur kërkesat dhe mendimet e studentëve. Secili prej hapave të zgjedhjeve që nga shpallja e kandidaturave deri në shpalljen e fituesve pasqyrohen në faqen zyrtare të



Universitetit. Zgjedhjet e këshillave studentore realizohen çdo 2 vite. Në 25.03.2022 u organizuan zgjedhjet e Këshillave Studentore në Universitetin e Shkodrës.

7-ANGAZHIMI I PERSONELIT AKADEMIK (STAF ME KOHË TË PLOTË DHE ME KOHË TË PJESSHME)

Personeli akademik i Universitetit të Shkodrës përbëhet nga:

- 199 pedagogë me kohë të plotë:
 - 14 Profesorë,
 - 34 Profesorë të asociuar,
 - 6 Docentë,
 - 88 Doktorë shkencash,
 - 57 Asistentë – lektorë.
- 262 pedagogë me kohë të pjesshme:
 - 4 Profesorë,
 - 2 Profesorë të asociuar,
 - 1 Docent,
 - 38 Doktorë shkencash,
 - 217 Asistentë – lektorë.

Në vijim tabelat e detajuara sipas fakulteteve:

Tabelë nr 3. Personeli akademik me kohë të plotë dhe me kohë të pjesshme

| Fakulteti | Departamenti | PAE | PAK |
|-----------------------------------|-------------------------------|-----|-----------|
| Fakulteti i Shkencave të Edukimit | Psikologji - Punë Sociale | 11 | 11 |
| | Mësuesisë | 8 | 9 |
| | Edukim Fizik dhe Sporte | 9 | 25 |
| | Departamenti i Arteve | 12 | 16 |
| | Totali | | 40 |
| Fakulteti i Shkencave Natyrore | Infermierisë | 13 | 74 |
| | Biologji – Kimisë | 16 | 14 |
| | Fizikës | 6 | 1 |
| | Matematikës/Informatikës | 9 | 33 |
| | Totali | | 44 |
| Fakulteti i Shkencave Shoqërore | Gjuhësisë | 11 | 0 |
| | Letërsisë/Gazetari -Komunikim | 12 | 0 |



| | | | |
|------------------------------|---|------------|------------|
| | Historisë | 7 | 2 |
| | Gjeografisë | 7 | 8 |
| | | 37 | 10 |
| Fakulteti i Gjuhëve të Huaja | i Gjuhës Angleze | 7 | 17 |
| | i Gjuhës Gjermane | 9 | 1 |
| | i Romanistikës | 11 | 11 |
| | Totali | 27 | 29 |
| Fakulteti Ekonomik | Financë – Kontabilitetit | 12 | 16 |
| | Administrim - Biznes | 10 | 17 |
| | Turizëm | 8 | 13 |
| | Totali | 30 | 46 |
| Fakulteti i Drejtësisë | Departamenti i të Drejtës Civile | 7 | 1 |
| | Departamenti i të Drejtës Publike e Penale | 8 | 3 |
| | Departamenti i të Drejtës ndërkombëtare dhe Evropiane | 6 | 0 |
| | Totali | 21 | 4 |
| TOTALI | | 199 | 272 |

Duke iu referuar tabelës së mësipërme konstatojmë se në disa departamente numri i pedagogëve me kohë të pjesshme është më i lartë se i atyre me kohë të plotë. Megjithëse kjo ndodh për shkak të specifikave që kanë disa departamente, duhet synuar në plotësimin e nevojave të departamenteve me staf me kohë të plotë.

Tabelë nr 4. Ngarkesat mësimore të stafit akademik me kohë të plotë

I. FAKULTETI I SHKENCAVE TË EDUKIMIT Departamenti i Psikologjisë dhe Punës Sociale

| Nr | Emri Mbiemri | Titulli | Pozicioni | Norma/orë | Realizimi |
|-----|--------------------|------------|------------|-----------|-----------|
| 1. | Adelina Kakija | Doktor | Pedagog | 165 | 282 |
| 2. | Arben Hoti | Doktor | Pedagog | 165 | 321 |
| 3. | Brilanda Lumanaj | Doktor | Pedagog | 165 | 357 |
| 4. | Bujanë Topalli | Doktor | Pedagog | 165 | 336 |
| 5. | Elidjon Cami | Master | Pedagog | 195 | 276 |
| 6. | Elona Hasmuja | Doktor | Pedagog | 165 | 282 |
| 7. | Fatbardha Osmanaga | Prof.as.dr | Zv. Dekan | 90 | 241 |
| 8. | Galzvinda Biba | Doktor | Pedagog | 165 | 275 |
| 9. | Jonida Lesha | Doktor | Pedagog | 165 | 291 |
| 10. | Lediana Xhakollari | Doktor | Pedagog | 165 | 206 |
| 11. | Visar Dizdari | Doktor | Drejt dep. | 90 | 210 |

Departamenti i Mësuesisë

| Nr. | Emri Mbiemri | Titulli | Pozicioni | Norma/orë | Realizimi |
|-----|----------------------------|----------|------------|-----------|-----------|
| 1. | Andi Hila | Master | Pedagog | 195 | 404 |
| 2. | Arlinda Ymeri | Doktor | Pedagog | 165 | 326 |
| 3. | Eranda Halluni (Bilali) | Doktor | Drejt dep. | 90 | 274 |
| 4. | Fatmir Vadohej | Prof. dr | Dekan | 70 | 304 |
| 5. | Megi Vjerdha | Master | Pedagog | 195 | 371 |
| 6. | Pranvera Puka (Kraja) | Doktor | Pedagog | 165 | 348 |
| 7. | Rina Muka (Gera) | Doktor | Pedagog | 165 | 331 |
| 8. | Roland Guli | Docent | Pedagog | 165 | 305 |

Departamenti i Edukimit Fizik dhe Sporte

Falë bashkëpunimit me universitetet e huaja kanë përfitur edhe studentët. FGJH nënvizon se gjatë vitit akademik 2021-2022 përfituan bursa studimi në kuadrin e projektit Erasmus + 3 studentë të vitit të dytë të programit të studimit Bachelor në Gjuhë italiane pranë Universitetit të Mesinës, Itali. Gjithashtu, dy studente të programit të studimit Gjuhë frënge fituan një stazh në përkthim pranë shoqatës së mësuesve të gjuhës frënge dhe një qëndrim në Bukuresht me rastin e Festivalit të studentëve frëngjishtfolës, të ofruar nga AUF. Pesë studentëve të departamentit të Gjermanistikës iu akorduan bursa studimi mbështetur nga DAAD për shkollën verore të organizuar nga Universiteti Vechta, në Gjermani. Dy studente të FSHN-së kanë ndjekur studimet për një ose dy semetra në Itali në kuadrin e marrëveshjes midis Universitetit të Shkodrës dhe Universitetit të Bolonjës, Itali (Programi Erasmus + Mobility)

Në kuadrin e bashkëpunimit me universitetet e tjera të Shqipërisë, Departamenti i Gjuhës Angleze ka vazhduar bashkëpunimin me Universitetin e Korçës duke marrë pjesë si bashkëorganizator në konferencën ndërkombëtare të organizuar nga Universiteti "Fan Noli" Korçë.

Sa u përket bashkëpunimeve FGJH citon disa përvoja. Departamenti i Romanistikës ka vazhduar zbatimin e projektit: *Hartimi, përgatitja dhe vënia në zbatim e programit të ri të studimit Bachelor në "Gjuhë të Huaja për fushën e Turizmit"*, të financuar nga Agjencia Universitare e Frankofonisë me qëllim përfitimin nga përvoja franceze në këtë fushë si dhe zhvillimin e kurrikulës për programin e studimit Bachelor "Gjuhë të huaja për turizmin". Publikimet në Internet i kanë shërbyer ndërgjegjësimit të publikut universitar/mjedisit profesional mbi sfidat e formimeve multidisiplinare, shkëmbimit të përhershëm dhe bashkëpunimit me mjedisin profesional me synim një integrim më të mirë profesional të të rinjve të diplomuar, promovimit të formimeve në gjuhën frënge/në gjuhë të huaja, promovimit të gjuhës frënge si gjuhë shkëmbimi dhe mobiliteti, promovimit të misionit dhe veprimtarisë së AUF si dhe promovimit të Universitetit të Shkodrës në mjedisin frankofon.

Në nivel njësie bazë, në raport përmenden aktivitetet midis Departamentit të Romanistikës dhe atij të Gjermanistikës me fokus studentët si dhe bashkëpunimin për zhvillim kurrikulash dhe programesh mësimore. Në kuadrin e muajit të përkthimit, ky fakultet ka organizuar veprimtari



bashkë me Bibliotekën shkencore të USH-së. Prania e lektoreve austriake në Departamentin të Gjermanistikës është fryt i marrëveshjeve të FGJH-së me Ministrinë e Arsimit të Republikës Austriake.

Një aspekt i rëndësishëm i bashkëpunimit ndërinstitucional është edhe shfrytëzimi i tij për zhvillimin e praktikave mësimore dhe profesionale. Shumë nga programet e studimit që ofron USH kërkojnë zhvillimin e praktikave profesionale dhe internshipeve pranë institucioneve dhe organizatave të ndryshme qeveritare apo joqeveritare. Për këtë, departamentet shfrytëzojnë marrëveshjet e nënshkruara me institucionet e ndryshme publike dhe private në nivel universiteti si dhe marrëveshjet e nënshkruara nga vetë ato.

FE citon marrëveshjen ndërmjet USH-së dhe ISAG - European Business School, si dhe Projektit Erasmus+ në shërbim të procesit mësimor. Në sajë të bashkëpunimit me Universitetet Hoëest dhe HoGent të Belgjikës, Departamenti i Turizmit, ka realizuar një aktivitet të përbashkët në kuadër të lëndës Menaxhim Udhëtues: 36 studentë nga Belgjika së bashku me 12 studentë nga Shkodra, nën kujdesin e pedagogëve nga Belgjika dhe Shkodra, sollën paketa konkrete, produkte turistike inovative në fushën e turizmit. Po kështu ka vazhduar bashkëpunimi me profesoratit e 11 departamenteve që mbështesin Doktoratën në “Ekonomi dhe Turizëm i qëndrueshëm” me ekspertizë dhe udhëheqje shkencore të doktorantëve. Shumë i rëndësishëm ka qenë edhe bashkëpunimi me institucionet publike lokale, komunitetin e biznesit dhe OJF-të në realizimin e praktikave mësimore.

Frut i bashkëpunimeve të suksesshme në funksion të përmirësimit të cilësisë së mësimdhënies janë edhe leksionet dhe seminarët e hapura të organizuara në disa fakultete të USH-së.

Departamenti i Romanistikës i FGJH-së ka organizuar 3 leksione të hapura nga programi i studimit Gjuhë italiane dhe 2 nga programi i studimit Gjuhë frënge: leksioni i mbajtur nga prof.as.dr. Alma Hafizi në kuadër të aktivitetëve për 700 vjetorin e vdekjes së Dante Alighierit, leksionet e Prof. Graziella Parati, Darmouth College dhe Prof.assoc. Lidia Radia University Richmond, USA me temë: “Italia e imMigrazioni: La diaspora albanese nei racconti degli scrittori transnazionali”, leksioni i mbajtur nga Dr. Lindita Kazazi për tematikën e Covid-it si dhe leksionet e Dr. Drita Brahimë dhe Dr. Gëzim Puka në lidhje me shkrimtarin francez Molier.

Në raportin e FE-së citohen disa përvoja: leksioni i hapur në fushën e marketingut digjital nga lektorja PhD. Marcia Monteiro – nga ISAG në Portugali si dhe leksionet në fushën bankare të mbajtur nga z. Fiqiri Baholli dhe Z. Fatjon Ademi në bashkëpunim me pedagogun Dr. Peter Saraci, seminari i hapur me specialistin e strategjive të turizmit në vendin tonë Z. Luan.Dervishaj nga GIZ , fokus grupi i organizuar nga pedagogia Dr. Alkida Hasaj me studentë dhe të ftuar, aktorë të interesit dhe specialistë në fushën e turizmit të qëndrueshëm.

Në funksion të përmirësimit të kurrikulës së Masterave profesionale të mësuesisë, Universiteti i Shkodrës po bashkëpunon aktualisht me universitetet e tjera brenda vendit, konkretisht të Tiranës, Elbasanit, Durrësit, Korçës e Vlorës me synimin që të përafrohet më shumë kurrikula dhe të krijohet një program i përbashkët në masën 80%. Të gjithë universitetet synojnë që kurrikula e përbashkët të aplikohet në vitin akademik 2023-2024.

10-TË DHËNA MBI STUDENTËT:



a. Numri i përgjithshëm i studentëve të regjistruar dhe atyre të diplomuar

Bazuar në raportin e të dhënave identifikuese numri i studentëve që kanë ndjekur studimet në Universitetin e Shkodrës “Luigj Gurakuqi” për vitin akademik 2021-2022 ka qenë **5404**.

Kanë marrë pjesë në provime,*(studentë aktivë), 3003 studentë në programet Bachelor, 322 studentë në Master shkencor, 705 studentë në Master profesional dhe 75 studentë në programet me karakter profesional. Janë diplomuar 808 studentë në programet e studimit Bachelor, 140 studentë në Master shkencor, 322 studentë në Master profesional dhe 29 studentë në programet me karakter profesional.

b. Përqindja e studentëve kalues në vit, përqindja e atyre që diplomohen sipas niveleve dhe programeve të studimit

Tabelë nr 6. Rezultatet e kalueshmërisë 2021 – 2022, Bachelor

| Fakulteti /Emërtimi i Programit të Studimit | Numri i studenteve aktiv | Numri i studentëve të rregullt | Kaluan | Përqindja | Diplomuar | Te regjistruar |
|---|--------------------------|--------------------------------|--------|-----------|-----------|----------------|
| 1. Fakulteti Ekonomik | | | | | | |
| FINANCË-KONTABILITET | | | | | | |
| Viti 1 | 97 | 91 | 87 | 95,60% | | 1 |
| Viti 2 | 93 | 81 | 75 | 92,59% | | 4 |
| Viti 3 | 134 | 85 | 55 | 64,71% | 88 | 2 |
| ADMINISTRIM-BIZNES | | | | | | |
| Viti 1 | 111 | 103 | 76 | 73,79% | | 2 |
| Viti 2 | 71 | 81 | 66 | 81,48% | | 5 |
| Viti 3 | 127 | 89 | 57 | 64,04% | 57 | 3 |
| TURIZËM | | | | | | |
| Viti 1 | 52 | 48 | 34 | 70,83% | | 3 |
| Viti 2 | 57 | 52 | 41 | 78,85% | | 2 |
| Viti 3 | 81 | 56 | 48 | 85,71% | 48 | 1 |
| 2. Fakulteti i Shkencave të Edukimit | | | | | | |
| MËSUESI PËR ARSIMIN FILLOR | | | | | | |
| Viti 1 | 18 | 14 | 13 | 92,86% | | |
| Viti 2 | 16 | 14 | 12 | 85,71% | | 1 |
| Viti 3 | 42 | 15 | 12 | 80,00% | 20 | |
| MËSUESI PËR ARSIMIN PARASHKOLLOR | | | | | | |
| Viti 1 | 16 | 16 | 12 | 75,00% | | |



| | | | | | | |
|--|-----|-----|----|---------|----|---|
| Viti 2 | 12 | 12 | 10 | 83,33% | | |
| Viti 3 | 26 | 7 | 7 | 100,00% | 24 | |
| PSIKOLOGJI | | | | | | |
| Viti 1 | 38 | 38 | 36 | 94,74% | | 1 |
| Viti 2 | 32 | 30 | 24 | 80,00% | | |
| Viti 3 | 30 | 20 | 12 | 60,00% | 21 | |
| PUNË SOCIALE | | | | | | |
| Viti 1 | 62 | 59 | 47 | 79,66% | | 2 |
| Viti 2 | 49 | 47 | 38 | 80,85% | | |
| Viti 3 | 73 | 43 | 31 | 72,09% | 48 | |
| EDUKIMI FIZIK DHE SPORTE | | | | | | |
| Viti 1 | 120 | 118 | 92 | 77,97% | | 3 |
| Viti 2 | 70 | 67 | 61 | 91,04% | | |
| Viti 3 | 90 | 77 | 43 | 55,84% | 51 | |
| PIKTURË DHE GRAFIK | | | | | | |
| Viti 1 | 25 | 25 | 22 | 88,00% | | |
| Viti 2 | 19 | 19 | 15 | 78,95% | | |
| Viti 3 | 30 | 27 | 20 | 74,07% | 27 | |
| PEDAGOGJI MUZIKORE | | | | | | |
| Viti 1 | 9 | 9 | 8 | 88,89% | | |
| Viti 2 | 8 | 8 | 7 | 87,50% | | 1 |
| Viti 3 | 15 | 13 | 9 | 69,23% | 13 | |
| 3. Fakulteti i Shkencave të Natyrës | | | | | | |
| BIOLOGJI -KIMI | | | | | | |
| Viti 1 | 9 | 8 | 8 | 100,00% | | |
| Viti 2 | 8 | 8 | 8 | 100,00% | | |
| Viti 3 | 24 | 10 | 8 | 80,00% | 18 | |
| INFORMATIKË | | | | | | |
| Viti 1 | 52 | 48 | 37 | 77,08% | | 1 |
| Viti 2 | 31 | 28 | 27 | 96,43% | | |
| Viti 3 | 35 | 23 | 19 | 82,61% | 31 | |
| MATEMATIKË | | | | | | |
| Viti 1 | 5 | 4 | 3 | 75,00% | | |
| Viti 2 | 9 | 7 | 5 | 71,43% | | |
| Viti 3 | 22 | 12 | 8 | 66,67% | 11 | |
| FIZIKË | | | | | | |
| Viti 1 | 6 | 6 | 4 | 66,67% | | |
| Viti 2 | 21 | 1 | 1 | 100,00% | | |
| Viti 3 | 7 | 0 | 0 | | 6 | |



| | | | | | | |
|---|-----|-----|-----|---------|-----|----|
| INFERMIERI E PËRGJITHSHME | | | | | | |
| Viti 1 | 109 | 109 | 104 | 95,41% | | 0 |
| Viti 2 | 109 | 109 | 104 | 95,41% | | 1 |
| Viti 3 | 141 | 125 | 72 | 57,60% | 104 | 0 |
| INFERMIERI - MAMI | | | | | | |
| Viti 1 | 79 | 79 | 76 | 96,20% | | 16 |
| Viti 2 | 38 | 37 | 37 | 100,00% | | 0 |
| Viti 3 | 81 | 54 | 39 | 72,22% | 64 | 0 |
| FIZIOTERAPI | | | | | | |
| Viti 1 | 80 | 80 | 72 | 90,00% | | 6 |
| Viti 2 | 34 | 33 | 33 | 100,00% | | 0 |
| Viti 3 | 55 | 33 | 27 | 81,82% | 34 | 0 |
| 4. Fakulteti i Shkencave Shoqërore | | | | | | |
| GJUHË-LETËRSI | | | | | | |
| Viti 1 | 11 | 10 | 7 | 70,00% | | |
| Viti 2 | 8 | 8 | 8 | 100,00% | | |
| Viti 3 | 41 | 7 | 6 | 85,71% | 31 | |
| GAZETARI DHE KOMUNIKIM | | | | | | |
| Viti 1 | 10 | 10 | 7 | 70,00% | | |
| Viti 2 | 21 | 19 | 15 | 78,95% | | |
| Viti 3 | 32 | 12 | 5 | 41,67% | 14 | |
| HISTORI | | | | | | |
| Viti 1 | 0 | 0 | 0 | | | |
| Viti 2 | 2 | 2 | 2 | 100,00% | | |
| Viti 3 | 30 | 3 | 3 | 100,00% | 20 | |
| GJEOGRAFI | | | | | | |
| Viti 1 | 0 | 0 | 0 | | | |
| Viti 2 | 3 | 3 | 3 | 100,00% | | |
| Viti 3 | 38 | 6 | 4 | 66,67% | 31 | |
| Histori e trashëgimi kulturore | | | | | | |
| Viti 1 | 18 | 18 | 16 | 88,89% | | |
| Viti 2 | | | | | | |
| Viti 3 | | | | | | |
| 5. Fakulteti i Gjuhëve të Huaja | | | | | | |
| GJUHË ITALIANE | | | | | | |
| Viti 1 | 10 | 10 | 7 | 70,00% | | 1 |
| Viti 2 | 7 | 7 | 6 | 85,71% | | |



| Viti 3 | 7 | 2 | 0 | 0,00% | 2 | | | | | | | | | | | | | |
|---|-----|-------------------------|----------------------------|---------|-----|----|--|--|-------------------------|----------------------------|--|--|-------------|------------|--|--|--|------------|
| GJUHË GJERMANE | | | | | | | | | | | | | | | | | | |
| Viti 1 | 8 | 7 | 4 | 57,14% | | 1 | | | | | | | | | | | | |
| Viti 2 | 12 | 11 | 9 | 81,82% | | | | | | | | | | | | | | |
| Viti 3 | 7 | 3 | 3 | 100,00% | 6 | | | | | | | | | | | | | |
| GJUHË FRËNGE | | | | | | | | | | | | | | | | | | |
| Viti 1 | 6 | 6 | 5 | 83,33% | | | | | | | | | | | | | | |
| Viti 2 | 3 | 2 | 2 | 100,00% | | | | | | | | | | | | | | |
| Viti 3 | 4 | 2 | 0 | 0,00% | 2 | | | | | | | | | | | | | |
| GJUHË ANGLEZE | | | | | | | | | | | | | | | | | | |
| Viti 1 | 51 | 45 | 37 | 82,22% | | 1 | | | | | | | | | | | | |
| Viti 2 | 39 | 34 | 23 | 67,65% | | | | | | | | | | | | | | |
| Viti 3 | 57 | 24 | 16 | 66,67% | 37 | 1 | | | | | | | | | | | | |
| 6. Fakulteti Drejtësisë | | | | | | | | | | | | | | | | | | |
| DREJTËSI (Bachelor) | | | | | | | | | | | | | | | | | | |
| Viti 1 | | | | | | 10 | | | | | | | | | | | | |
| Viti 2 | 58 | 58 | 20 | 34,48% | | 6 | | | | | | | | | | | | |
| Viti 3 | 193 | 66 | 26 | 39,39% | 106 | 4 | | | | | | | | | | | | |
| Program i integruar i ciklit të dytë | | | | | | | | | | | | | | | | | | |
| Viti 1 | 96 | 84 | 46 | 54,76% | | 12 | | | | | | | | | | | | |
| Viti 2 | 54 | 54 | 47 | 87,04% | | 27 | | | | | | | | | | | | |
| <table border="1" style="margin-left: auto;"> <thead> <tr> <th colspan="2"></th> <th style="text-align: center;"><i>Te diplomuar</i></th> <th style="text-align: center;"><i>Të çregjistruar</i></th> </tr> </thead> <tbody> <tr> <td colspan="2">Numri i studentëve aktiv në total</td> <td style="text-align: center;">3404</td> <td style="text-align: center;">914</td> </tr> <tr> <td colspan="2"></td> <td></td> <td style="text-align: center;">118</td> </tr> </tbody> </table> | | | | | | | | | <i>Te diplomuar</i> | <i>Të çregjistruar</i> | Numri i studentëve aktiv në total | | 3404 | 914 | | | | 118 |
| | | <i>Te diplomuar</i> | <i>Të çregjistruar</i> | | | | | | | | | | | | | | | |
| Numri i studentëve aktiv në total | | 3404 | 914 | | | | | | | | | | | | | | | |
| | | | 118 | | | | | | | | | | | | | | | |

Tabelë nr 7. Rezultatet e kalueshmërisë 2021 - 2022 Master Shkencor

| Fakulteti /Emërtimi i Programit të Studimit | Numri i studenteve aktiv | Numri i studentëve të rregullit | Kaluan | Përqindja | Diplomuar | Të çregjistruar |
|---|--------------------------|---------------------------------|--------|-----------|-----------|-----------------|
| 1. Fakulteti i Shkencave Shoqërore | | | | | | |
| Gjeografi regjionale në Gjeografi MSH | | | | | | |
| Viti 1 | 18 | 18 | 16 | 89% | | 1 |



| | | | | | | |
|--|----|----|----|------|----|---|
| Viti 2 | 18 | 14 | 7 | 50% | 9 | 0 |
| 2. Fakulteti i Shkencave të Natyrës | | | | | | |
| 1. Biologji mjedisore MSH | | | | | | |
| Viti 1 | 15 | 15 | 15 | 100% | | |
| Viti 2 | 19 | 18 | 11 | 61% | 12 | |
| 3. Fakulteti Ekonomik | | | | | | |
| 1. Menaxhim i Turizmit të qëndrueshëm MSH | | | | | | |
| viti 1 | 30 | 28 | 27 | 96% | | 1 |
| viti 2 | 20 | 17 | 17 | 100% | 17 | |
| 2. Administrim Biznesi MSH | | | | | | |
| viti 1 | 13 | 12 | 12 | 100% | | |
| viti 2 | 23 | 14 | 12 | 86% | 12 | |
| 3. Financë MSH | | | | | | |
| viti 1 | 16 | 16 | 16 | 100% | | |
| viti 2 | 26 | 20 | 18 | 90% | 24 | |
| 4. Kontabilitet MSH | | | | | | |
| viti 1 | 20 | 20 | 20 | 100% | | |
| viti 2 | 21 | 20 | 20 | 100% | 21 | |
| 4. Fakulteti i Shkencave të Edukimit | | | | | | |
| 1. Master i Shkencave në Psikologji | | | | | | |
| - Psikologji Organizative MSH | | | | | | |
| viti 1 | 12 | 12 | 12 | 100% | | |
| viti 2 | 28 | 18 | 18 | 100% | 20 | |
| - Psikologji Klinike MSH | | | | | | |
| viti 1 | 11 | 11 | 11 | 100% | | |
| viti 2 | 22 | 19 | 15 | 79% | 15 | |
| 2. Master shkencor në Mësuesi | | | | | | |
| Biologji - Kimi me profil minor në "Karriera dhe Aftësimi për jetën" | | | | | | |
| viti 1 | 0 | 0 | 0 | | | |
| viti 2 | 10 | 8 | 8 | 100% | 10 | |
| 6. Fakulteti i Drejtësisë | | | | | | |
| E drejte kushtetuese dhe administrative | | | | | | |
| Viti 1 | 65 | 58 | 58 | 100% | | |
| Viti 2 | 69 | 59 | 29 | 49% | 29 | |
| E drejta private dhe e biznesit | | | | | | |
| Viti 1 | 35 | 32 | 32 | 100% | | |
| Viti 2 | 16 | 12 | 12 | 100% | 12 | |



| | |
|-----------------------------------|-----|
| Numri i studentëve aktiv në total | 507 |
|-----------------------------------|-----|

| | |
|---------------------|------------------------|
| <i>Te diplomuar</i> | <i>Te çregjistruar</i> |
| 181 | 2 |

Tabelë nr 8. Rezultatet e kalueshmërisë 2021 – 2022, Master Profesional

| I. FAKULTETI SHKENCAVE SHOQERORE | Numri i studenteve aktiv | Numri i studentëve te rregullt | Kaluan | Përqindja | Diplomuar | Te çregjistruar |
|---|---------------------------------|---------------------------------------|---------------|------------------|------------------|------------------------|
| 1. Mësuesi në Gjuhë -Letërsi MP | | | | | | |
| viti 1 | 30 | 30 | 30 | 100% | | |
| viti 2 | 42 | 41 | 36 | 88% | 37 | |
| 2. Mësuesi në Histori-Gjeografi MP | | | | | | |
| viti 1 | 23 | 23 | 21 | 91% | | |
| viti 2 | 38 | 31 | 26 | 84% | 32 | 1 |
| 2. FAKULTETI I GJUHEVE TE HUAJA | | | | | | |
| 1. Mësuesi në Gjuhë Angleze MP | | | | | | |
| Viti 1 | 18 | 18 | 18 | 100% | | |
| Viti 2 | 26 | 25 | 14 | 56% | 14 | |
| 2. Mësuesi në Gjuhë Gjermane MP | | | | | | |
| Viti 1 | 10 | 10 | 10 | 100% | | |
| Viti 2 | 12 | 10 | 3 | 30% | 5 | |
| 3. Mësuesi në Gjuhë Italiane MP | | | | | | |
| Viti 1 | 11 | 11 | 11 | 100% | | |
| Viti 2 | 12 | 10 | 4 | 40% | 6 | |
| 4. Mësuesi në Gjuhë Frënge MP | | | | | | |
| Viti 1 | 10 | 10 | 10 | 100% | | |
| Viti 2 | 10 | 10 | 5 | 50% | 5 | |
| 3. FAKULTETI I SHKENCAVE TË EDUKIMIT | | | | | | |
| 1. Mësuesi në Edukim Fizik e Sporte MP | | | | | | |
| Viti 1 | 51 | 51 | 51 | 100% | | |



| | | | | | | |
|---|----|----|----|------|----|---|
| Viti 2 | 49 | 40 | 34 | 85% | 34 | 1 |
| 2. Mësuesi për Arsimiti fillor MP | | | | | | |
| Viti 1 | 27 | 27 | 27 | 100% | | |
| Viti 2 | 47 | 37 | 37 | 100% | 24 | |
| 3. Shërbimet sociale | | | | | | |
| Viti 1 | 21 | 21 | 12 | 57% | 12 | |
| 4. FAKULTETI EKONOMIK | | | | | | |
| 1. Trashëgimi Kulturor e Menaxhim Turizmi MP | | | | | | |
| viti 1 | 17 | 17 | 17 | 100% | | |
| viti 2 | 20 | 13 | 9 | 69% | 9 | |
| 2. Administrim-biznes MP | | | | | | |
| viti 1 | 10 | 10 | 10 | 100% | | |
| viti 2 | 21 | 14 | 12 | 86% | 12 | |
| 3. Financë - Bankë MP | | | | | | |
| viti 1 | 10 | 10 | 10 | 100% | | |
| viti 2 | 17 | 17 | 13 | 76% | 15 | |
| 4. FINAK MP | | | | | | |
| Viti 1 | 20 | 20 | 14 | 70% | 15 | |
| 5. FAKULTETI I SHKENCAVE TË NATYRËS | | | | | | |
| 1. Psikologji shëndeti MP | | | | | | |
| Viti 1 | 67 | 67 | 54 | 81% | 54 | |
| 2. Mësuesi në Matematikë - fizikë MP | | | | | | |
| viti 1 | 9 | 9 | 9 | 100% | | |
| viti 2 | 15 | 8 | 5 | 63% | 12 | |
| 3. Mësuesi në Matematikë me profil minor në Informatikë MP | | | | | | |
| viti 1 | 9 | 9 | 8 | 89% | | 1 |
| viti 2 | 22 | 22 | 20 | 91% | 20 | |
| 4. Mësuesi në Informatikë me profil minor në Matematikë MP | | | | | | |
| viti 1 | 7 | 7 | 6 | 86% | | 1 |
| viti 2 | 10 | 10 | 8 | 80% | 8 | |
| 5. Mësuesi në Biologji - Kimi MP | | | | | | |
| viti 1 | 5 | 5 | 5 | 100% | | |
| viti 2 | 9 | 9 | 8 | 89% | 8 | |



| | |
|-----------------------------------|-----|
| Numri i studentëve aktiv në total | 705 |
|-----------------------------------|-----|

| | |
|---------------------|------------------------|
| <i>Te diplomuar</i> | <i>Të çregjistruar</i> |
| 322 | 4 |

Tabelë nr 9. Rezultatet e kalueshmërisë 2021 – 2022, Programe me karakter Profesional

| 1. FAKULTETI SHKENCAVE SHOQERORE | Numri i studenteve aktiv | Numri i studentëve te rregullt | Kaluan | Përqindja | Diplomuar | Te çregjistruar |
|---|--------------------------|--------------------------------|--------|-----------|-----------|-----------------|
| 1. Udhërrëfyes turistik dhe menaxhues itinerareve turistike per rajonin verior | | | | | | |
| viti 1 | 25 | 25 | 12 | 48% | 12 | 1 |
| 2. FAKULTETI I SHKENCAVE TË NATYRËS | | | | | | |
| 2. Teknik sistemesh dhe rrjetesh kompjuterike | | | | | | |
| viti 1 | 30 | 30 | 30 | 100% | | |
| viti 2 | 20 | 20 | 17 | 85% | 17 | |

| | |
|-----------------------------------|----|
| Numri i studentëve aktiv në total | 75 |
|-----------------------------------|----|

| | |
|---------------------|------------------------|
| <i>Te diplomuar</i> | <i>Të çregjistruar</i> |
| 29 | 1 |

c. Numri i studentëve të shkëlqyer

Tabelë nr 10. Studentë me notë mesatare 9-10

Viti akademik 2021-2022



| Cikli i parë i studimeve | | |
|--|--|---|
| Nr | Njësia Kryesore / Emërtimi i programit të studimit | Numri i studentëve të diplomuar me notë mesatare 9-10 |
| Fakulteti Ekonomik | | |
| 1 | Financë- Kontabilitet | 5 |
| 2 | Administrim-Biznes | 4 |
| 3 | Turizëm | 1 |
| Fakulteti i Drejtësisë | | 0 |
| 4 | Drejtësi (cikël 5 vjeçar) Master i shkencave në drejtësi | |
| 5 | Drejtësi (3 vjeçar) | |
| Fakulteti i Shkencave të Edukimit | | 0 |
| 6 | Mësuesi për Arsimin Fillor | 1 |
| 7 | Mësuesi për Arsimin Parashkollor | 0 |
| 8 | Pedagogji muzikore | 2 |
| 9 | Pikturë dhe grafikë | 10 |
| 10 | Edukim Fizik dhe Sporte | 2 |
| 11 | Psikologji | 2 |
| 12 | Punë sociale | 2 |
| Fakulteti i Shkencave të Natyrës | | 0 |
| 13 | Matematikë | 0 |
| 14 | Informatikë | 1 |
| 15 | Fizikë | 0 |
| 16 | Biologji-Kimi | 3 |
| 17 | Infermieri e Përgjithshme | 10 |
| 18 | Fizioterapi | 1 |
| 19 | Infermieri - Mami | 1 |
| Fakulteti i Shkencave Shoqërore | | 0 |
| 20 | Gjuhë - Letërsi | 4 |
| 21 | Gazetari dhe Komunikim | 2 |
| 22 | Histori | 0 |
| 23 | Gjeografi | 4 |
| 24 | Histori dhe trashëgimi kulturore | 0 |
| Fakulteti i Gjuhëve të Huaja | | 0 |
| 25 | Gjuhë angleze | 0 |
| 26 | Gjuhë Italiane | 0 |



| | | |
|---------------|----------------|-----------|
| 27 | Gjuhë Frënge | 0 |
| 28 | Gjuhë Gjermane | 2 |
| Totali | | 57 |

| PROGRAMET ME KARAKTER PROFESIONAL | | |
|--|---|----------|
| 1 | Teknik sistemesh dhe rrjetesh kompjuterike (2 vjeçar) | 4 |
| 2 | Udhërrëfyes turistik dhe menaxhues i itinerareve turistike për rajonin verior (1 vjeçar) | 0 |
| Totali | | 4 |

| Cikli I dytë i studimeve | | | |
|---|---|-----------------|--|
| Nr. | Njësia Kryesore / Emërtimi i programit të studimit | Cikli II | Numri i studentëve të diplomuar me notë mesatare 9-10 |
| Fakulteti i Shkencave Shoqërore | | | |
| 1 | Studime të thelluara në gjuhësi | MSH | 0 |
| 2 | Etnokultura dhe letërsia shqipe | MSH | 0 |
| 3 | Studime Regjionale në Gjeografi | MSH | 2 |
| 4 | Mësuesi në Gjuhë - Letërsi | MP në Mësuesi | 6 |
| 5 | Mësuesi në Histori-Gjeografi | MP në Mësuesi | 1 |
| Fakulteti i Shkencave të Natyrës | | | |
| 1 | Psikologji shëndeti | MP | 3 |
| 2 | Biologji mjedisore | MSH | 3 |
| 3 | Mësuesi në Biologji - Kimi | MP në Mësuesi | 1 |
| 4 | Mësuesi në Matematikë - Fizikë. | MP në Mësuesi | 0 |
| 5 | Mësuesi në Informatikë me profil minor matematikë | MP në Mësuesi | 0 |
| 6 | Mësuesi në Matematikë me profil minor në informatikë | MP në Mësuesi | 4 |



| Fakulteti i Shkencave të Edukimit | | | |
|--|---|----------------|-----------|
| 1 | Mësuesi për arsimin fillor | MP në Mësuesi | 4 |
| 2 | Mësuesi në lëndët edukim fizik dhe sporte | MP në Mësuesi | 3 |
| 3 | Psikologji klinike | MSH | 3 |
| 4 | Psikologji organizative | MSH | 0 |
| 5 | Mësuesi në biologji - kimi me profil minor në karriera dhe aftësimi për jetën | MSH në Mësuesi | 4 |
| 6 | Shërbimet sociale | MP | 2 |
| Fakulteti Ekonomik | | | |
| 1 | Menaxhim i turizmit të qëndrueshëm | MSH | 3 |
| 2 | Administrim biznesi | MSH | 0 |
| 3 | Kontabilitet | MSH | 8 |
| 4 | Financë | MSH | 7 |
| 5 | Administrim – Bisnes | MP | 0 |
| 6 | Financë – Banke | MP | 1 |
| 7 | Trashegimi kulturore dhe menaxhim turizmi | MP | 0 |
| 8 | Menaxhimi Financiar, kontabiliteti dhe kontrolli ne administraten publike | MP | 2 |
| Fakulteti Gjuhëve të Huaja | | | |
| 1 | Mësuesi në gjuhë angleze | MP në Mësuesi | 3 |
| 2 | Mësuesi në gjuhë italiane | MP në Mësuesi | 0 |
| 3 | Mësuesi në gjuhë frënge | MP në Mësuesi | 0 |
| 4 | Mësuesi në gjuhë gjermane | MP në Mësuesi | 1 |
| Fakulteti i Drejtësisë | | | |
| 1 | E drejta private dhe e biznesit | MSH | 2 |
| 2 | E drejtë kushtetuese dhe administrative | MSH | 4 |
| Totali Cikli i II Universiteti i Shkodres | | | 67 |



| | | | |
|--|--|--|--|
| | | | |
|--|--|--|--|

d. Vlerësimi i përgjithshëm mbi cilësinë e studentëve dhe vlerësimi i rezultateve

Duke u bazuar në tabelat e mësipërme vërejmë se kalueshmëria e studentëve në disa programe studimi nuk është e kënaqshme. Megjithatë në statistikën e studentëve të shkëlqyer vihet re një motivim i madh në studentë të veçantë, të cilët kanë arritur rezultate mjaft të larta. Ashtu si në vitet e mëparshme, lëndët profesionale vlerësohen më shumë se ato të kulturës së përgjithshme. Në vitet e para të programeve Bachelor kalueshmëria është e ulët, ndërkohë që përmirësohet në vitet e dyta dhe të treta.

Vlerësimi i cilësisë së studentëve përbën një nga aspektet e rëndësishme të analizës vjetore. Po paraqesim në mënyrë të përmbledhur rezultatet e raporteve sipas fakulteteve.

FSHSH nënvizon se si rezultat i notës mesatare që po aplikohet në procesin e pranimeve të reja në programet e studimit të këtij fakulteti, cilësia e studentëve ka ardhur në rritje. Programet e studimit janë të konsoliduara prej vitesh dhe realizojnë me cilësi të gjitha objektivat e përcaktuara. Për sa i përket kualifikimit të mësimdhënësve, planeve mësimore, programeve të lëndëve, infrastrukturës etj., departamentet e **FSHSH-së** në përgjithësi i përmbushin të gjitha standardet akademike të parashikuara në legjislacionin në fuqi. Studentët e këtij fakulteti marrin formimin e duhur dhe të pritshëm në fushën e tyre profesionale dhe janë konkurrenues me të diplomuarit në programe të ngjashme studimi në universitetet e tjera të vendit. Programet e studimeve që mbulojnë departamentet e **FSHSH-së** synojnë të plotësojnë nevojat e tregut të punës, në përputhje me drejtimet strategjike të zhvillimit ekonomik, kombëtar e rajonal, ku përparësi kanë degët që zhvillojnë aftësi të aplikueshme në tregun e punës.

Lidhur me instrumentet e përdorura për vlerësimin e punës së bërë nga pedagogët (e brendshëm dhe të jashtëm), mund të theksohet se e një rëndësie të veçantë ka qenë tërheqja e mendimit të studentëve nëpërmjet pyetësorëve rreth nivelit të zhvillimit të leksioneve dhe seminareve, mënyrës së organizmit të provimeve, korrektësisë në zhvillimin e tyre etj. Përgjithësisht studentët vlerësojnë mënyrën e zhvillimit të mësimit, metodat e përdorura nga pedagogët, respektimin e orarit, qartësinë në përcjelljen e informacioneve, kuptueshmërinë e informacionit, vlerësojnë etikën e komunikimit, përdorimin e literaturës bashkëkohore dhe efektive, etj.. Ka shumë pak raste ku studentët shprehën për mënyrën jo korrekte të vlerësimit apo terminologjinë e përdorur nga pedagogu. Kuptohet që rezultatet e pyetësorëve janë marrë në konsideratë dhe janë bërë objekt diskutimi në departamente duke marrë edhe masat e duhura e përcaktuar edhe detyrat për të ardhmen. Vlerësimi i punës së pedagogëve nëpërmjet pyetësorëve është aplikuar edhe në FGJH dhe FSHSH. Pyetësorët e hartuar nga Njësia e Sigurimit të Brendshëm të Cilësisë bazohen tek Kodi i Cilësisë së Arsimit të Lartë.

Duke i konsideruar provimet si elementin kyç për vlerësimin e studentëve dhe si moment i kurorëzimit të punës së përbashkët pedagog – student, të gjitha departamentet e **FSHE-së** raportojnë se procesi i provimeve në përgjithësi është zhvilluar normalisht duke bërë kujdes në të gjitha aspektet. Ka patur një gadishmëri maksimale nga i gjithë stafi për të realizuar konsultimet dhe provimet. Sipas raportit të departamentit të Psikologjisë e Punës Sociale vlerësimi i studentëve është bërë në përputhje me programin e lëndës dhe Rregulloren e studimeve të Universitetit. Pjesa më e madhe e pedagogëve kanë përdorur sistemin e vlerësimit



40/60 (vlerësimi i vazhduar në seminare/vlerësimi përfundimtar). Forma më e përdorur e realizimit të provimit të kursit ka qenë ajo me shkrim me anë të testeve me pyetje të hapura dhe/ose të mbyllura. Departamenti i Arteve edhe gjatë vitit 2021-2022 ka vërejtur një vlerësim më të lartë në lëndët profesionale në raport me ato të kulturës së përgjithshme. Kalueshmëria në programin e studimit “Pikturë dhe grafikë” është 81% dhe kalueshmëria në programin e studimit “Pedagogji muzikore” 77%. Në raportin e departamentit të Mësuesisë theksohet se janë marrë masat që periudha e provimeve të jetë e organizuar sa më mirë duke vlerësuar të gjitha aspektet e këtij procesi të rëndësishëm sic janë oraret e provimeve, komisionet e provimeve dhe të sekretimit, tezat e provimit dhe vlerësimi i studentëve. Ky departament veçon rëndësinë e ballafaqimit me studentët pasi jo gjithnjë pedagogët janë të përpiktë me afatin e përcaktuar në rregulloren e studimeve. Departamenti i Edukimit Fizik dhe Sporteve evidentuar vështirësitë në vënien e notave në sistem që lidhen jo vetëm me funksionimin e sistemit “Pitagora” por edhe me vonesat e pajustificuara nga disa pedagogë të këtij departamenti si dhe ata të Shkencave të Natyrës.

Në **FGJH**, Departamenti i Romanistikës thekson frymën e bashkëpunimit student/pedagog, si në lidhje me procesin akademik, por edhe me aktivitetet kulturore dhe kërkimore jashtë këtij procesi. Vërehet një aktivizim i vazhdueshëm i studentëve gjatë orëve të seminareve dhe një përpjekje për përfshirje në mënyrë interaktive gjatë orëve të leksioneve, përfshirje kjo e bazuar në diskutime, në të menduarit dhe të zhvilluarit e ideve. Megjithatë, duhet theksuar se pedagogët e Romanistikës ndeshen me vështirësi të caktuara, të cilat lidhen me formimin gjuhësor të disa prej studentëve. Për këtë arsye pedagogët kanë këmbëngulur në realizimin e veprimtarive të caktuara mësimore që kanë patur si qëllim pikërisht qartësimin dhe përmirësimin e këtyre njohurive.

Për **FE** ndikimi i pandemisë pati efekt zinxhir në vitin 2021-2022 në uljen e numrit të studentëve të regjistruar në Bachelor dhe në vështirësitë e përqëndrimit të studentëve në mësim. Megjithatë, kalueshmëria për vitin akademik 2021-2022 ka qenë e mirë. Një tregues i rëndësishëm për të siguruar vazhdimësinë e studimeve në ciklin e dytë dhe të kontributit të DT në përgatitjen e kapaciteteve njerëzore të kualifikuara, është numri i studentëve të diplomuar në të dy ciklet e studimit. Kështu për vitin akademik 2021-2022 janë diplomuar 48 studentë në Bachelor në Turizëm. Po kështu në dy programet Master në Turizëm u diplomuan 26 studentë ndër të cilët 18 përgatitën temë diplome. Ndër 17 studentët e diplomuar në Master tre i përkasin kategorisë së studentëve ekselentë. **FE** evidenton përparësitë që ka sjellë futja e sistemit të Pitagorës i cili lehtëson procesin e regjistrimit të studentëve në provim dhe pasqyrimin e notave, por nuk lë pa përmendur edhe problemet teknike me të cilat janë përballur pedagogët dhe studentët.

Korigjimi i provimeve në kuadrin e projektit CleanScore, si proces i vlerësimit të studentëve, ka vazhduar edhe gjatë vitit 2021-2022. CleanScore ka për qëllim të zbatojë në universitete korigjimin e automatizuar të provimeve, duke rritur ndjeshëm transparencën në vlerësimin e studentëve. Në vijim po paraqesim disa statistika të përgatitura nga kordinatori i projektit, Z. Hysmir Idrizi.

Tabelë nr 11. Provime të korigjuara me CleanScore në vitin akademik 2021-2022



| Të dhënat | Total |
|---------------------|-------|
| Pedagogë | 35 |
| Provime | 110 |
| Fletë të korigjuara | 4333 |

| Fakulteti | Pedagogët (2022) |
|-----------------------------------|------------------|
| Fakulteti Ekonomik | 12 |
| Fakulteti i Shkencave të Edukimit | 8 |
| Fakulteti i Shkencave Shoqërore | 3 |
| Fakulteti i Drejtësisë | 2 |
| Fakulteti i Shkencave të Natyrës | 5 |
| Fakulteti i Gjuhëve të Huaja | 5 |

| Viti akademik | Provime | Pedagogë | Fletët e korigjuara |
|---------------|---------|----------|---------------------|
| 2020-2021 | 19 | 10 | 654 |
| 2021-2022 | 110 | 35 | 4333 |

Duke iu referuar të dhënave të mësipërme vëmë në dukje faktin se gjatë vitit 2021-2022 është rritur ndjeshëm numri i provimeve të korigjuara me CleanScore.

- e. Informacion mbi numrin e studentëve që kanë përfituar bursa numrin e atyre që kanë përfituar nga përjashtimi apo reduktimi i tarifave të shkollimit



| NR | Efektet e Vendimeve te Keshillit te Ministrave "Per studente tqe perfitojne bursa financiare . perjashtim apo reduktim nag tarifa vjetore e shkollimit per vitin akademik 2021-2022, sipas VKM si me poshte | Total Nr studente | Total efekti financiar (viti akademik 2021-2022) | Numri I studenteve me noten mesatare 9-10, qe perfitojne bursa financiare+perjashtim nga tarifa vjetore e shkollimit. Viti akademik 2021-2022 | Efekti financiar per studentet me note mesatare 9-10,bursa+tarifa vjetore e shkollimit. | Numri I studenteve nga kategorite sociale ne nevoje qe perfitojne burse+tarifa vjetore e shkollimit. | Efekti financiar ga kategorite sociale ne nevoje qe perfitojne burse+tarifa vjetore e shkollimit. (Viti akademik 2021-2022) |
|-------------|---|-------------------|---|---|---|--|---|
| | | A=C+E | B=D+F | C | D | E | F |
| a.1 bursat | Studente qe perfitojne bursa financiare sipas VKM nr. 903, date 21.12.2016, i ndryshuar me VKM nr. 39, date 23.1.2019. Me Vendim BA | 634 | 57,060,000 | 192 | 17,280,000 | 442 | 39,780,000 |
| a.2 bursat | Studente qe perfitojne bursa financiare sipas VKM nr. 903, date 21.12.2016, i ndryshuar me VKM nr. 39, date 23.1.2019., qe kanë paraqitur kerkesë në plotësim të kriterëve, në pritje të konfirmimeve nga institucionet përkatëse për të përfituar burse financiare | 10 | 900,000 | 0 | 0 | 10 | 900,000 |
| | Total Bursat 2021-2022 a1+ a2 | 644 | 57,960,000 | 192 | 17,280,000 | 452 | 40,680,000 |
| b.1 tarifat | Numri i studenteve qe perfitojne nga ulja/reduktimi me 50% i tarifës vjetore të shkollimit për vitin akademik 2021-2022 sipas VKM nr. 288 date 21.05.2018, i ndryshuar (Cikli i pare i studimeve) viti i parë, i regjistruar 2021-2022 | 848 | 9,390,000 | 848 | 9,390,000 | 0 | 0 |
| b.2 tarifat | Numri i studenteve qe perfitojne nga ulja/reduktimi me 50% i tarifës vjetore të shkollimit për vitin akademik 2021-2022 sipas VKM nr. 288 date 21.05.2018, i ndryshuar (Cikli I pare I studimeve) viti i dytë e viti tretë me mesatare mbi 6 | 720 | 7,960,000 | 720 | 7,960,000 | 0 | 0 |
| | Total b1+b2 | 1,568 | 17,350,000 | 1,568 | 17,350,000 | 0 | 0 |
| b.3 tarifat | Numri i studenteve qe perjashtohen nga tarifa vjetore e shkollimit (për vitin akademik 2021-2022) sipas VKM nr. 269, date 29.03.2017, i ndryshuar me VKM nr 40 date 23.01.2019 Me Vendim BA | 685 | 15,412,500 | 192 | 4,320,000 | 493 | 11,092,500 |
| b.4 tarifat | Numri i studenteve qe perjashtohen nga tarifa vjetore e shkollimit (për vitin akademik 2021-2022) sipas VKM nr. 269, date 29.03.2017, i ndryshuar me VKM nr 40 date 23.01.2019 qe kanë paraqitur kerkesë në plotësim të kriterëve, në pritje të konfirmimeve nga institucionet përkatëse në pritje për të përfituar përjashtim nga tarifa e shkollimit. | 10 | 225,000 | 0 | 0 | 10 | 225,000 |



| | Total b3+b4 | 695 | 15,637,500 | 192 | 4,320,000 | 503 | 11,317,500 |
|----------------|--|-------|------------|-------|------------|-------|------------|
| b.5 Tarifat | Numri i studentëve që përfitojnë reduktim me 50%, të tarifës vjetore të studimit, sipas Vendimit nr. 780, datë 26.12.2018 (Cikli i dytë i studimeve) | 201 | 6,633,000 | 71 | 2,343,000 | 130 | 4,290,000 |
| | Total b.5 | 201 | 6,633,000 | 71 | 2,343,000 | 130 | 4,290,000 |
| | Total b1+b2+b3+b4+b5 | 2,464 | 39,620,500 | 1,831 | 24,013,000 | 633 | 15,607,500 |
| | Shuma (a _bursat +b _Tarifat) | 3,108 | 97,580,500 | 2,023 | 41,293,000 | 1,085 | 56,287,500 |

11-PRITSHMËRITË DHE OBJEKTIVAT (PARASHIKIMET) PËR VITIN 2022-2023 NË LIDHJE ME MËSIMDHËNIEN, KËRKIMIN SHKENCOR DHE INOVACIONIN PËR SECILËN NJËSI

FSHE synon të shohë me prioritet:

- veprimtarinë kërkimore-shkencore e botuese;
- pjesëmarrjen në konferenca shkencore kombëtare e ndërkombëtare;
- pjesëmarrjen në projekte kërkimore;
- përfshirjen e studentëve në kërkimin shkencor;
- partneritetin e ngushtë me institucione kërkimore-shkencore, trajnuese, botuese, të shërbimeve psiko-sociale apo komunitare.

Departamenti i Psikologjisë dhe Punës Sociale ka marrë nismë për organizimin e Konferencës së 5^{të} shkencore “Arritjet dhe sfidat e profesionit të punës sociale në Shqipëri”, në periudhën Prill – Maj 2023 në bashkëpunim me departamentet homologe të UT dhe UE.

Departamenti i Arteve synon një pjesëmarrje më të madhe të pedagogëve dhe studentëve në jetën artistike qytetit e më tej.

Si pjesë e strategjisë afatmesme të FSHSH-së veçojmë qëllimin për konsolidimin dhe pasurimin e mëtejshëm të programeve të studimit, si në *bachelor*, ashtu edhe *master*. Për këtë është pasur parasysh :

- të punohet në mënyrë të vazhdueshme për forcimin cilësor të programeve ekzistuese të studimit, por edhe hapjen e programeve të reja të cilat duhet të jenë të orientuara drejt kërkesave të tregut të punës;
- të forcohet dhe të thellohet më tej puna mësimore, duke synuar modernizimin e saj;
- të rishikohen e të pasurohen më tej programet mësimore të çdo lënde, me qëllim përmirësimin dhe përditësimin e tyre;
- të përditësohen leksionet e shkruara në të gjitha lëndët, duke u bërë objekt diskutimi në njësitë bazë, në veçanti për pedagogët e rinj (në rastet kur për nevoja tepër të mëdha duhet të japin leksione, është e domosdoshme që leksionet e tyre të diskutohen paraprakisht në departament);



- të punohet për rihapjen e programit të studimit të ciklit të tretë Doktoraturë në “Gjuhë shqipe”, si dhe të punohet për hapjen e programeve të tjera të studimit në ciklin e tretë të studimeve.

FGJH ka këto pritshmëri dhe objektiva:

- zbatimin e mobilitetit të studentëve dhe të stafit akademik në kuadrin e projektit Erasmus + me Universitetin e Mesinës, Itali dhe krijimin e mundësisë për marrëveshje Erasmus + edhe me universitete të tjera të huaja;
- vazhdimin e zbatimit të projektit të financuar nga AUF: *Hartimi, përgatitja dhe vënia në zbatim e programit të ri të studimit Bachelor në "Gjuhë të Huaja për fushën e Turizmit"*;
- pjesëmarrjen në projektin READ;
- hartimin e projektit mbi lundrimet në pellgun e Adriatikut dhe të Mesdheut, në nivel departamenti, në kuadrin e projekteve të iniciuara nga CISVA, pjesë e së cilës është ky departament, me fokus Shqipërinë e veçanërisht Shkodrën;
- vazhdimin e mbajtjes së leksioneve të hapura si nga pedagogët e fakultetit ashtu edhe nga pedagogë të ftuar nga universitete të tjera shqiptare apo edhe të huaja;
- bashkëpunimin me Universitetin e Korçës me aktivitete të tjera shkencore, workshop-e apo konferenca;
- kualifikimin e stafit akademik me kohë të plotë në marrjen e titujve/gradave shkencore.

FSHN ka përcaktuar këto pritshmëri për 2022-2023:

- të insistohet në zbatimin me korrektësi të ligjeve, të rregulloreve dhe të urdhërave e udhëzimeve të MAS apo të Rektoratit, me qëllim përmirësimin e cilësisë së punës në të gjitha drejtimet;
- të përmirësohen në mënyrë të vazhdueshme metodat e kontrollit të njohurive të studentëve;
- të përfshihen studentët në projekte të përbashkëta kërkimore apo kontribute përmes aktiviteteve kulturore.

12- ANALIZA SWOT

Pika të forta

- Kredibiliteti institucional (Universiteti i Shkodrës është universitet i akredituar);



- Pozicioni gjeografik i përshtatshëm i institucionit (i vetmi universitet në trevat e Veriut);
- Programe bashkëkohore studimi të një cilësie të lartë, të cilat garantojnë përgatitjen e studentëve në përputhje me objektivat dhe profilin e përcaktuar, në përputhje me vizionin, misionin e Universitetit të Shkodrës, nevojat e tregut, objektivat e reformës së arsimit të lartë në vend dhe kanë të integruar përvojën më të mirë bashkëkohore të huaj dhe vendase;
- Staf akademik me grada e tituj shkencorë dhe me eksperiencë ndërkombëtare;
- Pjesëmarrja në vizita studimore dhe në shkëmbime me Universitete të huaja në kuadër të disa projekteve ndërkombëtare;
- Përfshirje e studentëve në mobilitete;
- Biblioteka shkencore e universitetit dhe ato të disa departamenteve ofrojnë një literaturë të pasur në gjuhën shqipe dhe të huaj;
- Transparencë dhe informacione të aksesueshme në faqen eeb publike të institucionit;
- Politika mbështetëse ndaj studentëve të kategorive sociale të veçanta;
- Organizim i mirë i praktikave mësimore dhe profesionale si aspekt i formimit profesional të studentëve;
- Marrëveshja ekzistuese me Universitetin e Vechta-s, Gjermani në kuadër të Erasmus +;
- Sistemi i automatizimit. Administrimi online i të dhënave nga njësitë kryesore rrit cilësinë e shërbimeve ndaj studentëve, si dhe transparencën ndaj tyre dhe stafit;
- Ekzistenca e disa institucioneve kryesore të qeverisjes qendrore dhe lokale (Bashki, AZHR etj.);
- Universiteti i Shkodrës si kontribues në zhvillimin ekonomik e rajonal të Shkodrës dhe më gjerë.

Pika të dobëta

- Rënia e numrit të regjistrimeve në programet e studimit të mësuesisë;
- Mosdhënia e mundësisë nga MASR për hapjen e programeve të reja në përputhje me nevojat e tregut dhe specifikat e rajonit të Shkodrës;
- Mungesa e buxhetit të mjaftueshëm (Fakultetet nuk kanë një buxhet të vetin);
- Vështirësi në përmirësimin e mëtejshëm të kushteve aktuale laboratorike e të mësimdhënies me risitë teknologjike;
- Botimi i monografive, artikujve në vende anëtare të OECD dhe BE dhe në revista të indeksuara në Scopus dhe Reuters Thompson;
- Pamjaftueshmëria e infrastrukturës dhe e logjistikës për studentët me aftësi të kufizuara;
- Mungesa e fondeve për të zhvilluar në një hapësirë më të gjërë praktikën në terren;
- Mungesa e formalizimit të marrëveshjeve ndër-institucionale me biznesin lokal;
- Raport jo i drejtë në disa programe studimi i pedagogëve me kohë të plotë me ata me kohë të pjesshme.

Barriera dhe rrisqe



- Mungesa e studimit të përhershëm të tregut të punës në përcaktimin e strategjive qoftë afatshkurtra apo afatgjata të programeve të studimit;
- Rënia e mundësive të punësimit të të diplomuarve sidomos të fushës së mësuesisë dhe për rrjedhojë rënia e interesit për regjistrimin e të rinjve në këtë fushë;
- Prirja e maturantëve për të vazhduar studimet universitare jashtë shtetit, gjë që sjell reduktimin e numrit të studentëve edhe në Universitetin e Shkodrës.

Mundësi

- Thellimi i bashkëpunimeve ndërkombëtare në drejtim të rritjes së aktivitetit kërkimor - shkencor dhe atij botues;
- Bashkëpunimi me universitetet e tjera kombëtare dhe ndërkufitare;
- Tërheqja e fondeve nga projektet e Bashkimit Europian dhe financimi nga projekte brenda dhe jashtë vendit;
- Zgjerimi i bashkëpunimit me organizatat e huaja qeveritare dhe joqeveritare që operojnë në vend;
- Programe shkëmbimi të stafit dhe studentëve me universitetet brenda dhe jashtë vendit;
- Mundësi për rritjen e bashkëpunimit me institucionet publike dhe private;
- Kthimi i disa fakulteteve në qendra trajnimi për të gjitha specialitetet që ofron;
- Mundësia e dhënies të mbështetjes financiare nga organizma qeveritare dhe joqeveritare për studentet me të mirë.

II-VEPRIMTARIA SHKENCORE

Fakulteti i Gjuheve të huaja

1. Objektivat e kërkimit shkencor dhe inovacionit për vitin akademik 2021- 2022 në përputhje me strategjinë e zhvillimit të institucionit.

FGJH ndjek vizionin kryesor të USH, atë të prodhimit të një kërkimi shkencor me standarde sa më të larta për të qënë i aftë të konkurrojë në shkallë kombëtare dhe ndërkombëtare. Qëllimi është përmirësimi dhe ngritja cilësore e punës kërkimore përmes vënies në jetë të metodologjive të reja si dhe pjesëmarrja aktive në programet, projektet dhe studimet kombëtare dhe ndërkombëtare.

Integrimi i punës kërkimore – shkencore me punën mësimore është padyshim një tjetër objektivi. Këto janë arritur nëpërmjet:

- nxitjes së veprimtarisë kërkimore-shkencore në fushat tradicionale dhe në ato që kanë një impakt të rëndësishëm në komunitet,
- nxitjes së vazhdueshme të kualifikimit shkencor të stafit akademik.
- krijimit të burimeve financiare duke marrë pjesë nëpër projekte kombëtare dhe ndërkombëtare bazuar në partneritet,



- përditësimin të njohurive dhe metodave të reja kërkimore me synim rritjen e cilësisë së kërkimit shkencor dhe vënien në shërbim të inovacionit si dhe mësimdhenërisë
- nxitjes së studentëve elitare për të marrë pjesë në projekte kombëtare apo ndërkombëtare.

2. Politikat e ndjekura për kërkimin shkencor.

Bashkëpunimet ndërinstitucionale qofshin këto kombëtare apo ndërkombëtare funksionojnë në sajë të respektimit të kontratave apo marrëveshjeve ndërinstitucionale. **Projektet e zbatuara dhe rezultatet e tyre, në nivel individual apo njësie.**

Bazuar në Ligjin Nr. 80/2015, "Për arsimin e lartë dhe kërkimin shkencor në Institucionet e Arsimit të Lartë në Republikën e Shqipërisë", neni 3 'Liria akademike dhe autonomia e institucioneve të arsimit të lartë,' në mbështetje pikës 3/a si dhe bazuar në Udhëzimin Nr. 52, dt. 3.12.2015, azhornuar me Udhëzimin nr. 5, dt. 16.02.2017, Udhëzimin nr. 11, dt. 10.04.2017, Udhëzimin nr. 20, dt. 22.09.2017 'Për përcaktimin e niveleve të gjuhëve të huaja dhe të testeve ndërkombëtare, për pranimet në programet e studimit të ciklit të dytë dhe të tretë, në IAL' në mbështetje pikës 4, të nenit 102, të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë, pikës 4, të nenit 76 dhe pikës 3, të nenit 78, të ligjit nr. 80/2015, "Për arsimin e lartë dhe kërkimin shkencor në Institucionet e Arsimit të Lartë në Republikën e Shqipërisë", Fakulteti i Gjuhëve të Huaja i Universitetit të Shkodrës 'Luigi Gurakuqi' kërkoi mbështetjen e SA të USH të *miratojë kërkesën e tij që të aplikojë në MAS si subjekt me qëllim njohjen e së drejtës për ofrimin e testeve* (ndër-)kombëtare në Republikën e Shqipërisë, për certifikimin e nivelit të njohjes së gjuhës së huaj sipas Kuadrit të Përbashkët Evropian të Referencave për Gjuhët. Zyrtarisht FGJH-së nuk i është përcjellë informacion mbi ecurinë e kësaj kërkesë.

Bazuar në ligjin nr. 80/2015 "Për Arsimin e Lartë dhe Kërkimin Shkencor në Institucionet e Arsimit të Lartë në Republikën e Shqipërisë", Udhëzimit nr.16 dt. 28.07.2021 "Për organizimin dhe funksionimin e sistemit të zhvillimit të vazhdueshëm profesional të punonjësve arsimorë", në përgjigje të njoftimit "Njoftim për paraqitjen e aplikimeve të agjensive trajnuese për trajnim të punonjësve arsimorë në sistemin e arsimit parauniversitar pranë komisionit ta akreditimit të programeve trajnuese (Faza I)", Fakulteti i Gjuhëve të Huaja Shkodër shprehu interesin për aplikim. Në përgjigje të këtij aplikimi u fitua e drejta për të qënë trajnuese ped. Dr. Ilda Erkoçi.

Periudha akademike 2021-2022 për **Departamentin e Romanistikës karakterizohet nga vullneti dhe këmbëngulja për bashkëpunime dhe projekte.** Është punuar me partnerë të huaj për vazhdimin e projektit nga AUF. Projekti i fituar e financuar nga AUF :*Hartimi, përgatitja dhe vënia në zbatim e Programit të ri të studimit : Bachelor në "Gjuhë të Huaja për fushën e Turizmit"*, prill 2021-qershor 2023 ka përfshirje të pedagogeve të të dy programeve Bachelor të departamentit të Romanistikës. Ky bashkëpunim ka sjellë eksperiencën franceze, konkretisht atë të Universitetit Haute Alsace në formimet universitare të orientuara drejt profesioneve;

- evidentimin e nevojës së universiteteve shqiptare për të implementuar formime të tilla me qëllim një punësim më të mirë të studentëve ;
- hapjen e universiteteve shqiptare drejt formimeve të tilla multidisiplinare;



- nevojën e rinovimit dhe zgjerimit të formimeve në gjuhën frënge/ në gjuhë të huaja me qëllim rritjen e numrit të studentëve ose përmbushjen e kërkesave/pritshmërive të studentëve për formime që sigurojnë një integrim më të mirë profesional ;
- nevojën imediate për forcim të marrëdhënieve universitet-biznes me qëllim zhvillimin e një metodologjie të qëndrueshme bashkëpunimi;
- rritjen e bashkëpunimit mes Universitetit dhe Zyrës së Punësimit Shkodër, me qëllim orientimin sa më të mirë të të rinjve të diplomuar drejt kërkesave të tregut të punës;
- rëndësinë e përgatitjes së studentëve me shumë aftësi për bizneset turistike dhe kulturore mbi të cilat bazohet ekonomia e rajonit me aktivitetet të madh ndërkufitar;

Departamenti i Gjermanistikës ka zhvilluar gjatë vitit akademik 2021-2022 projekte dhe aktivitete të organizuara me mbështetjen e stafit akademik dhe të studentëve të këtij departamenti si më poshtë vijon.:

- Në kuadër të ekspozitës speciale “Stefan Cvajg. Autori Botëror” me datë 24.03.2022 u zhvillua aktiviteti në formën e një Workshop me studentët e Departamentit të Gjermanistikës mbi temat qendrore të jetës dhe veprës së autorit austriak Stefan Cvajg. Një video me titra shqip u shfaq në Bibliotekën Austriake, ky aktivitet u drejtua dhe u organizua nga znj. Karoline Kuttner, lektore pranë këtij departamenti, mbështetur dhe nga përgjegjësjë e Bibliotekës Austriake në BUSH.
- Në kuadër të Javës Botërore të Librit u zhvillua takim letrar me autoren austriake znj. Andrea Grill dhe znj. Majlinda Cullhaj përkthyesja e romanit nga gjuha gjermane në gjuhën shqipe “Der gelbe Onkel”. Takim i drejtuar nga lektorja austriake dhe i integruar në procesin mësimor, ku studentët ishin tashmë të njohur me librin dhe me variantin e përkthyer, ku së bashku me to u diskutuan sfidat e përkthimit.
- Në kuadër të Javës Kulturore Austriake, Biblioteka Austriake në bashkëpunim me departamentin e Gjermanistikës organizuan me 19 tetor 2022 ligjeratën me temë “Kur gjyshja, Zoti dhe Britney u takuan në dhomën e ndenjes – ose Islami dhe unë” me prezencën e autorës austriake, me origjinë siriane, Luna Al-Mousli. Një ditë më parë u prezantuan pranë Kryeministrit, në Tiranë edhe përkthime të disa pjesëve të shkëputura nga ky libër, përkthime të realizuara nga tre studentë të Departamentit të Gjermanistikës.

3. Infrastruktura e përdorur në shërbim të kërkimit shkencor dhe të inovacionit.

Bibliotekat fizike (të departamenteve, BU, të qytetit), por edhe bibliotekat online, kërkimet në faqe të besueshme në web, bashkëpunimet dhe kontaktet me profesorë të huaj, janë burimet kryesore, të cilat stafi i FGJH-së i ka shfrytëzuar për të pasuruar fondet e shfrytëzuara për punën tij akademike dhe shkencore.

4. Përfshirja e studentëve në kërkimin shkencor, projektet kërkimore dhe botimet.

Studentët padyshim duhet të jenë në fokus të punës së përditshme.

Departamenti i Romanskistikës ka përfshirë studentët me pjesëmarrje në leksionet e hapura si dhe në projektin e financuar nga AUF.

Departamenti i Gjermanistikës në vazhden e aktiviteteve, synoi që të jenë studentët në qendër të veprimtarive. Kështu gjatë vitit akademik 2021-2022 janë për t'u renditur nga ky departament veprimtaritë e mëposhtme:



- 4 (katër) studentë nga viti i dytë pjesë në projektin

kërkimor 1 javor në Vechta të organizuar nga Universiteti i Vechta, Gjermani. Tematika e këtij projekti ishte 'Shumëgjuhësia'. Përveç anës teorike dhe qasjes ndaj metodave të mësimdhënies dhe të kërkimit shkencor Evropian, studentët hulumtuan për shumëgjuhësinë. Rezultatet e këtij projekti ata i prezantuan në qendër të qyetetit të Vechtës. Studentët u pajisën me certifikatën përkatëse.

- Në lëndën e përkthimit, studentë të talentuar dhe të mirëpërgatitur u përzgjedhën në përkthimin e disa pjesëve të shkëputura nga libri "Kur gjyshja, Zoti dhe Britney u takuan në dhomën e ndenjes – ose Islami dhe unë" të autores me origjinë siriane Luna Al-Mousli. Pjesët e përkthyer u prezantuan nga vetë studentët para një publiku të ftuar në Qendrën për Hapje dhe Dialog (Centre for Openness and Dialog), pranë Kryeministrisë.

- Në kuadër të javës kulturore austriake u zhvillua nga Ministria Federale e Arsimit dhe Shkencës së Austrisë si dhe me mbështetjen e shkollës teknike austriake „Peter Mahringer“ Shkodër Workshop-i për mësuesit aktualë të gjuhës gjermane dhe atyre të ardhshëm. Kështu në këtë Workshop u përfshinë edhe studentët, të cilin ndjekin programin e studimit të ciklit të dytë Master Profesional në Mësuesi në Gjuhë Gjermane. Workshop-e të njëpasnjëshme të cilat kishin si fokus qasjet në mësimdhënien e gjuhës gjermane si gjuhë të huaj, përkatësisht Workshop I: Bühne frei für Deutsch - Theater fördert Sprache dhe Workshop II: Erzähl' mir was! Theaterpädagogische Anregungen für die Arbeit mit Texten im DaF-Unterricht. Studentët u pajisën me certifikata.

Departamenti i Gjuhës Angleze Gjatë vitit akademik 2021-2022 bashkëpunimin me studentët e trajtoi vetëm brenda lëndëve mësimore me punime e prezantime modeste në nivelin Bachelor dhe punime më të thelluara shkencore në nivelin Master.

Në kuadër të Javës së Librit u organizua takimi me temë "Gjuha e kombeve n'gjuhën shqipe". Studentët e të tre Departamenteve lexuan dhe interpretuan pjesë në gjuhën origjinale dhe të përkthyer.

5. Kontributi i anëtarëve të stafit akademik në kërkim, zhvillim e transferim teknologjie si dhe veprimtari krijuese. Këtu mund të përfshihet kontributi me konsulencë e projekte komunitare për autoritetet lolale, shoqërinë civile, biznesin etj.

Falë bashkëpunimeve me Universitete të tjera brenda dhe jashtë vendit FGJH ka qënë bashkëorganizator duke u përfaqësuar me pedagogë në komitete shkencore për organizimin e konferencave shkencore ndërkombëtare.

Për t'u përmendur është bashkëpunimi për Konferencën ndërkombëtare organizuar nga Universiteti 'Fehmi Agani' Gjakovë, Konferenca ndërkombëtare organizuar nga Universiteti "F.Noli" Korçë dhe në Konferencën ndërkombëtare organizuar nga vetë USH me rastin e 65-vjetorit. Në kuadër të Javës së Librit u organizua në bashkëpunim me BUSH Shkodër takimi me temë "Gjuha e kombeve n'gjuhën shqipe". Të ftuar ishin profesorë nga Fakulteti i Gjuhëve të Huaja, të cilët janë marrë dhe merren me përkthimin e librave. U zhvilluan diskutime rreth eksperiencave dhe sfidave në përkthim. Në kudër të ditëve të hapura, anëtarë të stafit të tre Departamenteve u angazhuan të informojnë maturantë të shkollave të ndryshme mbi programet që ofron FGJH. Ditët e informimit përcaktohen dhe rregullohen nga MAS në bashkërenditje me ZAV.



Po në funksion të ditëve të hapura për informim në bashkëpunim me Tik Agency në rang universiteti pedagogë të FGJH-së morën pjesë në panairin informues Work & Study në rrethet Kukës, Lezhë. Takime informuese u realizuan edhe me iniciativën e vetë Departamenteve si në Koplik, Pukë, Hajmel, Ishull Lezhë, Lezhë.

Anëtarë të FGJH vazhdojnë të jenë të miratuar nga MAS si anëtarë të Komisionit të provimit të shtetit për profesionet e rregulluara.

Po ashtu disa anëtarë të stafit të FGJH-së vazhdojnë të kenë të drejtën e ushtrimit të funksionit përkthyes zyrtarë të autorizuar nga Ministria e Drejtësisë së Republikës së Shqipërisë.

Katër anëtarë të Departamentit të Romanistikës janë emëruar në ASCAL si ekspertë të jashtëm për akreditim të programeve të studimit të gjuhës italiane, gjuhës frënge dhe gjuhës spanjolle që ofrohen në FGJH Tiranë.

6. Produktet e kërkimit shkencor 2021-2022 për secilën njësi sipas tabelës së mëposhtme si dhe pritshmëritë dhe objektivat (parashikimet) për vitin 2022-2023 në lidhje me kërkimin shkencor dhe inovacionin

Pasqyrë përmblledhëse e veprimtarisë shkencore të Fakultetit të Gjuhëve të Huaja për periudhën Tetor 2021 – Shtator 2022

| r | Fakulteti | Monografi (te botuara) | Tekste universitare | Artikuj të botuar në revista shkencore brenda vendit | Artikuj të botuar në revista ndërkombëtare (me faktor impakti, SCOPUS, etj.) | Konferenca, kongrese brenda vendit (kumtesa të botuara) | Konferenca, kongrese jashtë vendit (kumtesa të botuara) | Veprimtari krijuese letrare, artistike etj. brenda e jashte vendit | Përkthime | Projekte shkencore brenda vendit | Projekte shkencore jashte vendit | Doktoratura (2021-2022) | Profesor i asociuar (2021-2022) | Profesor (2021-2022) |
|---|--------------------|------------------------|---------------------|--|--|---|---|--|-----------|----------------------------------|----------------------------------|--------------------------|---------------------------------|----------------------|
| | Dep.i Romanistikës | - | - | 1 (1 në pro | 7 (2 në proce | 1 (në proce | 9 (8 në proce | 6 | - | 2 | 1 | - | - | - |



| | | | ces boti mi) | s botim i) | botim i) | s botim i) | | | | | | | |
|-----------------------------|---|---|--------------------|------------------|-------------|------------------|----|---|---|---|---|---|---|
| Dep.i Gjermani stikës | - | - | - | 1 | 4 | 1 | 4 | - | - | 2 | - | - | - |
| Dep.i Gjuhës Angleze | - | - | - | 2 | 3 | 5 | 1 | - | - | - | 1 | - | - |
| Qendra | | | | | | | | | | | | | |
| SHUMA | | | 1 | 9 | 7 | 15 | 11 | | 1 | 3 | 1 | | |

Fakulteti i Shkencave të Edukimit

Raportimi për kërkimin shkencor.

1. Objektivat e kërkimit shkencor dhe inovacionit për vitin akademik 2021- 2022 në përputhje me strategjinë e zhvillimit të institucionit.

Për të përballuar sfidat e kohës, duke e vlerësuar arsimin e lartë si përgjegjësi publike, duke e konsideruar universitetin si një institucion që mbështetet në dy gjymtyrë të së njëjtës peshë e rëndësi: mësimdhënie dhe kërkim shkencor; FSHE ka patur në qendër të vëmendjes: integrimin e mësimdhënies me kërkimin shkencor, zhvendosjen e veprimtarisë kërkimore-shkencore në njësitë bazë (departamente);

përcaktimi i prioriteteve të kërkimit shkencor nga departamentet; përcaktimi i objektivave të veprimtarisë kërkimore të çdo anëtari të stafit akademik, duke synuar përputhjen e objektivave të kualifikimit shkencor vetjak me objektivat kërkimore-shkencore të departamentit/fakultetit, realizimi i artikujve shkencorë të botuar në revista shkencore kombëtare, ndërkombëtare, me faktor impakti, SCOPUS; pjesëmarrja në konferenca shkencore kombëtare, konferenca ndërkombëtare, konferenca të tjera, simpoziume, forume etj; pjesëmarrja në projekte kërkimore; përfshirja e studentëve në kërkimin shkencor, si kërkesë për formimin e tyre profesional dhe qytetar; etj.

Angazhimi në veprimtaritë kërkimore - shkencore dhe kualifikimi i vazhdueshëm janë pjesë e rëndësishme e punës së pedagogëve. Rritja e cilësisë së mësimdhënies në FSHE sigurisht që ka për bazë edhe arritjet në punët kërkimore - shkencore të realizuara nga pedagogët e këtij fakulteti.

Në raportin e departamentit të Psikologjisë e Punës Sociale thuhet se me rikthimin në normalitet, pas situatës së krijuar nga kufizimet për shkak të pandemisë së Covid – 19, edhe veprimtaria shkencore e pedagogëve të Departamentit Psikologji – Punë Sociale gjatë vitit akademik 2021 - 2022 ka njohur rritje, por pa rifituar ritmin e viteve para fillimit të pandemisë. Pedagogët kanë zhvilluar disa veprimtari kërkimore – shkencore, kryesisht pjesëmarrje në konferenca (me prezencë apo online) dhe botime në përmbushje të detyrimeve të tyre kontraktuale me Universitetin “Luigj Gurakuqi” Shkodër si dhe duke ndjekur objektivat e paravendosura në planin personal të punës shkencore.

Në departamentin e Arteve, kërkimi shkencor “konvertohet” kryesisht në veprimtari krijuese artistike. Siç reflektohet në tabelat përkatëse të aktivitetveve, pedagogët kanë qenë të angazhuar në pjesëmarrje në ekspozita në nivel lokal, kombëtar e ndërkombëtar.

Pedagogët e Departamentit të Mësuesisë gjatë vitit akademik 2021 - 2022 kanë zhvilluar një veprimtari të larmishme kërkimore – shkencore e artistike në përmbushje të detyrimeve të tyre kontraktuale me Universitetin “Luigj Gurakuqi” Shkodër si dhe duke ndjekur objektivat e paravendosura në planin personal të punës shkencore. Vlen të evidentohet se këtë vit në Departamentin e Mësuesisë janë botuar tre artikuj në revista Scopus, Dr Eranda Halluni 2 (dy) dhe Dr. Megi Shllaku 1 (një).



Edhe në departamentin e Edukimit Fizik e Sporte, pjesëmarrja në konferenca shkencore, botimet në nivele të ndryshme revistash ka qenë në rritje, por duke e krahasuar me pjesëmarrjen në aktivitete të ndryshme sportive, është me ulët. Kjo për vetë natyrën që ka ky program studimi.

2. Politikat e ndjekura për kërkimin shkencor.

Hapat e hedhur nga bashkëpunimi i Senatit Akademik të USH me bordin e Administrimit të USH lidhur me realizimin e pagesave për veprimtarinë shkencore të pedagogëve, jemi të mendimit se do të ndikojë dukshëm në rritjen sasiore dhe cilësore të kërkimit në USH.

3. Projektet e zbatuara dhe rezultatet e tyre, në nivel individual apo njësie.

Departamenti i Psikologjisë e Punës Sociale, gjatë vitit akademik 2021 – 2022, ka qenë pjesëmarrës në dy projekte kombëtare:

1. Hasmujaj, E. (2022). "Pathways to wellbeing, empowerment and resilience for adolescents and youth (Power 4 AY)" projekt i Save the Children. Projekti është lokalizuar në 3 rrethe të Shqipërisë (Elbasan, Shkoder dhe Diber).
2. Osmanaga F. (Korrik 2022). Pjesëmarrje në projektin "Baseline Study for Save the Children Albania Country Office Pathways to wellbeing, empowerment and resilience for adolescents and youth (Power 4AY)".

Ndërsa pjesëmarrja në projekte ndërkombëtare e stafit të DPPS ka qenë në katër projekte:

1. Osmanaga F. Anëtare e Projektit 3 vjeçar IDEA në kuadër të programit Erasmus "Capacity Building in the Higher Education" ku Universiteti i Shkodrës është pjesë e këtij projekti.
2. Osmanaga F. (22-28 maj 2022) Vizitë studimore në Universitetin e Zagrebit (Kroaci), Fakulteti i Edukimit, në kuadër të projektit Erasmus+, KA107.
3. Dizdari V. (25 – 29 PRILL 2022) Vizitë studimore në Universitetin Complutense të Madridit (Spanje), Fakulteti i Punës sociale, në kuadër të projektit Erasmus+, KA107.
4. Topalli B. (25 – 29 PRILL 2022) Vizitë studimore në Universitetin Complutense të Madridit (Spanje), Fakulteti i Punës sociale, në kuadër të projektit Erasmus+, KA107.

Në Departamentin e Arteve, Dr. Rubin Mandija dhe Prof. Nirvana Baja marrin pjesë në Projektin Erasmus+ REACH.

Prof. Markelian Kapidani merr pjesë në projektin N'Gen (Neë Generation) Muzikë Shqiptare e rarranxhuar Jazz; Latin Jazz etc (forma moderne të produksionit muzikorë).

Departamenti i Mësuesisë merr pjesë në 3 (tre) projekte ndërkombëtare si më poshtë:

1. Eranda Halluni Bilali: Symposium Concluding LECU-SINAN Symposium, November 1 to 3, 2021 Across Borders: Transcultural Experiences and Pedagogic Insights in Teacher Education Venue: Zurich University of Teacher Education (PHZH), LECU (Swiss-Albanian-Kosovan, Teacher education network) & SINAN (Swiss North African, Akademik Network) (dëshmi).
2. Pranvera Kraja: Projekti "IDEA" Inclusive tertiary Education in the West Balkan, Project Number: 618859-EPP-1-2020-1-AL-EPPKA2-CBHE-JP (co-funded by Erasmus+ Programme of European Council).
3. Rina Muka: Projekti "IDEA" Inclusive tertiary Education in the West Balkans, Project Number: 618859-EPP-1-2020-1-AL-EPPKA2-CBHE-JP (co-funded by Erasmus+ Programme of European Council).

Fakulteti i Shkencave të Edukimit në bashkëpunim me Qendrën e Studimeve Albanologjike dhe Fakultetin e Shkencave Shoqërore, organizuan konferencën shkencore me titull "Jehonë auditorësh" me rastin e 80-vjetorit të lindjes së Prof. Dr. Vehbi Hotit, (datë 17 Qeshor 2022).

Përsa i përket pjesëmarrjes në borde editoriale të revistave shkencore, pedagogët Prof. Dr. Fatmir Vadohej, Prof. as. dr. Fatbardha Osmanagaj, Dr. Eranda Halluni Bilali dhe Dr. Visar Dizdari dhe janë pjesë e bordit editorial të Buletinet Shkencor (Seria e Shkencave të Edukimit) të Universitetit të Shkodrës "Luigj Gurakuqi".



Dr. Eranda Halluni Bilali, Anëtare e bordit shkenor të konferencës së shkencave mjekësore teknike “Ecuria e kurrikulave të shkencave mjekësore teknike, impakti i tyre në sistemin shëndetësor”, Shkodër 24 - 25 qershor 2022.

Dr. Eranda Halluni Bilal, Anëtare e bordit editorial të VI International Scientific Conference “Developmental Perspectives of Social Sciences in Different Periods, Models and Alternatives”, 1 April 2022, Ulqin Montenegro.

Prof. Dr. Fatmir Vadohej, Dr. Eranda Halluni Bilali, Anëtarë të bordit shkencor të konferencës “Vlerësojmë të kaluarën, investojmë në të ardhmen, portrete të spikatura pedagogësh”, 7 mars 2022, Shkodër, Shqipëri.

Tabele përmblidhese e veprimtarisë shkencore të FSHE për periudhën akademike 2021-2022

| Nr. | Fakulteti i Shkencave të Edukimit | Monografi (te botuara) | Tekste universitare | Artikuj të botuar në revista shkencore brenda vendit | Artikuj të botuar në revista ndërkombëtare (me faktor impakti, SCOPUS, etj.) | Konferenca, kongrese brenda vendit (kumtesa të botuara) | Konferenca, kongrese jashtë vendit (kumtesa të botuara) | Veprimtari krijuese letrare, artistike etj. brenda e jashtë vendit | Përkthime | Projekte shkencore brenda vendit | Projekte shkencore jashtë vendit | Doktoratura (2020-2021) | Profesor i asociuar (2020-2021) | Profesor (2020-2021) |
|-----|-----------------------------------|------------------------|---------------------|--|--|---|---|--|-----------|----------------------------------|----------------------------------|-------------------------|---------------------------------|----------------------|
| 1. | Dep. i Mesuesisë | - | 1 | 4 | 3 | 17 | 18 | 9 | - | - | 3 | 1 | - | - |
| 2. | Dep. i Psik. e Punës soc | - | - | 4 | 4 | 8 | 3 | - | - | 2 | 4 | - | - | - |
| 3. | Dep. eduk. fizik | - | - | - | - | 6 | 2 | 3 | - | - | - | - | - | - |
| 4. | Dep i arteve | - | - | 1 | - | - | - | 19 | - | 3 | 2 | - | - | - |
| | Shuma | | 1 | 9 | 7 | 31 | 23 | | - | 5 | 9 | 1 | - | - |



Fakulteti i Shkencave Shoqërore

Njësitë bazë në përbërje të FSHSH, ashtu si çdo vit tjetër, në përgjithësi i kanë realizuar objektivat e punës shkencore që i kanë vënë vetes në vitin e kaluar. Sipas objektivave të vendosura, anëtarët e Departamenteve kanë punuar në këto drejtime kryesore:

1. Realizimi i *botimeve* në organe të ndryshme shkencore (brenda dhe jashtë vendit) dhe mbajtja *kumtesave* në konferenca shkencore (brenda dhe jashtë vendit).
2. *Udhëheqjeve* të studentëve në dy nivelet e studimit : Bachelor, Master Shkencor e Master Profesional, si dhe të *recensave* apo *oponencave* për tezat e diplomave.
3. Puna në shërbim të kualifikimit të mëtejshëm të stafit pedagogjik, si një element i rëndësishëm në rritjen e cilësisë së punës në departament, fakultet e universitet.
4. Puna si ekspertë të fushave përkatëse nëpërmjet pjesëmarrjes në projekte të ndryshme që gjejnë zbatim në rajon dhe më gjerë nga organizata qeveritare dhe jo-qeveritare apo nga institucionet vendore dhe qendrore etj.

Nga analizat e zhvilluara në të gjitha njësitë bazë u konstatua se është bërë një punë e mirë në drejtimet e lartpërmendura. Vlen të përmendet fakti se ka patur pjesëmarrje në trajnime specifike kualifikuese brenda e jashtë vendit, pjesëmarrje me kumtime në konferenca prestigjioze, si dhe projekte në terren.

Mund të konstatojmë gjithashtu që ka një rritje cilësore të botimeve, gjë që ndikon pozitivisht jo vetëm në formimin individual të pedagogëve, por edhe në rritjen e mundësive të bashkëpunimit me institucione homologe.

4. Politikat e ndjekura për kërkimin shkencor.

Stafi akademik i njësisë bazë të FSHSH është vazhdimisht në kërkim të përmirësimit të performancës së kërkimit shkencor, si element i rëndësishëm i përmirësimit edhe të cilësisë së mësimdhënies.

Duhet theksuar se këtë vit akademik, në zbatim të Vendimit të Senatit Akademik, nr. 301, datë 4 tetor 2021, “Për financimin e botimeve dhe pjesëmarrjes në konferenca shkencore të stafit akademik të Universitetit të Shkodrës “*Luigj Gurakuqi*””, ka pasur mbështetje financiare për pjesëmarrje në aktivitete shkencore jashtë vendit, çka ka ndikuar pozitivisht në rritjen e punës shkencore, përmes pjesëmarrjes së stafit akademik në përditësimin me të rejtat më të fundit të shkencës në fushat përkatëse, si dhe për zgjerimin e rrjetit të kontakteve me studiues të disiplinave të ngjashme shkencore.

Gjithashtu duhet theksuar se në kuadër të projektit shkencor “*Leksiku historik i gjuhës shqipe*” logjistika është përmirësuar ndjeshëm, kryesisht për QSA, ndonëse ka edhe vend për përmirësim të mëtejshëm edhe në njësitë e tjera bazë.

5. Projektet e zbatuara dhe rezultatet e tyre, në nivel individual apo njësie.

Pedagogët e FSHSH kanë hartuar projekte shkencore dhe janë gjithashtu të përfshirë në realizimin e projekteve shkencore brenda institucionit, por edhe jashtë tij.

QSA është duke punuar paralelisht në realizimin e disa projekteve shkencore :

1. “*Fjalori i plotë i nxjerrë nga shkrimet e Ndre Mjedës dhe rimari*” të prof. Kolë Ashtës. Libri është duke u faqosur dhe pret të shohë dritën e botimit.



2. Po punohet për përfundimin e projektit *“Kontribut me vlerë në fushë të albanologjisë (Kolë Thaçi)”*, i cili synon të rrisë bashkëpunimin brenda institucionit tonë, mbasi pjesë e projektit janë bërë edhe Fakulteti Ekonomik dhe ai Juridik.

Pjesëmarrje në projekte ndërkombëtare

- *Mimoza Priku & Rrezarta Draçini* - Pjesëmarrje në projektin ndërkombëtar “Valeu-x”, një bashkëpunim midis TUD (Gjermani), UET dhe USH.
- Elinda Ramadani merr pjesë në projektin USIA - PROJECT - projekt ndërkombëtar.
- Valbona Karakaçi ka marrë pjesë në një projekt në kuadër të programit CEEPUS CZ-0029-17-2122 për pedagogë vizitorë në Çeki. Koordinim dhe mundësim i mobiliteteve të mëposhtme CEEPUS CZ-0029-17-2122. Pedagogë vizitor: Rrezarta Murati dhe Merita Hysa, Babes Bolyai” Universiteti i Cluj-Napoca. Studentë vizitor: Kvak, Juraj, Matej Bel University Banská Bystrica, Faculty of Arts; Jakub Jurek, Palacký University Olomouc, Faculty of Arts

6. Infrastruktura e përdorur në shërbim të kërkimit shkencor dhe të inovacionit.

Infrastruktura e përdorur në funksion të kërkimit shkencor dhe të inovacionit është përmirësuar, ndonëse ka akoma vend për përmirësim. Në disa njësi bazë mungojnë mjetet teknologjike bashkëkohore, si dhe botimet më të fundit të disiplinave përkatëse apo të shkencave të ngjashme, sikurse dhe programet apo softëeret e përshtatshme për përpunimin e të dhënave. Prandaj metodologjia e përdorur në kërkim është sidomos shqyrtim literature (deskëork) apo mbledhje të dhënash në shkallë të vogël hapësinore. Ndërsa për burime sekondare përdoren botime të qendrave të ndryshme që operojnë në Shqipëri dhe jashtë saj (INSTAT, Banka Botërore, IGJEUM, EUROSTAT etj.).

7. Përfshirja e studentëve në kërkimin shkencor, projektet kërkimore dhe botimet.

Numri i kufizuar i studentëve nuk krijon mundësi të mëdha për përfshirje të tyre me bashkëpunime shkencore. Megjithatë pedagogët tanë janë përpjekur t'i përfshijnë ata në kërkimin shkencor, sidomos për mbledhjen e të dhënave primare sikurse: plotësim të pyetësorëve, fotografi të marra direkt në terren, takime me specialiste të fushave përkatëse etj.. Një punë e mirë është bërë sidomos me studentët e Masterit shkencor, por edhe ata të masterit profesional, të cilët në përfundim të studimeve kanë paraqitur për mbrojtje punime diplome që kanë ardhur si rezultat i përfshirjes së tyre në kërkim të mirëfilltë shkencor.

Më 13 Qershor 2022 është organizuar një konferencë me temë *“Gjeografia vlen”*, e organizuar nga studentët e programeve të studimit Bachelor në *“Gjeografi”* dhe Master shkencor në *“Studime Regjionale në Gjeografi”*. Kjo konferencë u ideua në formën e ditëve të hapura, si mënyrë njohjeje me programet e gjeografisë për maturantët, publiku përbëhej pikërisht nga nxënës dhe mësues të shkollave të mesme të rajonit të Shkodrës.

Gjithashtu ka pasur një përfshirje të studentëve në kërkimin shkencor nëpërmjet iniciativave personale të pedagogëve. Kështë, 2 studentë të Historisë kanë qenë pjesëmarrës në projektin U_SIA: University to Society Innovations in Albania, pjesëmarrës në prezantimin e paketës 6 (bashkëpunimi i Universitetit me politikë-bërjen) në Universitetin *“Giuglielmo Marconi”*, Romë, tetor 2022 (nën drejtimin e Prof. dr. Nertila Ljarja).



Pedagogu Ismet Kallaba ka udhëhequr si mentor grupin e studentëve të programit të studimit Gazetari-Komunikim të Universitetit të Shkodrës, në kuadër të projektit “Building bridges” në aktivitetin e zhvilluar në Universitetin e Novi Sadit (Serbi), të organizuar dhe mbështetur nga OSBE. Grupi i studentëve të Gazetari-Komunikimit ka fituar Çmimin e Parë në kategorinë e prodhimit televiziv në edicionin e 7-të të Festivalit Ndërkombëtar të studentëve të gazetarisë “On the Record”, që është organizuar në Novi Sad (Serbi), më 27-28 maj 2022.

8. Kontributi i anëtarëve të stafit akademik në kërkim, zhvillim e transferim teknologjie, si dhe veprimtari krijuese. Këtu mund të përfshihet kontributi me konsulenca e projekte komunitare për autoritetet lolale, shoqërinë civile, biznesin etj.

Anëtarë të FSHSH kanë dhënë kontributin e tyre në hartimin dhe zbatimin e disa projekteve që kanë të bëjnë me probleme të shoqërisë civile, të pushtetit vendor apo atij qendror :

- **Pjesëmarrja në projektin USIA: University to Society Innomediaries in Albania. Përgatitje dhe prezantim i paketës 6 (bashkëpunimi i Universitetit në politikë-bërje) në Universitetin “Giugliemo Marconi” (Romë, tetor 2022), është një konsulencë mjaft e vlefshme për të ardhmen e bashkëpunimit mes Universitetit tonë dhe Bashkisë Shkodër.**
- *Një pjesë shumë të rëndësishme të punës kërkimore – shkencore të Dr. Dritan Rustja gjatë vitit akademik 2021 – 2022, duhet thënë që e ka zënë fitimi i së drejtës për të marrë pjesë, regjistrimi dhe vetë pjesëmarrja në Master-in e Avancuar (ose të nivelit të dytë) mbi Zhvillimin e Qëndrueshëm Blu / Ekonominë Blu, të ofruar nga Universiteti i Triestes, në bashkëpunim me Institutin Kombëtar të Oqeanografisë dhe Gjeofizikës Eksperimentale (OGS), i organizuar në formatin part-time në 3 sesione me kohëzgjatje dyjavore (Mars, Qershor dhe Shtator). I konsideruar dhe vlerësuar më shumë si një specializim në këtë fushë, ky Master do finalizohet në shkurt të vitit 2023 me mbrojtjen e mikrotezës (projektit përfundimtar). Rezultatet kërkimore – shkencore të tij, priten të merren kryesisht gjatë vitit të ardhshëm akademik.*

Puna kualifikuese në shërbim të kualifikimit të mëtejshëm të stafit pedagogjik si element i rëndësishëm në rritjen e cilësisë së punës shkencore në departament, ka konsistuar në drejtim të botimeve në organet e ndryshme shkencore (brenda apo jashtë vendit), si dhe të pjesëmarrjes me kumtesa në aktivitete kombëtare dhe ndërkombëtare; workshope apo seminare kualifikimi në kuadër të projekteve të ndryshme në proces implementimi.

Në ndihmë të kualifikimit të stafit pedagogjik e shkencor, si dhe në azhornimin e vazhdueshëm me forma të reja e informacione të përditësuara shkencore të fushave përkatëse, vijnë dhe trajnimet e realizuara brenda e jashtë vendit, pranë fakulteteve e universiteteve me të cilët jemi në marrëdhënie shkëmbimi, përvoja e të cilëve shpesh paraqitet e domosdoshme për mbarëvajtjen e procesit mësimor e studimor në departamentet tona.

Një tjetër aspekt i investimit shkencor të anëtarëve të departamentit është dhe angazhimi në botime monografish e artikujsh shkencorë brenda dhe jashtë vendit, pjesëmarrje me kumtesa në konferenca, si dhe recensa artikujsh shkencorë, recensa të doktoraturave, pjesëmarrje në komisionet e vlerësimit etj.. E gjithë veprimtaria e anëtarëve të stafit pedagogjik të FSHSH jepet në tabelën përmbledhëse :



| N r | FAKULTETI I SHKENCAVE SHOËRORE | | | | | | | | | | | | | |
|--------|--------------------------------|---------------------|--|--|---|---|--|-----------|----------------------------------|----------------------------------|--------------------------|---------------------------------|----------------------|--|
| | Monografi (te botuara) | Tekste universitare | Artikuj të botuar në revista shkencore brenda vendit | Artikuj të botuar në revista ndërkombëtare (me faktor impakti, SCOPUS, etj.) | Konferenca, kongrese brenda vendit (kumtesa të botuara) | Konferenca, kongrese jashtë vendit (kumtesa të botuara) | Veprimtari krijuese letrare, artistike etj. brenda e jashte vendit | Përkthime | Projekte shkencore brenda vendit | Projekte shkencore jashte vendit | Doktoratura (2021-2022) | Profesor i asociuar (2021-2022) | Profesor (2021-2022) | |
| 1. | Depart. Gjeografi | | 1 | 3 | 10 | 1 | | | | 2 | | - | - | |
| 2. | Dep. Histori | - | 2 | 3 | 3 | | | | | 1 | 1 | - | - | |
| 2. | Dep. Gjuhësi | - | 4 | 6 (4FI) | 35 | 15 | 5 | - | 2 | 1 | - | - | - | |
| 2. | Dep. Letërsi | - | 8 | 1 | 11 | 7 | 2 | 1 | - | 2 | 1 | - | - | |
| 2. | QSA | 2 | 18 | 4 | 21 | 4 | - | - | 2 | | | - | - | |
| | SHUMA | 2 | 33 | 17 | 80 | 27 | 7 | 1 | 4 | 6 | 2 | - | - | |



Objektivat për vitin 2023:

Objektivi kryesor për vitin e ardhshëm është puna në vazhdimësi për përgatitjen e dosjeve për të fituar titullin *Profesor* ose *Profesor i asociuar* nga anëtarët e njësive bazë.

Për të gjithë anëtarët e stafit akademik të FSHSH do të kërkohet pjesëmarrja në trajnime, konferenca dhe projekte, brenda dhe jashtë vendit, si dhe për botime artikujsh në revistën Buletini shkencor i USH apo në revista të tjera shkencore brenda e jashtë vendit.

Synim kryesor i punës do të jetë botimi i librave me karakter shkencor.

Monografi

- Vincens Marku: “*Mbi përkthimin e Këngës së parë të Ferrit*”,
- Merita Hysa: “*Variacioni i strukturave rrokjesore në gjuhën shqipe*”.

Përmbledhje studimesh

- Botim i punimeve të konferencës “*Trans-humance and Rural Development*”, vëllimi i dytë me proceedings, si kriter i rëndësishëm për njohjen dhe validimin e pjesëmarrjes në konferenca ndërkombëtare. (vëllimi i parë tashmë është botuar).
- Dalja nga shtypi i përmbledhjes “*Studime shqiptare*” 24 dhe “*Studime shqiptare*” 31.
- Arben Prendi parashikon përgatitjen për botim të një përmbledhjeje studimore dhe të një studimi mbi veprën e Martin Camajit.
- Pedagogu Gëzim Puka parashikon përgatitjen e një përmbledhjeje studimore me artikuj dhe kumtesa të mbajtura në vite.

Tekste universitare

- Vincens Marku - *Letërsi e huaj moderne*
- Merita Hysa - “*Fonetikë e gjuhës shqipe*” (tekst ushtrimesh).

Organizim i konferencave shkencore

- “**Albanologjia e shek. XX dhe perspektivat e saj**” (nga QSA në bashkëpunim me Akademinë e Shkencave të Shqipërisë, mars-prill 2023).

Përmes kësaj konference, të cilën mendojmë ta organizojmë në bashkëpunim me Akademinë e Shkencave synojmë ta shikojmë albanologjinë dhe albanologët në një këndvështrim më të plotë duke pasur parasysh edhe figura dhe vepra apo kontribute që në vite janë studiuar nga gjuhëtarët tanë, por që shpeshherë kanë mbetur të kufizuar nga politikat e kohës. Nuk duhen harruar se një pjesë e albanologëve janë të panjohur edhe nga studiues të rinj që merren me shqipen. Albanologjia është pika më e fortë që ne kemi për të krijuar lidhjet me Europën. Në këtë fushë të dijes rroken të gjithë elementet që kanë të bëjnë me Shqipërinë dhe shqiptarët.

- “**Autorët gegë Rilindas të gjysmës së parë të shek XIX**” (nga QSA, qershor 2023)

Është detyrim kombëtar që secili institucion të paraqes kontributin e tij në përkujtimin të figurave dhe autorëve gegë që ndikuan në letrat shqipe të shek. XIX, por që në të vertetë nuk u bënë të njohur. Ne synojmë t'i nxjerrim në pah këto figura dhe të hapim një faqe të re në njohjen e tyre për lexuesit dhe studiuesit. Në këtë rast qëllimi kryesor i Qendrës së Studimeve Albanologjike në bashkëpunim me Departamentet pranë Universitetit të Shkodrës “Luigj Gurakuqi”, është që jo vetëm të organizojë një konferencë shkencore, por edhe të jenë Lider në këtë drejtim.

- “**Shtypi periodik në vitet 1913-1915 në Shkodër**” (nga QSA, nëntor 2023)



Përmes kësaj konference kombëtare synojmë të nxjerrim në pah prurjet e shtypit periodik në fillimin e shek. XX, rolin e tij në jetën kulturore, atdhetare dhe politike përmes gazetave të publikuara në Shkodër gjatë kësaj periudhe, si: “Besa shqiptare”, “Shqypnia e re”, “Hylli i Dritës” etj..

- **“Prirje të gegërishtes sot”** (nga Departamenti i Gjuhësisë)
- **“Zhvillimi rural në rajonin e veriut – Potenciale dhe sfida”** (Fakulteti i Shkencave Shoqërore në bashkëpunim me Institutin e Kërkimeve Rurale).
- **“At Anton Harapi”** (Departamenti i Letërsisë, shkurt 2023).
- **“Studime për rajonin”** (Studentët e Gjeografisë, qershor 2022)

Edhe njësitë e tjera bazë të FSHSH gjatë vitit 2023 do të organizojnë konferenca shkencore me punime të studentëve, të cilat do të ketë në fokus orientimin e tyre nga kërkimi shkencor dhe paraqitjen e rezultateve të hulumtimeve të tyre të deritanishme.

Gjithashtu edhe promovimi i veprave, monografive dhe librave shkencorë do të jenë pjesë e punës promovuese të Qendrës së Studimeve Albanologjike në bashkëpunim me institucione të tjera kërkimore-shkencore.

Aktivitete të tjera:

Prill-Maj 2023, Festivali i poezisë. Biseda, takime me poetë. Bashkëpunim me shtëpinë botuese Bardbooks Prishtinë (Departamenti i Letërsisë).

Projekte

- Do të përmbyllet pjesa e parë e projektit *“Gramatikat e shqipes në shek. XIX”*. Do të bëhet përgatitja e materialit për shtyp.
- Do të fillojë puna për zbatimin e projektit për zhvillim e kërkim *“Fjalor historik i gjuhës shqipe* (shek. XVI-XIX) që do të realizohet nga anëtarët e seksionit të gjuhësisë në QSA në bashkëpunim me anëtarë të departamentit të gjuhësisë.

Marrje grade apo titulli :

Gjatë vitit akademik 2021-2022 pedagogët e FSHSH do të punojnë në vazhdimësi për përgatitjen e dosjes për të përfutur titullin *“Profesor i asociuar”* (Bresena Kopliku, Flora Gjoni, Ervis Krymbi, Dritan Rustja, Zamira Shkreli etj.) dhe *“Profesor”* (Nevila Dibra, Arben Prendi, Valbona Karakaçi, Vinçens Marku, Elinda Dibra etj.).

Fakulteti i Shkencave të Natyrës

1. Objektivat e kërkimit shkencor dhe inovacionit për vitin akademik 2020- 2021 në përputhje me strategjinë e zhvillimit të institucionit.

Njësitë bazë në përbërje të FSHN, ashtu si çdo vit tjetër, në përgjithësi e kanë realizuar punën shkencore duke u mbështetur në objektivat që i kanë vënë vetes në vitin e mëparshëm. Sipas objektiveve të vendosura, anëtarët e Departamenteve kanë punuar në këto drejtime kryesore:

5. Realizimi i *botimeve* në organe të ndryshme shkencore (brenda dhe jashtë vendit) dhe *kumtesave* të mbajtura në konferenca shkencore (brenda dhe jashtë vendit).



6. *Udhëheqjeve* të studentëve në tre nivelet e studimit: Bachelor, Master Shkencor, Master Profesional dhe Doktoraturë, si dhe të *recensave* apo *oponencave* për tezat e Masterit dhe të Doktoraturës.
7. Puna në shërbim të kualifikimit të mëtejshëm të stafit pedagogjik, si një element i rëndësishëm në rritjen e cilësisë së punës në departament, fakultet e universitet.

Përmbushja e këtyre objektivave rezultoi e vështirë edhe për këtë vit, si pasojë e periudhës pas pandemisë. Megjithatë u konstatua se në përgjithësi është bërë një punë e mirë në drejtimet e lartpërmendura. Vlen të përmendet fakti se ka patur pjesëmarrje në trajnime specifike kualifikuese jashtë vendit, konferenca prestigjioze, si dhe projekte në terren. Sipas objektivave të vendosura, **në janar 2021**, fituan gradën shkencore "Doktor shkencash", pedagogët e Departamentit të Infermierisë Emiliano Pjetri dhe Julian Kraja.

2. Politikat e ndjekura për kërkimin shkencor.

3.

Stafi i fakultetit tone, sipas specifikave të departamenteve është vazhdimisht në kërkim të përmirësimit të performancës kërkuese-shkencore, si element i rëndësishëm i përmirësimit edhe të cilësisë së mësimdhënies. Përveç logjistikës së kufizuar edhe mundësitë e pakta financiare për lëvizje, sidomos jashtë kufijve të Shqipërisë, kanë ndikuar në vështirësimin e pjesëmarrjes në aktivitete shkencore për përditësimin me të rejtat më të fundit të shkencës në fushat përkatëse, si dhe për zgjerimin e rrjetit të kontakteve me studiues të disiplinave të ngjashme shkencore.

4. Projektet e zbatuara dhe rezultatet e tyre, në nivel individual apo njësie.

Projektet e zbatuara dhe rezultatet e tyre në Departamentin e Biologjisë janë

VALEU-X PROJECT [VIRTUAL ALBANIAN EUROPIAN UNIVERISTIES EXCHANGE].

Projekt nr. 610360-EPP-1-2019-1-DE-EPPKA2-CBHE-JP/ Afat dyvjeçar. Roli: I stafit akademik, Arjana Lacej dhe Arselida Mashaj.

Gjithashtu të dy pedagogët kanë realizuar: Vizite: Universiteti Teknik i Dresdenit /Dresden, Gjermani 04.05.2022 - 07.05.2022, Vizite, UNIMED, Rome, Itali, 18.05.2022 - 22.05.2022

Prof. Dr. Ariana Striniqi: ka marrë pjesë në ERASMUS+/Staff Week. Sustanaibilitz at Unict, E+KA107, a.a 2021/2022, Universita di Catania, 20 - 24.06.2022

Aurora Dibra: është Koordinator lokal i projektit: Përmirësimi i kapaciteteve të kërkimit shkencor të institucioneve shqiptare të arsimit të lartë në ruajtjen dhe restaurimin e Trashëgimisë Kulturore – REACH” (*Improving Research capacities of Albanian higher education institutions in conservation and restoration of Cultural Herirage -REACH*): “Marrëveshja e Grantit Nr: 610390-EPP-1-2019-I-AL-EPPKA2-CBHE-SP dhe në kuader të këtij projekti është realizuar **Training on the Job**, në Universitetin e Bolonjes në Itali, pranë Alma Mater Studiorum University of Bologna- Ravenna campus program nga data 15.12.2021 - (date): 17.12.2021 në të cilin kanë marrë pjesë nga departamenti i Biologjisë edhe prof. Dr. Anila Neziri dhe staf teknik Diana Muriqi.

Gjithashtu dr. Aurora Dibra është anetar Anetar i grupit të punës së projektit STEAM MSc course in STEAM education – STEAM edu dhe koordinator i projektit “Menaxhimi i qendrueshëm dhe digjitalizimi shkencor i biodiversitetit në Qarkun e Shkodrës mbshetetur nga AAKSHI (2022-2023), si dhe anetar në projektin “Vlerësimi i ndikimeve të ndersjellta



ndermjet ndyshimeve klimatike dhe ndotjes mbeshtetur nga AAKSHI (2021-2023)”.
se ajrit mbi territorin e Shqipërisë

Prof. As. Anila Dizdari është pjesë e stafit që ka hartuar e po zbaton projektin shkencor të miratuar për financim nga Senati i Universitetit “Luigj Gurakuqi” të Shkodrës “Vlerësimi i cilësisë ekologjike të ujit të ekosistemit ujor të Liqenit të Shkodrës sipas standarteve të BE dhe të Direktivës Kuadër të Ujërave (DKU)”, projektin Entral me mbështetjen e ERASMUS dhe Komunitetit European në kuadër të cilit ka marrë pjesë edhe në kursin “Meeting on designing the entrepreneurship courses”, Léon, Spain (24-27 Maj 2022).

Gjithashtu menaxher prof. dr. Suzana Golemi është menaxher dhe staf kerkues në projektet REACH, Projektin Entral, SREAM (Erasmus +) si dhe ka marrë pjesë në Meeting on designing the entrepreneurship courses, Léon, Spain (24-27 Maj 2022) dhe Mobilitetin ERASMUS+/Staff Week. Sustanaibilitiz at Unict E+KA107, a.a 2021/2022Universita di Catania, 20-24.06.2022

Kontributi i anterave të stafit akademik në kerkim e transferim teknologjike e veprimtarie krijuese në Departamentin e Biologji – kimise si dhe pjesëmarrje me punime në konferenca shkencore ndërkombëtare brenda vendit ka rezultuar e kenaqshme dhe është pasqyruar në tabelën përmbledhese të veprimtarisë së Fakultetit.

Po kështu stafi i këtij departamenti ka pasur një Pjesëmarrje të mirë me punime në konferenca shkencore ndërkombëtare brenda vendit, edhe kjo e paraqitur në tabelën përmbledhese të veprimtarisë së Fakultetit.

Anetaret e **QSURSH** kanë rezultuar gjithashtu të kenë marrë pjesë në konferenca shkencore kombëtare dhe ndërkombëtare përmes referimeve e botimeve të ndryshme.

Qendra gjithashtu ka botuar një numër të konsiderueshëm të artikujve shkencore në revista shkencore brenda dhe jashtë vendit. Keto janë pasqyruar në tabelën përmbledhese të veprimtarisë së Fakultetit.

Departamenti i Matematikës gjithashtu rezulton të ketë katër botime të artikujve shkencorë jashtë vendit. Keto janë pasqyruar në tabelën përmbledhese të veprimtarisë së Fakultetit.

Puna shkencore e Departamentit të Fizikës ka qënë e integruar si me botime ashtu edhe me pjesëmarrje të stafit të këtij departamenti në konferenca shkencore apo botime në revista shkencore jashtë vendit. Vlen të veçohet pjesëmarrëse në trajnimin: “Pjesëmarrja shqiptare në Horizon Europe 2021-2027 dhe mësimet e nxjerra nga H2020”; organizuar nga Agjencia Kombëtare e Kërkimit Shkencor dhe Inovacionit (NASRI) në koordinim me Projektin e Asistencës Teknike të BE-së për Programet e Bashkimit në Shqipëri Si dhe pjesëmarrja në projekte ndërkombëtare. Keto janë pasqyruar në tabelën përmbledhese të veprimtarisë së Fakultetit.

Departamenti i Infermierisë: stafi i këtij departamenti ka marrë pjesë në 15 Konferenca shkencore si dhe ka 20 botime në revista shkencore ndërkombëtare, 27 botime në revista shkencore brenda vendit si dhe 3 botime në revista me bord editorial. Këto janë pasqyruar në tabelën përmbledhese të veprimtarisë së Fakultetit.

Gjithashtu Zamira Shabani, staf i këtij departamenti ka realizuar gjithashtu gjashtë opionenca të studimeve doktorale, një në vitin 2021 dhe pesë në vitin 2022.

5. Infrastruktura e përdorur në shërbim të kërkimit shkencor dhe të inovacionit.



Infrastruktura e përdorur në funksion të kërkimit shkencor dhe të inovacionit është relativisht e kufizuar. Mungojnë mjetet teknologjike, si dhe botimet më të fundit të disiplinave përkatëse apo të shkencave të ngjashme, sikurse dhe programet apo softwarët e përshtatshme për përpunimin e të dhënave. Prandaj metodologjia e përdorur në kërkim është sidomos shqyrtim literature apo mbledhje të dhënash në shkallë të vogël hapësinore. Ndërsa për burime sekondare përdoren botime të qendrave të ndryshme që operojnë në Shqipëri dhe jashtë saj (INSTAT, Banka Botërore, IGJEUM, EUROSTAT etj.).

6. Përfshirja e studentëve në kërkimin shkencor, projektet kërkimore dhe botimet.

Numri i kufizuar i studentëve nuk krijon mundësi të mëdha për përfshirje të gjerë të tyre në bashkëpunime shkencore. Megjithatë pedagogët tanë janë përpjekur t'i përfshijnë ata në kërkim shkencor, sidomos për mbledhjen e të dhënave primare sikurse: plotësim të pyetësorëve, fotografi të marra direkt në terren, takime me specialiste të fushave përkatëse etj. Një punë e mirë është bërë sidomos me studentët e Masterit shkencor, por edhe ata të masterit profesional, të cilët në përfundim të studimeve kanë paraqitur për mbrojtje punime diplome që kanë ardhur si rezultat i përfshirjes së tyre në kërkim të mirëfilltë shkencor, dhe kane rezultuar me pas me prezantimin e tyre edhe në konferenca shkencore.

Në fakultetin e Shkencave të Natyrës janë botuar gjatë vitit akademik 2021-2022 dy tekste Universitare N. BUSHATI (ÇAKU) & F. BUSHATI. Mikrobiologjia, (ribotim) Shtypshkronja Volaj, Shkodër 2021 si dhe A. BEKTESHI. Kimia e Përgjithshme (ribotim). Univeriteti i Shkodrës "Luigj Gurakuqi", Shkoder 2022.

7. Kontributi i anëtarëve të stafit akademik në kërkim, zhvillim e transferim teknologjie, si dhe veprimtari krijuese. Këtu mund të përfshihet kontributi me konsulencë e projekte komunitare për autoritetet lokale, shoqërinë civile, biznesin etj.

Anëtarë të FSHN kanë dhënë kontributin e tyre në hartimin dhe zbatimin e disa projekteve që kanë të bëjnë kryesisht me probleme mjedisore, të pushtetit vendor apo atij qendror: Në ndihmë të kualifikimit të stafit pedagogjik e shkencor, si dhe në azhurnimin e vazhdueshëm me forma të reja e informacione të përditësuara shkencore të fushave përkatëse, vijnë dhe trajnimet e realizuara brenda e jashtë vendit, pranë fakulteteve e universiteteve me të cilët jemi në marrëdhënie shkëmbimi, përvoja e të cilëve shpesh herë paraqitet e domosdoshme për mbarëvajtjen e procesit mësimor e studimor në departamentet tona. Një tjetër aspekt i investimit shkencor të anëtarëve të departamentit është dhe angazhimi në botime monografish e artikujsh shkencorë brenda dhe jashtë vendit, pjesëmarrje me kumtesa në konferenca, si dhe recensa artikujsh shkencorë, recensa të doktoraturave, pjesëmarrje në komisionet e vlerësimit etj.

Tabela 8. Veprimtaria shkencore e anëtarëve të stafit akademik të FSHN^{se}, per vitin akademik
2021 – 2022.



| Nr. | Fakulteti i Shkencave të Natyrës | Monografi (te botuara) | Tekste universitare | Artikuj të botuar në revista shkencore brenda vendit | Artikuj të botuar në revista ndërkombëtare (me faktor impakti, SCOPUS, etj.) | Konferenca, kongrese brenda vendit (kumtesa të botuara) | Konferenca, kongrese jashtë vendit (kumtesa të botuara) | Veprimtari krijuese letrare, artistike etj. brenda e jashte vendit | Përkthime | Projekte shkencore brenda vendit | Projekte shkencore jashte vendit | Doktoratura (2021-2022) | Profesor i asociuar (2021-2022) | Profesor (2021-2022) |
|-----|----------------------------------|------------------------|---------------------|--|--|---|---|--|-----------|----------------------------------|----------------------------------|--------------------------|---------------------------------|----------------------|
| 1. | Bio - Kimi | - | - | 6 | 2 | 18 | 7 | - | - | 2 | 11 | 1 | - | - |
| 2. | Matematikë | - | - | - | 1 | 2 | - | - | - | - | - | - | - | - |
| 3. | Fizikë | - | - | 3 | - | - | - | - | - | - | - | - | - | - |
| 4. | Infermieri | - | 5 | 3 | 1 | 4 | 4 | - | - | 1 | 3 | - | - | - |
| 5. | QSURSH | - | 2 | 8 | 2 | 7 | 2 | - | - | 1 | - | - | - | - |
| | Shuma | - | 7 | 20 | 6 | 31 | 13 | - | - | 4 | 14 | 1 | - | - |

Objektivat per te ardhmen:

Misioni dhe objektivat e FSHN janë në të njëjtën linjë me misionin dhe objektivat e Universitetit të Shkodrës “Luigj Gurakuqi”.

USH ka për mision kryesor: Të krijojë, të transmetojë, të zhvillojë dhe të mbrojë dijet me anë të mësimdhënies, të kërkimit shkencor dhe të shërbimeve. Gjithashtu, ai ka si mision edhe të formojë specialistë të lartë dhe të përgatisë shkencëtarë të rinj.

Objektivi kryesor për vitin e ardhshëm është puna në vazhdimësi për përgatitjet e dosjeve për të fituar titujt Profesor ose Profesor i asociuar nga anëtarët e njësisive bazë.

Për të gjithë anëtarët e stafit akademik të FSHN do shihen mundësitë për pjesëmarrje në trajnime, konferenca dhe projekte, brenda dhe jashtë vendit dhe paralelisht me to edhe mundësitë për botime monografish, tekstesh universitare dhe artikujsh shkencorë.

OBJEKTIVAT E DEPARTAMENTIT TE INFERMIERISE PER VITIN 2022 - 2023



- Hapja e programit të Ri të ciklit të dytë të studimeve Master Shkencor “Menaxhim Infermieror”
- Implementimin e metodologjise Payton si të vetmin instrument mates në praktikat infermiore dhe pikezimin e veprimeve infermiore.
- Si në në ciklin e parë të studimeve, ashtu edhe në ciklin e dytë të punohet në mënyrë të vazhdueshme për hapjen e programeve të reja të studimit të cilët janë të orientuar drejt kërkesave të tregut të punës.
- Të shihet këtë vit akademik me përparësi akreditimi i programeve të studimit.
- Të forcohet dhe të thellohet më tej puna mësimore, duke synuar modernizimin e saj.
- Të rishikohen e të pasurohen më tej programet mësimore të çdo lënde, me qëllim përmirësimin e tyre.
- Të përditësohen leksionet e shkruara në të gjitha lëndët, duke u bërë objekt diskutimi në njësitë bazë, në veçanti për pedagogët e rinj (në rastet kur për nevoja tepër të mëdha duhet të japin leksione, është e domosdoshme që leksionet e tyre të diskutohen në departament). Pedagogët e rinj duhet të kenë ngarkesë vetëm seminarët. Pas kualifikimeve shkencore mund të bëhen titullarë lënde, kjo gradualisht.
- Metodatat e kontrollit të njohurive të studentëve duhet të përmirësohen në mënyrë të vazhdueshme.
- Të rritet numri i provimeve me zë, sidomos në lëndët me karakter teorik.
- Të insistohet në zbatimin me korrektësi të ligjeve, të rregulloreve dhe të urdhërave e udhëzimeve të MAS apo të Rektoratit, me qëllim përmirësimin e cilësisë së punës mësimore.
- Të bëhet normë tërheqja e feedbackut nga studentët për realizimin e procesit mësimor në të gjitha hallkat e tij.
- Lidhur me problemin e praktikave mësimore, të shkohet drejt hartimit të një dokumenti rregullator ndërmjet departamentit dhe reparteve perkatëse.
- Në bashkëpunim me MAS dhe rektoratit të punohet në ngritjen e qendrave të shërbimit shëndetësor Universitar të praktikës që do të ndihmonin në një ushtrim praktik e cilësor të studentëve, ofrimin e shërbimit qytetareve dhe do të jepnin fund praktikave formale.
- Organizimi i aktiviteteve të përbashkëta me institucionet e shërbimeve shëndetësore dhe ato të edukimit, për një afrim të universitetit me publikun.
- Kthimi i departamentit të infermiere në qendër jo vetëm të formimit fillestar të infermiereve, por edhe të zhvillimit profesional të tyre.
- Të synojmë në përgatitjen nga ana e pedagogëve të teksteve për lëndët që mbulojnë.

Departamenti do të përcaktojë dhe të miratojë programe të veçanta për realizimin e objektivave të mësipërme.

Objektivat për punën shkencore të punonjësve shkencorë të Qendrës së Studimit të Ujrave të Rajonit të Shkodrës (QSURSH) për vitin akademik 2022 – 2023 janë:

- Zbairi i projektit: Vlerësimi i cilësive ekologjike (kimike, mikrobiologjike dhe biologjike) të ujërave të Liqenit të Shkodrës sipas standardeve të BE dhe të Direktivës Kuadër të Ujërave (DKU ose WFD).
- Monitorim dhe vlerësim i situatës kimike dhe mikrobiologjike të rrjetit ujor të rajonit të Shkodrës, duke analizuar burimet e ndotjes kimike e mikrobiologjike. *A. Bektoshi, D. Kapiti, N. Bushati, H. Dibra & J. Preka*



- Monitorim dhe vlerësim i situatës biologjike të ekosistemeve, habitateve dhe gjallesave ujore (bimë, plankton, peshq etj.) të rrjetit ujqor të rajonit të Shkodrës. *Marash. Rakaj, Lulzime Dhora* në bashkëpunim me anëtarët e Departamentit të Biologjisë dhe Kimisë
- Studime të avancuara mbi florën dhe bimësinë ujore dhe tokësore (aspekte taksonomike, ekologjike dhe të perhapjes gjeografike) të Rajonit të Shkodrës. M. Rakaj në bashkëpunim me ekspertë të florës dhe faunës.
- Situata e popullatave të peshqve herbivorë dhe detritivorë të Liqenit të Shkodrës, bazuar në zënie, që kontribuojnë në transferimin e nutrientëve prej litoralit në pelagial. L. Dhora me bashkëpunim me anëtarët e Departamentit të Biologjisë dhe Kimisë]
- Pjesëmarrje me referime ose me postera në konferenca shkencore dhe mjedisore kombëtare dhe ndërkombëtare (□do anëtar i Qendrës duhet të marrë pjesë me të paktën 2 referime ose 2 postera). Anëtarët e Qendrës.
- Botim i 4 artikujve në Buletinin shkencor të Universitetit të Shkodrës, FSHN të Universitetit të Tiranës dhe në revista të tjera shkencore kombëtare dhe i 2 artikujve në revista ndërkombëtare. (□do anëtar i Qendrës duhet të botoi të paktën 1 artikull në revista kombëtare dhe 1 artikull në revista ndërkombëtare). Anëtarët e Qendrës.
- Udhëheqje e tezave të diplomave të studentëve të Masterit Shkencor “Biologjia Mjedisore” etj., në fushat e kimisë, mikrobiologjisë, ekologjisë dhe të florës e faunës ujore dhe mundësisht edhe të tezave të Disertacioneve. Anëtarët e Qendrës.
- Aplikime dhe pjesëmarrje në projekte për Liqenin e Shkodrës dhe lumenjt e Rajonit të Shkodrës dhe projekte të tjera kombëtare dhe ndërkombëtare të mbështetura nga AKKSHI, HORIZON 2021-2027, GIZ, GEF, MAVVA etj. Anëtarët e Qendrës.
- Rritje e nivelit të bashkëpunimit me Qendrat, Institutet shkencore dhe Institucionet shkencore si motra të Tiranës, të vendeve të Ballkanit dhe të vendeve të Bashkimit Europian në fushat e kimisë, mikrobiologjisë dhe biologjisë së ujërave. Vazhdimisht, Anëtarët e Qendrës.
- Implementim i projektit: “Përcaktimi i parametrave fiziologjikë të disa peshqve të tregut në Liqenin e Shkodrës (L. Dhora & anëtarët e Qendrës).
- Monitorim dhe vlerësim i situatës ekologjike dhe mjedisore të rrjetit ujqor të rajonit të Shkodrës, përfshij shkaqet dhe burimet e ndotjeve dhe pasojat e tyre mbi ekosistemin, habitatet dhe gjallesat ujore. (anëtarët e Qendrës).
- Studime të avancuara të florës dhe faunës ujore te Rajonit të Shkodrës dhe Shqipërisë, si aspekte taksonomike, citologjike, fiziologjike dhe ekologjike dhe të perhapjes gjeografike të specieve ujore të florës dhe faunës. (M. Rakaj në bashkëpunim me ekspertë të florës dhe faunës).
- Pjesëmarrje e vazhdueshme me referime në konferenca, kongrese dhe simpoziume shkencore kombëtare dhe ndërkombëtare.

Fakulteti Ekonomik

Veprimtaria kërkimore dhe shkencore përbën njëri prej dy drejtimeve kryesore të aktivitetit të përditshëm të stafit akademik të FE-së duke qenë se arritjet kërkimore dhe shkencore të tyre janë të lidhura drejtpërdrejt me përmirësimin e cilësisë së mësimdhënies, me përditësimin e informacionit shkencor që u përcillet studentëve në auditor dhe me rritjen akademike të tyre në botën e kërkimit shkencor. Mbështetur në raportet individuale të pedagogëve të FE-së,



rezulton se pedagogët janë përpjekur të punojnë në realizimin e punës së tyre shkencore individuale si me publikime dhe pjesëmarrje në konferenca e projekte kerkimore, mobilitete mësimdhënie e trajnime, udhëheqjen e temave të diplomave të studentëve të ciklit të parë dhe të dytë të studimit si dhe në përfshirjen e studentëve në kërkimin shkencor, si kërkesë për formimin e tyre profesional dhe qytetar etj. Objektivat e kërkimit-shkencor për vitin akademik 2021-2022, sikurse edhe ato të mësimdhënies, kanë qenë në përputhje të plotë me strategjinë e zhvillimit të USH-së dhe atë të fakultetit. Ndër objektivat themelore përmendim:

1. Angazhimi maksimal në hapjen e programit të studimit Doktoraturë në “Ekonomi dhe Turizëm i Qëndrueshëm” .
2. Vazhdimi i punës për hapjen e programit të studimit MP në ‘Marketing inovativ’.
3. Pjesëmarrja në konferenca dhe aktivitete shkencore e stafit dhe e studentëve.
4. Realizimi i botimeve në revistat prestigjioze me faktor impakti dhe indeksim SCOPUS apo THOMPSON.
5. Realizimi i botimeve në revista të tjera shkencore brenda dhe jashtë vendit.
6. Pjesëmarrja në projekte kerkimore-shkencore.
7. Pjesëmarrja në mobilitete me qëllim kërkimin dhe trainimin e stafit.

Politikat e ndjekura nga Fakulteti Ekonomik në drejtim të kërkimit shkencor janë në të njëjtën linjë me strategjinë e kërkimit dhe zhvillimit shkencor të USH-së. Këto politika synojnë të stimulojnë kërkimin shkencor në nivel individual apo në nivel grupi, të nxisin pedagogët të jenë pjesë e projekteve shkencore dhe e organizimeve të tilla si, konferenca, ëorkshope, seminare dhe natyrisht edhe pjesëmarrës me botime në revista shkencore brenda dhe jashtë vendit.

Projekte kërkimore gjatë vitit akademik 2021-2022 të mbështetura nga Bashkimi Evropian dhe projekte brenda vendit në të cilat është angazhuar FE:

- Anëtarë të Fakultetit Ekonomik janë të përfshirë në në projektet:

1. **MARDS** – projekti i doktoraturës. Ky projekt u finalizua me miratimin e programit doktoral në “Ekonomi dhe turizëm i qëndrueshëm” ne muajin Prill 2022 nga MAS.
2. Projekti **USIA** – mbi ngritjen e nivelit të kërkimit shkencor
3. Projekti **“Smart”** – project ERASMUS+ që do të fillojë implementimin në Janar 2023.
4. Projekti **“Fairwork Albania”**, projekt kërkimor një vjeçar financuar nga Oxford Internet Institute dhe WZB Berlin Social Science Center
5. Projekti **“Kol Thaçi”** në bashkëpunim me Fakultetin e Shkencave Shoqërore dhe Fakultetin e Drejtësisë .

Gjatë këtij viti ka patur mobilitete të pedagogëve dhe studentëve të FE në kuadër të projekteve ERASMUS+ dhe CEEPUS.

II. Infrastruktura e përdorur në shërbim të kërkimit shkencor dhe të inovacionit.

Në shërbim të kërkimit shkencor dhe inovacionit në USH kanë shërbyer përveç mjediseve të godinës së re të Fakultetit Ekonomik dhe mjediseve që ajo ofron, edhe pajisja e një pjese të laboratoreve të saj me kompjutera dhe mjete të komunikimit në distancë, si telekonferenca, të siguruara nga projektet MARDS dhe FOSTINNO. Gjithashtu edhe përveç Biblotekës së USH dhe fondi i Librave të Prof.Ted Oefkes , Buletini shkencor i FE, biblioteka digjitale e ofruar nga MAS dhe tjetra nga AADF.



III. Përfshirja e studentëve në kërkimin shkencor, projektet kërkimore dhe botimet.

- Studentët kanë qenë vazhdimisht në vemendjen e Fakultetit për t'u përfshirë në punën kërkimore shkencore. Për një periudhë prej 10 vitesh ato janë bërë pjesë e workshopit 'Sfidat e zhvillimit rajonal' me temat më të mira të studentëve të realizuar çdo vit, me pjesëmarrjen e një jurie profesionistësh nga fusha e biznesit, institucionet vendore dhe OJF-të e rajonit.
- Organizimi i workshopit me studentët e turizmit nga Departamenti i Turizmit me datën 06.05.2022 'Ruajtja dhe përmirësimi i atraktivitetit turistik në rajonin verior të Shqipërisë në kushtet e krizes aktuale ekonomike'.
- Një pjesë e punimeve më të mira të diplomave të studentëve janë publikuar në Buletinin e Shkencave Ekonomike. Ato vijnë si artikuj shkencorë të studentëve në bashkëpunim me pedagogët udhëheqës.

III. Kontributi i pedagogëve në kërkim, zhvillim e transferim teknologjie si dhe veprimtari krijuese. Këtu mund të përfshihet kontributi me konsulencë e projekte komunitare për autoritetet lokale, shoqërinë civile, biznesin etj.

Sa i përket kontributit të stafit akademik të FE në mbështetje të institucioneve publike lokale, shoqërisë civile dhe biznesit, përmendim, pjesëmarrjen pedagogëve: 1) në mbështetjen me konsulencë në projektet e OJF-ve që veprojnë në Rajonin e Shkodrës, 2) si ekspertë në veprimtari rekrutuese në insitucionet e pushtetit lokal apo biznesit, 3) përmes ofrimit të konsulencës në proceset e menaxhimit të biznesit në mënyrë të qëndrueshme.

Arritjet kërkimore shkencore për secilin Departament janë paraqitur në tabelën përmbledhëse të fakultetit dhe do të jene te perfshira si aneks i ketij raporti.

Departamenti i Administrim Biznesi ka realizuar **Konferencën Studentore** "Sfidat e Zhvillimit Rajonal". Drejtuese e këtij workshopi Albana Borici, dhe pjesë e grupit të punës kanë qenë dhe përgjegjësit e departamenteve, si dhe anëtarë të tjerë të departamentit si Ylvije Kraja, Arjola Halluni.

Departamenti i Administrim Biznesi ka realizuar **Panairin e Punës**, në Prill.

Të gjithë anëtarët fakultetit kanë qenë udhëheqës dhe recensues të udhëheqjeve të diplomave në master. Gjithashtu një pjesë e tyre kanë qenë recensues të punimeve në Buletin Shkencor të USH-së, Seria e Shkencave Ekonomike.

Ne departamentin e Turizmit jane organizuar gjithashtu Workshopi i 9-të " Sfidat e zhvillimit rajonal", publikime ne në **Buletine shkencore të USH rezultojne te jene 2 te tilla si dhe udheheqje e temave te diplomave te studenteve apo pjesemarrje ne borde editorial te revistastave shkencore si p.sh. International Marketing Journal of Culture and Tourism (IMJCT)**

Gjithahstu staf i ketij departamenti, prof.,dr Arjeta Troshani u angazhua për të bërë recencë në Collegiumin e parë Doktorale 'Zhvillimit të qëndrueshëm' në Mal të zi (Shtator 2022) dhe rezulton te jete edhe anëtar të komitetit shkencor.



| Nr | Fakulteti | Monografi (te botuara) | Tekste universitare | Artikuj të botuar në revista shkencore brenda vendit | Artikuj të botuar në revista ndërkombëtare (me faktor impakti, SCOPUS, etj.) | Konferenca, kongrese brenda vendit (kumtesa të botuara) | Konferenca, kongrese jashtë vendit (kumtesa të botuara) | Veprimtari krijuese letrare, artistike etj. brenda e jashte vendit | Përkthime | Projekte shkencore brenda vendit | Projekte shkencore jashte vendit | Doktoratura (2021-2022) | Profesor i asociuar (2021-2022) | Profesor (2021-2022) |
|----|-----------------|------------------------|---------------------|--|--|---|---|--|-----------|----------------------------------|----------------------------------|--------------------------|---------------------------------|----------------------|
| 1. | Dep. Turizmit | 0 | 0 | 0 | 0 | 3 | 5 | 0 | 0 | 0 | 1 | 0 | 0 | 0 |
| 2. | Dep. Adm-Biznes | 0 | 0 | 5 | 12 | 12 | 6 | 0 | 0 | 0 | 4 | 0 | 0 | 0 |
| 3. | Dep. Fin-Kontab | 0 | 0 | 1 | 6 | 8 | 6 | 0 | 0 | 1 | 4 | 0 | 0 | 0 |
| 4. | Totali | 0 | 0 | 6 | 18 | 23 | 17 | 0 | 0 | 1 | 9 | 0 | 0 | 0 |

11.Puna për përgjegjësinë sociale të FE-së

Në vazhdim të përpjekjeve për të kontribuar në zhvillimin e qëndrueshëm të rajonit të veriut e me tej, realizoi në ditët e para të Qeshorit 2022 disa takime të organizuara në auditore me maturantët e shkollave të mesme në Bashkinë Shkodër dhe Bashkinë Vau dejës, mbi ndërgjegjësimin e të rinjve për rolin dhe mundësitë e tyre për të kontribuar



individualisht dhe së bashku në realizimin e 17 Objektivave të OKB-së të Agjendës 2030 për Zhvillim të Qëndrueshëm. Këto takime u bënë me lejen e drejtorisë arsimore rajonale me qendër në Lezhë.

13. Objektiva për vitin akademik 2022-2023:

- Botime në Buletinin Shkencor të Shkencave Ekonomike të UNISHK për vitin 2023.
- Pjesmarrje dhe kontribues në konferencën që do të organizohet në kuadër të 30 vjetorit të Fakultetit Ekonomik.
- Pjesmarrje në konferenca kombëtare dhe ato ndërkombëtare.
- Botime artikujsh në revista brenda dhe/ose botim artikujsh në revista me factor impact apo Scopus
- Organizimi i Konferencës Studentore, kryesisht me temat më të mira të punuara nga studentët.
- Realizimi i Panairit të Punës.
- Pjesmarrje në projekte, trainime brenda dhe jashtë vendit etj.
- Realizimi me sukses i procesit të akreditimit të tre programeve bachelor të ofruara nga FE.



UNIVERSITETI I SHKODRËS "LUIGJ GURAKUQI"
REKTORATI

**RAPORT VJETOR I VEPRIMTARISË SË UNIVERSITETIT
TË SHKODRËS "LUIGJ GURAKUQI"**
PËR VITIN AKADEMIK 2021-2022
(01 Tetor 2021 – 30 Shtator 2022)

BORDI I ADMINISTRIMIT

a) *Të dhëna të përgjithshme mbi IAL-në lidhur me strukturën e përgjithshme organizative të institucionit të arsimit të lartë, njësitë përbërëse dhe autoritetet drejtuese përkatëse etj.*

1. Të dhëna të përgjithshme mbi Universitetin e Shkodrës në lidhje me strukturën e përgjithshme organizative, njësitë përbërëse dhe autoritetet drejtuese përkatëse (Udhëzimi nr.5 dt. 19.02.2018 paragrafi B, pika a)

Universiteti i Shkodrës “Luigj Gurakuqi”, gjatë vitit akademik 2021–2022 ka operuar në zbatim të vendimit të Senatit Akademik nr.3 dt.11.01.2021 dhe vendimit të Bordit të Administrimit nr. 6 dt.12.01.2021.

“Për detajimin e grantit 2021 (grant i mësimdhënies)”, në zbatim të Udhëzimit të MASR nr. 27 datë 29.12.2017 “Për strukturat e brendshme akademike dhe administrative në institucionet publike të arsimit të lartë”

Universiteti i Shkodrës, gjatë vitit akademik 2021-2022 ka arritur numrin maksimal të punonjësve prej 313 vetash. Ky personel është i punësuar në Rektorat, dhe 6 Fakultetet përbërëse të UNISHK-së.

1.1. Rektorati i Universitetit të Shkodrës ka në përbërjen e tij: Rektorin, zv.rektorin dhe administratorin si autoritete drejtuese. Në këtë strukturë punojnë 66 punonjës administrativ të organizuar në drejtori/njësi dhe ku çdo drejtori ka në përbërje sektorë, si më poshtë:

- | | |
|---|--|
| 1.1.1. Drejtoria e Kurikulave Kërkimit shkencor dhe Standardeve | 1.1.4. Drejtoria e IT-së |
| - Sektori i kurikulave dhe kërkimit shkencor | - Sektori i menaxhimit të sistemit |
| - Sektori i sigurimit të cilësisë, këshillimit të karrierës dhe alumni. | - Sektori i zhvillimit dhe mirëmbajtjes IT |
| 1.1.2. Drejtoria e Bibliotekës Shkencore | 1.1.5. Drejtoria e Financës dhe Buxhetit |
| - Sektori bibliotekare-arkivist | - Sektori i financës dhe buxhetit |
| - Sektori i klasifikator-restaurator | 1.1.6. Drejtoria e Shërbimeve dhe Prokurimeve |
| 1.1.3. Drejtoria Juridike dhe Burimeve Njerëzore | - Sektori i prokurimeve |
| - Sektori Juridik | 1.1.7. Laboratori i diagnostikimit Mikrobiologjik |
| - Sektori i Protokoll Arkivës | 1.1.8. Sektori i Komunikimit, Marrëdhënieve me Jashtë dhe Projekteve |
| - Sektori i Burimeve Njerëzore | 1.1.9. Auditi i brendshëm |

1.2. Universiteti i Shkodrës “Luigj Gurakuqi” ka në përbërjen e tij 6 (gjashtë) fakultete të ndara në departamente/qendra kërkimore. Struktura organizative ka në përbërje personel akademik, ndihmësakademik me karakter mësimor/administrativ dhe personel administrativ. Fakultetet e



Universitetit të Shkodrës janë të organizuar në departamente dhe kanë në përbërje krahas personelit akademik edhe personel ndihmës akademikë/laborantë, të cilët ndihmojnë në realizimin dhe mbështetjen e veprimtarive të mësimdhënies. Pjesë përbërëse e strukturës së Fakultetit janë edhe sekretaritë mësimore. Njësitë bazë të secilit fakultet paraqiten:



1.2.1. Fakulteti i Shkencave të Natyrës:

- Departamenti i Biologji-Kimisë
- Departamenti i Fizikës
- Departamenti i Matematikë-Informatikë
- Departamenti i Infermierisë
- Qendra e Studimit të Ujrave

1.2.2. Fakulteti i Shkencave Shoqërore:

- Departamenti i Gjuhës Shqipe
- Departamenti Letërsisë
- Departamenti i Historisë
- Departamenti i Gjeografisë
- Qendra e Studimeve Albanologjike

1.2.3. Fakulteti i Shkencave të Edukimit:

- Departamenti i Mësuesisë
- Departamenti i Psikologjisë dhe Punës Sociale

- Departamenti i Edukimit Fizik dhe Sporteve

- Departamenti i Arteve

1.2.4. Fakulteti i Drejtësisë:

- Departamenti i të Drejtës Publike
- Departamenti i të Drejtës Civile
- Departamenti i të Drejtës Ndërkombëtare dhe Evropiane

1.2.5. Fakulteti Ekonomik:


- Departamenti i Administrim Biznesit
- Departamenti i Financë Kontabilitetit
- Departamenti i Turizmit

1.2.6 Fakulteti i Gjuhëve të Huaja

- Departamenti i Gjuhës Angleze
- Departamenti i Gjermanistikës
- Departamenti i Romanistikës

1.3. Autoritetet drejtuese të Universitetit të Shkodrës “Luigj Gurakuqi” janë:

- Rektori
- Administratori
- Drejtues të njësisë kryesore – Dekan fakulteti
- Drejtues të njësisë bazë: Drejtues departamenti, Drejtues drejtorie.



Fakultetet në vite

Numri i punonjësve në Universitetin e Shkodrës “Luigj Gurakuqi” për vitin 2021 u parashikua 344 personel akademik dhe joakademik (ndihmës akademikë me karakter mësimor-administrativ dhe personel administrativ).

Për periudhën janar–dhjetor të vitit 2021 kanë punuar 312 punonjës (numri maksimal i periudhës), nga të cilët 63% janë personel akademik dhe 37% janë personel ndihmësakademik dhe administrativ. Për më tepër detaje paraqesim të dhënat si më poshtë:

Numri maksimal i Viti 2021

| Emertimi | Gjithsej | Meshkuj | Femra | % që zënë femrat |
|----------------|----------|---------|-------|------------------|
| Gjithsej | 312 | 79 | 233 | 75% |
| Drejtues | 53 | 18 | 35 | 66% |
| Specialistë | 237 | 57 | 180 | 76% |
| Teknik i mesëm | 4 | 4 | | 0% |
| Punëtorë | 18 | | 18 | 100% |



Për periudhën janar–shtator të vitit 2022 kanë punuar 313 punonjës (numri maksimal i periudhës) nga të cilët 63% personel akademik dhe 37% personel ndihmësakademikë me karakter administrativ dhe punonjës administrativë. Paraqiten të dhëna si më poshtë:

Numri maksimal i Viti 2022

| Emertimi | Gjithsej | Meshkuj | Femra | % që zënë femrat |
|----------------|----------|---------|-------|------------------|
| Gjithsej | 313 | 82 | 231 | 74% |
| Drejtues | 51 | 18 | 33 | 65% |
| Specialistë | 240 | 60 | 180 | 75% |
| Teknik i mesëm | 4 | 4 | | 0% |
| Punëtorë | 18 | | 18 | 100% |

Për vitin akademik 2021 –2022 për periudhën janar–shtator 2022 nga personeli akademik 70 % janë me gradën Doktor ose titujt Profesor dhe Profesor i Asociuar, ndërsa 30 % me master.





Të dhëna të përgjithshme mbi: Ciklet e studimit, numri i studentëve, ngarkesa mësimore, shtrirja dhe mjediset


➤ **Ciklet e studimit, numri i studentëve.**

- **Ciklet e studimit**

Universiteti i Shkodrës për vitin akademik 2021–2022 kishte këto nivele e programe studimi me kohë të plotë:

- Cikli i parë i studimeve me 28 programe studimi.
- Cikli i dytë i studimeve me 37 programe studimi:
 - o Master profesional me 21 programe studimi,
 - o Master i shkencave me 16 programe studimi.
 - o 2 Programe Profesionale studimi

| Programe studimi në vitet 2017 - 2022 | | | | | | |
|---------------------------------------|---------------------|-------------|-------------|-------------|-------------|-------------|
| Nr | Emërtimi | Vitet | | | | |
| | | 2017 - 2018 | 2018 - 2019 | 2019 - 2020 | 2020 - 2021 | 2021 - 2022 |
| 1 | Bachelor | 26 | 26 | 26 | 27 | 28 |
| 2 | Program Profesional | 0 | 0 | 0 | 2 | 2 |
| 4 | Master Profesional | 19 | 20 | 20 | 20 | 21 |
| 6 | Master Shkencor | 16 | 16 | 16 | 16 | 16 |
| | | 61 | 62 | 62 | 65 | 67 |



- Numri i studentëve


Në Universitetin e Shkodrës për vitin akademik 2021–2022 kanë studiuar në të gjithë nivelet e studimeve **3,718** studentë:

- ◊ Në Ciklin e parë të studimit Bachelor kanë studiuar **2,578** studentë.
- ◊ Në Programet profesionale kanë studiuar **75** studentë.
- ◊ Në Ciklin e dytë të studimit kanë studiuar **1,065** studentë nga të cilët:
 - Master profesional kanë studiuar **655** studentë,
 - Master i shkencave kanë studiuar **410** studentë

Studentët sipas ndryshimeve në sistemet dhe ciklet e shkollimit

| Nr. | Sistemi shkollimit | vitet | | | | |
|-----|--------------------|--------------|--------------|--------------|--------------|--------------|
| | | 2017-2018 | 2018-2019 | 2019-2020 | 2020-2021 | 2021-2022 |
| A | Cikli i parë | 5,385 | 3,759 | 3,022 | 2,803 | 2,653 |
| | - Bachelor | 5,385 | 3,759 | 3,022 | 2,764 | 2,578 |
| | - Profesionale | - | - | - | 39 | 75 |
| B | Cikli i dytë | 1,228 | 1,265 | 1,237 | 1,134 | 1,065 |
| | 1 MP | 824 | 907 | 839 | 720 | 655 |
| | 2 MSH | 404 | 358 | 398 | 414 | 410 |
| | Totali | 6,613 | 5,024 | 4,259 | 3,937 | 3,718 |

Numri i studentëve sipas viteve



- b) *Të dhëna për planin buxhetor afatmesëm, planin buxhetor njëvjeçar dhe planin strategjik të zhvillimit të institucionit. (Udhëzimi nr. 5, dt 19.02.2018, paragrafi B, pika b)*

1. Projekt Buxheti afatmesëm vitet 2023-2025

Hartimi i p/buxhetit 2023-2025 është bazuar në projektet e paraqitura deri në momentin e hartimit të tij, në ecurinë e realizimit të pritshëm të buxhetit për vitin 2022, Strategjinë e Zhvillimit të Universitetit të Shkodrës dhe në ndryshimet në: strukturën organizative dhe numrin e punonjësve, programet e studimit, numrit të studentëve të pritshëm, në nivelin e financimit nga Buxheti i Shtetit. Nga strukturat bazë të Universitetit janë paraqitur kërkesa për projektet afatmesme 2023 – 2025, si për procesin e veprimtarisë kryesore të këtyre njësive edhe për atë kërkimore e shkencore, në përputhje me Strategjinë Kombëtare të Zhvillimit të Arsimit të Lartë.

Financimi i p/buxhetit për vitet 2023 – 2025 nga të hyrat paraqitet si më poshtë:

:

Granti (Fonde të pakushtëzuara) për vitin 2023 - 2025

| Nr | Emërtimi i projektit | 2023 000/lekë | 2024 000/lekë | 2025 000/lekë |
|---------------|--|----------------|----------------|----------------|
| 1 | Grante për shpenzime korente dhe Transfera | 552,844 | 569,430 | 586,513 |
| 2 | Grante për investime | 20,209 | 20,209 | |
| 3 | Kërkim shkencor | 13,664 | 14,074 | 14,496 |
| 4 | TVSH-projekte të huaja | 0 | 0 | 0 |
| TOTALI | | 586,717 | 603,713 | 601,009 |

Të ardhura të institucionit për vitin 2023 - 2025

| Nr | Emërtimi i projektit | 2023 000/lekë | 2024 000/lekë | 2025 000/lekë |
|---------------|--|----------------|----------------|----------------|
| 1 | Fondet nga të ardhurat për shpenzime korente | 105,709 | 105,709 | 105,709 |
| 2 | Fonde nga të ardhurat për investime | 244,404 | 128,969 | 115,037 |
| TOTALI | | 350,113 | 234,678 | 220,746 |

Planifikimi në këto nivele do të mundësojë përbalimin e shpenzimeve në rritje në disa zëra, si: energji, ujë, telefon; në shërbimet që dalin të detyruara, si p.sh. shpenzimet për rojet private, shpenzimet për internetin si dhe shpenzime për mirëmbajtje. Vënia në punë e ngrohjes qendrore në tërë godinat do të paraqesë nevojën për shpenzime për lëndë djegëse. Ndarjen për çdo artikull e kemi llogaritur duke u nisur nga fakti i artikujve të vitit të kaluar, nga realizimi i pritshëm i këtij viti, si dhe nga kërkesat për disa lloj shpenzimesh.



(000/Lekë)

| Artikulli | Emertimi | Parashikimi për vitin 2023 | | | 2024 | 2025 |
|-----------|--|----------------------------|---------------|-----------------|----------------|----------------|
| | | Limiti | Kerkesa | Nga te ardhurat | Kerkesa | Kerkesa |
| 602.0 | Materiale zyre dhe te pergjithshme | 7,700 | 2,600 | 5,100 | 8,085 | 8,489 |
| 602.1 | Materiale dhe sherbime speciale | 5,620 | 0 | 5,620 | 5,901 | 6,196 |
| 602.2 | Sherbime nga te trete | 80,528 | 71,648 | 8,880 | 71,954 | 75,552 |
| 602.3 | Shpenzime transporti | 360 | 0 | 360 | 504 | 529 |
| 602.4 | Shpenzime udhetimi | 11,400 | 5,000 | 6,400 | 11,970 | 12,569 |
| 602.5 | Shpenzime per mirembajtje te zakonshme | 23,920 | 5,000 | 18,920 | 25,116 | 26,372 |
| 602.6 | Shpenzime per qeramarrje | 0 | 0 | 0 | 0 | 0 |
| 602.7 | Shpenzime per detyrime dhe kompensime legale | 0 | 0 | 0 | 0 | 0 |
| 602.8 | Shpenzime te lidhura me huamarrjen per hua | 0 | 0 | 0 | 0 | 0 |
| 602.9 | Shpenzime te tjera operative | 20,480 | 14,200 | 6,280 | 21,504 | 22,579 |
| | Totali | 150,008 | 98,448 | 51,560 | 145,034 | 152,286 |

➤ **Për artikullin investime Art. 230/231**

Investimet kryhen nga Universiteti duke i përballuar me fonde, të cilat financohen në formën e:

- Investimeve nga të ardhurat e vetë institucionit.
Investimet për vitin e parë 2023 planifikohen kryesisht:
 - "Rikonstrukcion godia e Rektoratit" është parashikuar nga të ardhurat e Institucionit në vlerën 99,537 mijë lekë.
 - "Rikonstrukcion, supervizion dhe kolaudim ctia e FSHE" nga të ardhurat e Universitetit në vlerën 14,319 mijë lekë.
 - "Sistemi i mbrojtjes nga zjarri" nga buxheti i shtetit në vlerën 20,209 mijë lekë.
 - "Supervizion, Rikonstrukcion dhe kolaudim i përshtatjes së godinave për studentët me aftësi ndryshe" nga të ardhurat e Institucionit në vlerën 20,250 mijë lekë"

Projektet shkencore, megjithëse paraqiten si investime për efekt të kërkesave të plotësimit të formularit zyrtar, një pjesë të kostove kostot i kanë të inkuorpuara tek zëra si psh 600 dhe 602. Tek zëri pajisjet elektronike përfshihen edhe pajisjet elektronike për instalimin e sistemeve elektronike në auditorët e Universitetit.



| Emertimi i projektit të investimit | Vlera e plote e projektit | Fakt vitit 2022 | | Parashiki mi per vitin 2023 | Parashiki mi per vitin 2024 | Parashiki mi per vitin 2025 |
|---|---------------------------|-----------------|-----------|-----------------------------|-----------------------------|-----------------------------|
| | | Plani | Realizuar | | | |
| Pajisje elektronike | 81,443 | 22,601 | | 38,842 | 10,000 | 10,000 |
| Sistemi i mbrojtjes nga zjarrit. | 40,418 | | | 20,209 | 20,209 | |
| Rikonstruksion godina e rektoratit | 298,611 | | | 99,537 | 99,537 | 99,537 |
| Mbikqyrje punimesh rikonstruksion godina e rektoratit | 1,000 | | | 1,000 | | |
| Kolaudim punimesh rikonstruksion godina e rektoratit | 500 | | | | | 500 |
| Pajisje per inventar ekonomik | 15,156 | 4,156 | | 5,000 | 3,000 | 3,000 |
| Furnizim vendosje kondicionere | 10,200 | 3,200 | | 3,000 | 2,000 | 2,000 |
| Libra per Artet+sportet+biblioteken | 6,300 | 2,300 | | 4,000 | | |
| Laboratori virtual në web | 5,486 | | | 5,486 | | |
| Rritja e kapaciteteve "Remote sensing" në vendin tonë, investigimi i depozitimit të pluhurave minerale mbi bazenin e Liqenit të Shkodrës. | 5,370 | | | 5,370 | | |
| Ambjente te hapura wireless | 1,000 | | | 1,000 | | |
| Instalim i sistemeve elektronike ne auditoret e Universitetit | 9,330 | | | 9,330 | | |
| Brava elektronike Fakulteti I Drejtesise | 600 | 600 | | | | |
| TVSH MARDS materiale promovuese | 125 | 125 | | | | |
| TVSH VALEU X, pajisje elektronike dhe elektrike | 88 | 88 | | | | |
| TVSH REACH, materiale promovuese | 63 | 63 | | | | |
| TVSH SUCCESS blerje pajisje | 713 | 713 | | | | |
| TVSH Entral blerje pajisje elektronike dhe elektrike | 350 | 350 | | | | |
| TVSH Entral materiale promovuese | 60 | 60 | | | | |
| TVSH IDEA blerje pajisje elektronike dhe elektrike | 700 | 700 | | | | |
| TVSH IDEA materiale promovuese | 25 | 25 | | | | |
| TVSH STEAM blerje pajisje elektronike dhe elektrike | 488 | 488 | | | | |
| TVSH STEAM materiale promovuese | 100 | 100 | | | | |
| TVSH USA materiale promovuese | 25 | 25 | | | | |
| TVSH projekti REACH pajisje | 1,375 | 1,375 | | | | |
| TVSH Projekti Success | 695 | | | 695 | | |
| TVSH Projekti Entral | 429 | | | 429 | | |
| TVSH Projekti IDEA | 732 | | | 732 | | |
| TVSH Projekti STEAM | 610 | | | 610 | | |
| Pajisje Projekti REACH qe do te mbulohen nga UNISHK | 300 | 300 | | | | |
| Krijimi i laboratorit dixhital të anatomisë | 14,490 | 14,490 | | | | |
| Projekti i catise se FSHE | 562 | 562 | | | | |
| Supervizion rikonstruksion catia FSHE | 291 | | | 291 | | |
| Rikonstruksion catia e FSHE | 14,000 | | | 14,000 | | |
| Kolaudim catia e FSHE | 28 | | | 28 | | |
| Projekti Kampusi i Universitetit | 2,000 | | | 2,000 | | |
| Projekti per pershtatjen e godinave per personat me aftesi ndryshe | 500 | 500 | | | | |
| Rikonstruksion per pershtatjen e godinave per studentet me aftesi ndrysh | 20,000 | | | 20,000 | | |
| Supervizim rikonstruksionit te ambjeteve per studentet me aftesi ndrysh | 200 | | | 200 | | |
| Kolaudim rikonstruksionit te ambjeteve per studentet me aftesi ndryshe | 50 | | | 50 | | |
| Supervizim ndricim te objekteve dhe tabelave emertuese te ndertesave | 252 | | | 0 | 252 | |
| Investim per ndricim te objekteve dhe tabelave emertuese te ndertesave | 14,153 | | | 0 | 14,153 | |
| Kolaudim ndricim te objekteve dhe tabelave emertuese te ndertesave | 27 | | | 0 | 27 | |
| Blerje automjeti autobus | 8,000 | | | 8,000 | | |
| Laboratori i programit dyvjecar SRRK | 5,991 | 5,991 | | | | |
| Salla e Senatit instalim I pajisjeve elektronike | 8,334 | 8,334 | | | | |
| Salla Nr 3 instalim I pajisjeve elektronike | 4,440 | 4,440 | | | | |
| Laboratori i Muzikes | 3,203 | 3,203 | | | | |
| Laboratori i Multimedias | 1,920 | 1,920 | | | | |
| Digitalizimi i shtypshkronjes | 15,000 | 15,000 | | | | |
| Pajisje Laboratori SURSH | 500 | 500 | | | | |
| Departamenti i historise Korniza | 100 | 100 | | | | |
| Infermiera stenda | 48 | 48 | | | | |
| 10 aparate tensioni | 30 | 30 | | | | |
| Organo elektrike artet | 100 | 100 | | | | |
| Pajisje Laboratori Zoologjia | 1,500 | 1,500 | | | | |
| Pajisje Laboratori Grafika sistem aspirimi+instalime elektrike dhe ndricim | 160 | 160 | | | | |
| Pajisje Laboratori Grafika platforme fshirje dhe tharesë-furre me termos | 170 | 170 | | | | |
| Pajisje laboratori I fizioterapise | 573 | 573 | | | | |
| Furnzim Vendosje Perde | 1,700 | 1,700 | | | | |
| Laboratori i Ushqimit dhe pjese Fakulteti Ekonomik | 13,307 | 13,307 | | | | |
| Laboratori i analizave te ushqimeve* | 5,000 | 5,000 | | | | |
| Pajisje Sportive Dep Edukimit Fizik | 1,200 | | | 1,200 | | |
| Salla multimediale Departamenti i Biologji Kimise | 2,720 | | | 2,720 | | |
| Projekt Shkencor Fakulteti I Shkencave te Natyres | | | | 19,750 | | |
| Projekt Shkencor Fakulteti Ekonomik | | | | 2,473 | | |
| Projekt Shkencor Fakulteti I Shkencave shoqerore | | | | 2,660 | | |
| | | 114,895 | | 20,209 | 20,209 | 0 |
| | | | | 248,404 | 128,969 | 115,037 |



Në kuadrin e Strategjisë së Universitetit ku është parashikuar dhe ndërtimi i një kampusi, janë parashikuar edhe 2 milionë lekë për projektimin e kampusit.

c) *Realizimi faktik i planit buxhetor të vitit paraardhës buxhetor sipas zërave të buxhetit, planit buxhetor të vitit pasardhës akademik, si dhe tarifat e shkollimit për vitin akademik në vijim.*

1. Realizimi i buxhetit viti 2021

1. Për vitin 2021 buxheti i akorduar e i çelur është në vlerën **704,434** mijë lekë, i cili vjen nga akordimet e fondeve në fillim të vitit. Detajimi sipas formës së financimit paraqitet:

| Fonde të mbartura, financim grante për vitin 2021-Fakti | | | | 000/lekë |
|---|---|-----------------------|---------------------|-------------------|
| Nr | Emërtimi i projektit | Mbartur nga viti 2020 | Financimi viti 2021 | Buxheti viti 2021 |
| 1 | Financime nga Buxheti i Shtetit (Grante e transferta) | 175,693 | 528,742 | 704,434 |
| TOTALI | | 175,693 | 528,742 | 704,434 |

1.1. Hyrjet e fondeve

Hyrjet e fondeve për Universitetin për vitin 2021 përveç akordimeve nga Buxheti i Shtetit janë dhe të ardhurat që sigurohen nga arkëtimet që paguajnë studentët, shërbimet ndaj të tretëve dhe disbursimet nga financimet e huaja.

Fondet e kushtëzuara – të ardhurat e USH - së: Të ardhurat e disponueshme janë realizuar në vlerën 115,694 mijë lekë ose 69.² % të krahasuara me planin vjetor të tyre.

| Të Ardhurat për 12- mujorin viti 2021 - fakti | | | | |
|---|----------------------------|----------------|----------------|-------------|
| Krijimi | | | | |
| Nr | Emërtimi | Plan | Fakt | % |
| A | Të ardhura të vitit | 165,585 | 115,694 | 69.9 |
| 1 | Qira | 0 | 197 | 0 |
| 2 | Tarifa shkollimi | 142,241 | 94,484 | 66.4 |
| 3 | Lëshim dokumenti | 16,000 | 15,975 | 99.8 |
| 4 | Taksë regjstrimi | 6,594 | 3,256 | 49.4 |
| 5 | Tarifa konkurimi | 750 | 180 | 24 |
| 6 | Tjera - shërbime Analiza | 0 | 1,482 | 0 |
| 7 | Sponsorizime | 0 | 120 | 0 |


Plani i grumbullimit të të ardhurave dhe fakti i realizimit të tyre për vitin 2021 u bazua në:

- programet e studimit të ciklit të parë (Bachelor),
- programet e studimit të ciklit të dytë (MP e MSH),
- numrin e studentëve për çdo program studimi,



- nivelin e tarifave të vendosura me Vendim të Bordit të Administrimit për çdo program studimi, sipas tavaneve të vendosura me VKM-t për çdo rast.
- Realizimi është rezultat i grumbullimit i një pjese të tarifave të shkollimit të planifikuara për vitin 2021 në tetor–dhjetor 2020. Një pjesë e këtyre të ardhurave janë përdorur për shpenzimet e planifikuara për tu realizuar në vitin 2020. Pjesa e papërdorur ka kaluar si të ardhura të trashëguara për vitin 2021.

Grumbullimi i të ardhurave gjatë periudhës janar – dhjetor 2021 është ndjekur në mënyrë të vazhdueshme.



Grupimet më kryesore të të ardhurave në % ndaj totalit të ardhura:

- Tarifa shkollimi 81.⁸⁰ %
- Tarifa regjistrimi 2.⁸⁰ %
- Tarifa konkurrimi 0.²⁰ %
- Të ardhura Qira 0.²⁰ %
- Të tjera 15.¹⁰ %

- Numri i rasteve të përjashtimeve nga pagesa e tarifës së shkollimit për Ciklin e parë të studimeve dhe ulja e tarifës së shkollimit për ciklin e dytë të studimeve, në zbatim të VKM s dhe Vendimeve të BA – së. Nga zbatimi i këtyre akteve një pjesë e konsiderueshme e studentëve përfitojnë nga përjashtimi i pagesës të plotë të tarifës së shkollimit.
- Sipas aplikimeve të kryera nga studentët për këtë qëllim përfitimi i tyre është 56,838 mijë lekë sipas tabelës së mëposhtme
- Mosshlyerja në kohë e detyrimeve të tarifave të shkollimit nga një pjesë e studentëve.
- Numri i ulët i regjistrimeve në disa programe studimi. Për këto programe ishte planifikuar realizimi i të ardhurave sipas kuotave të planifikuara për secilin prej tyre.

1.2. Shpenzimet

Plan buxheti i çelur për përdorim (Plan Thesari) ka vlerën 791,551 mijë lekë dhe është realizuar financiarisht në vlerën **592,807 mijë lekë**, ose 74.9%

Tabela Përmbledhëse sipas kategorive të shpenzimeve dhe realizimit financiar si më poshtë:

| Realizimi viti 2021 000/lekë | | | | | | | | | | |
|------------------------------|---------------------|----------------|----------------|-------------|---------------|---------------|-------------|----------------|----------------|-------------|
| llog | Pershkrimi | Granti | | | Të ardhura | | | USH | | |
| | | Plan | Realizimi | % | Plan | Realizimi | % | Plan | Realizimi | % |
| 600 | Paga | 493,136 | 365,675 | 74.2 | 0 | 0 | 0.0 | 493,136 | 365,675 | 74.2 |
| 601 | Sigurime | 75,954 | 57,743 | 76.0 | 0 | 0 | 0.0 | 75,954 | 57,743 | 76.0 |
| 602 | Shpenzime operative | 64,892 | 46,879 | 72.2 | 37,674 | 20,118 | 53.4 | 102,566 | 66,996 | 65.3 |
| 606 | Bursa Studentëve | 65,461 | 63,495 | 97.0 | 0 | 0 | 0.0 | 65,461 | 63,495 | 97.0 |
| 231 | Investime | 0 | 0 | 0.0 | 54,433 | 38,899 | 71.5 | 54,433 | 38,899 | 71.5 |
| TOTALI | | 699,443 | 533,791 | 76.3 | 92,107 | 59,016 | 64.1 | 791,551 | 592,807 | 74.9 |

Sipas burimeve të financimit



- Buxheti i brendshëm (Granti konkurrues-investime nga buxheti, kërkimi shkencor nga buxheti-AKKSHI) dhe Grantet për shpenzime korrente e bursat e studentëve në vlerën 76.3%
- Të ardhura të institucionit (të vitit dhe të trashëguara nga vitet e mëparëshme) të në vlerën 64.1 %.

➤ **Paga e shpërblime – Artikulli 600**

Pagat për periudhën janar-dhjetor 2021 janë mbuluar me fondet nga Granti për shpenzime korrente. Plani vjetor i pagave është në vlerën 493,136,104 lekë, ndërsa realizimi në nivelin 365,674,588 lekë ose 74.2%.

➤ **Fondi i sigurimeve shoqërore e shëndetësore – Artikulli 601**

Fondi për sigurime shoqërore është shpenzuar për likuidimin e detyrimeve që institucioni ka ndaj Degës së Sigurimeve Shoqërore, si kontribut për punonjësit e vet. Ky zë është planifikuar në vlerën 75,954,489 lekë dhe është realizuar në vlerën 57,742,616 lekë ose 76.0%.

➤ **Shpenzime operative – Artikulli 602**

Për vitin 2021 shpenzimet operative janë parashikuar të përballohen nga granti për shpenzime korrente dhe nga të ardhurat. Këto shpenzime janë realizuar financiarisht për periudhën janar-Dhjetor 2021 në masën 65.3% e fondit të çelur për këtë qëllim: nga granti 72.2 % dhe nga të ardhurat 53.4% e planit vjetor. Shpenzimet operative për vitin 2021, janë realizuar kryesisht për: ruajtjen e godinave, elektricitet, taksa e tarifa te insitucionit etj. Në lidhje me realizimin financiar sqarojmë:

- ◊ Shërbimi i ngrohjes (blerje gazoil), është nënshkruar kontrata në vlerën e plotë 7,500,000 lekë. Eshtë likuiduar brenda vitit 2021 vlere prej 1,747,875 lekë. Realizimi i plotë është finalizur me datë 02 Mars kur është likuiduar edhe fatura e fundit.
- ◊ Zëri “Shpenzime për taksa dhe tarifa të paguara nga institucioni” është buxhetuar në vlerën 13,000,000 lekë dhe janë paguar 2,734,791 lekë. Kjo për arsye se nuk është vijuar me akreditimin e programeve që parashikohej spas shkresës nr 134 Prot, dt 18.01.2021.
- ◊ Shpenzime për kërkimin shkencor në vlerën 6,000,000 lekë është realizuar në vlerën 485,846 Lekë. Do të vijohet me realizimin e rimbursimeve për faturat që vijnë në vijim bazuar në raportet e grupit të punës.
- ◊ Për energji elektrike janë planifikuar 8,000,000 lekë dhe janë paguar 6,411,026 lekë.
- ◊ Për ujin janë planifikuar 3,877,000 Lekë dhe janë paguar 800,340 Lekë.
- ◊ Me buxhetin e vitit 2021 ishte parashikuar edhe shërbimi i ruajtjes për 01 Janar deri 14 Prill 2022 në vlerën 7,864,106 lekë. Në fakt kontrata u bë me vit kalendarik deri me 31 dhjetor.



- ◇ Udhëtime e dieta janë planifikuar 5,200,000 Lekë dhe janë paguar 1,004,290 lekë, sepse praktikat mësimore janë realizuar me itinerar të cunguar dhe pa fjetje.
 - ◇ Udhëtime jashtë shtetit CEEPUS, janë planifikuar 1,000,000 lekë dhe janë paguar 22,355 lekë, sepse nuk janë realizuar për shkak të pandemisë COVID 19.
 - ◇ Materiale për pastrim ,dezinfektim, ngrohje dhe ndricim janë planifikuar 960,000 lekë por nuk ka qenë e nevojshme të realizohen pasi ka patur gjendje në magazinë.
 - ◇ Kanelaria është planifikuar 3,000,000 por për shkak të uljes së fondit limit është realizuar në vlerën 1,686,140 lekë.
- Më poshtë, tabelat e realizimit financiar dhe realizimit së bashku me kontratat e nënshkruara për shpenzimet operative.

| Kodi i Llogarisë | Emërtimi | Parashikimi viti 2021 | Realizimi |
|------------------|---|-----------------------|----------------------|
| 6020 | Materiale zyre dhe të përgjithshme | 5,838,600 | 2,294,718.00 |
| 6020100 | Kancelari | 3,000,000 | 1,686,140.00 |
| 6020200 | Materiale për pastrim, dezinfektim, ngrohje dhe ndricim | 960,000 | - |
| 6020300 | Materiale për funksionimin e pajisjeve të zyrës | 466,600 | 12,000.00 |
| 6020400 | Materiale për funksionimin e pajisjeve speciale | 120,000 | 100,000.00 |
| 6020500 | Blerje dokumentacioni | 332,000 | - |
| 6020900 | Furnizime dhe materiale të tjera zyre dhe të përgjithshme | 960,000 | 496,578.00 |
| 6021 | Materiale dhe shërbime speciale | 2,810,000 | 949,537.00 |
| 6021003 | Ilaçe, materiale dhe proteza mjekësore | 120,000 | 14,040.00 |
| 6021007 | Libra dhe publikime profesionale | 650,000 | - |
| 6021009 | Materiale dhe pajisje laboratorike të shërbimit publik | 960,000 | 190,560.00 |
| 6021010 | Shpenzime për prodhim dokumentacioni specifik | 960,000 | 704,537.00 |
| 6021099 | Të tjera materiale dhe shërbime speciale | 120,000 | 40,400.00 |
| 6022 | Sherbime nga të tretë | 47,914,131 | 34,976,131.00 |
| 6022001 | Elektricitet | 8,000,000 | 6,411,026.00 |
| 6022002 | Ujë | 3,877,000 | 800,340.00 |
| 6022003 | Shërbime telefonike Telefoni Celulare | 400,000 | 316,736.00 |
| 6022004 | Posta dhe shërbimi korrier | 200,000 | 152,495.00 |
| Kodi i Llogarisë | Emërtimi | Parashikimi viti 2021 | Realizimi |
| 6022005 | Shërbim për ngrohje | 7,500,000 | 1,747,875.00 |
| 6022008 | Sherbime të sigurimit dhe ruajtjes viti 2021 | 19,473,025 | 25,093,414.00 |
| 6022008 | Sherbime të sigurimit dhe ruajtjes viti 2022 | 7,864,106 | - |
| 6022009 | Sherbime të pastrimit dhe gjelbërimit | 480,000 | 429,589.00 |
| 6022010 | Sherbime të printimit dhe publikimit | 120,000 | 24,656.00 |
| 6023 | Shpenzime transporti | 240,000 | 218,103.00 |
| 6023300 | Shpenzimet e siguracionit të mjeteve të transportit | 120,000 | 164,103.00 |
| 6023900 | Shpenzime të tjera transporti | 120,000 | 54,000.00 |
| 6024 | Shpenzime udhëtimi | 6,200,000 | 1,026,645.00 |
| 6024100 | Udhëtim i brendshëm e dieta | 5,200,000 | 1,004,290.00 |
| 6024200 | Udhëtim jashtë shtetit+ceepus | 1,000,000 | 22,355.00 |
| 6025 | Shpenzime për mirëmbajtje të zakonshme | 18,803,526 | 18,061,932.00 |
| 6025200 | Shpenzime për mirëmbajtjen e objekteve specifike | 960,000 | 778,080.00 |
| 6025300 | Shpenzime për mirëmbajtjen e objekteve ndërtimore | 17,499,526 | 16,995,852.00 |
| 6025500 | Shpenzime për mirëmbajtjen e ashensorit | 144,000 | 134,400.00 |
| 6025600 | Shpenzime për mirëmbajtjen e mjeteve të transportit | 200,000 | 153,600.00 |
| 6029 | Shpenzime të tjera operative | 20,760,000 | 9,469,354.00 |
| 6029001 | Shpenzime për pritje e percjellje | 480,000 | 221,000.00 |
| 6029002 | Shpenzime për aktivitete sociale për personelin | 480,000 | - |
| 6029003 | Shpenzime gjyqësore | 100,000 | 84,300.00 |
| 6029004 | Shpenzime për sigurimin e ndërtesave dhe të tjera | 700,000 | 580,000.00 |
| 6029005 | Shpenzime për honorare | 0 | 5,363,417.00 |
| 6029006 | Shpenzime kompesimi për anëtarët e zgjedhur | 0 | - |
| 6029007 | Shpenzime për pjesëmarrje në konferenca (kërkim shkencor) | 6,000,000 | 485,846.00 |



| | | | |
|---------|--|--------------------|----------------------|
| 6029008 | Shpenzime për tatime & taksa të paguara nga institucioni | 13,000,000 | 2,734,791.00 |
| | Totali | 102,566,257 | 66,996,420.00 |

➤ **Bursat e studentëve – Artikulli 606**

Realizimi i këtij zëri është në vlerën 63,494,997 lekë nga 65,385,740 të miratuara.

Për vitin akademik 2021 – 2022, këto fonde ndahen:

Kanë përfituar bursa 634 studentë sipas VKM -së nr.903, dt.21.12.2016 “Për përcaktimin e kriterëve për përfitimin e bursave nga fondi i mbështetjes studentore, për studentët e shkëlqyer, studentët që studiojnë në programe studimi në fushat prioritare dhe studentët në nevojë (i ndryshuar). Keto bursa janë miratuar me vendimet e BA si dhe me vendimet e këshillave bashkiakë sa i takon studentëve të viteve të para:

Efekti Financiar 57 060 000 lekë

Numri total i studentëve 634

Studentë Ekselence 192

Studentë nga kategoria sociale 442

Numri i studentëve që përfitojnë nga ulja apo reduktimi me 50% i tarifës vjetore të shkollimit për vitin akademik 2021-2022, në zbatim të Vendimit nr. 778, datë 26.12.2018 të Këshillit të Ministrave “Për një ndryshim dhe shtesë në Vendimin nr.288, datë 21.5.2018 të Këshillit të Ministrave “Për miratimin e kufirit maksimal të tarifës vjetore të shkollimit për studentët që ndjekin studimet në institucionet publike të arsimit të lartë, në një program të ciklit të parë të studimeve, në një program të integruar të studimeve ose në një program të studimeve profesionale me kohë të plotë”, i ndryshuar; numrin e studentëve përfitues për çdo njësi, si dhe efektet financiare të parashikuara miratuar me vendimet e BA është 1,568 studentë. Për një total 17,350,000 lek.

Numri i studentëve që ndjekin studimet në institucionet publike të arsimit të lartë, në një program të ciklit të dytë të studimeve, që përfitojnë reduktim me 50%, të të tarifës vjetore të studimit. Studentët , sipas kategorive, sipas Vendimit nr. 780, datë 26.12.2018 të Këshillit të Ministrave "Për përcaktimin e kategorive të individëve që plotësojnë kriteret për ulje të tarifës vjetore të studimit në programet e ciklit të dytë të studimeve, në institucionet publike të arsimit të lartë", paguajnë 50% të tarifës vjetore të studimeve të miratuar nga institucionet publike të arsimit të lartë, është 201 studentë me efekt financiar 6,633,000 lekë.



Numri i studenteve që përjashtohen nga tarifa vjetore e shkollimit (për vitin akademik 2021-2022) sipas VKM nr. 269, datë 29.03.2017, i ndryshuar me VKM nr 40 date 23.01.2019 është 685 studentë me efekt financiar 15,412,500 lekë.

| NR | Elekete Vendeve te Kerkimit te Ministrave "Per studente teq perfitojne bursa financiare , perjashtim njo reduktim ang tarifa vjetore e shkollimit per vitin akade mik 2021-2022, sipas VKM si me poshte | Total Nr studente | Total efekti financiar (viti akademik 2021-2022) | Numri i studenteve te noten mesatare % 10, qe perfitojne bursa financiare-perjashtim nga tarifa vjetore e shkollimit. (Viti akademik 2021-2022) | Elekti financiar per studentet me note mesatare 9-10,bursa- tarifa vjetore e shkollimit. | Numri i studenteve nga kategorite sociale ne nevojë qe perfitojne bursat- tarifa vjetore e shkollimit. | Elekti financiar ga kategorite sociale ne nevojë qe perfitojne bursat- tarifa vjetore e shkollimit. (Viti akademik 2021-2022) |
|-------------|--|-------------------|--|---|--|--|---|
| | | A+C+E | B+D+F | C | D | E | F |
| a 1 bursat | Studenti që përfitojnë bursa financiare sipas VKM nr. 903, datë 21.12.2016, i ndryshuar me VKM nr. 39, datë 23.1.2019. Me Vendum BA | 634 | 57,060,000 | 192 | 17,280,000 | 442 | 39,780,000 |
| a 2 bursat | Studenti që përfitojnë bursa financiare sipas VKM nr. 903, datë 21.12.2016, i ndryshuar me VKM nr. 39, datë 23.1.2019, që kanë paraqitur kërkesë në plotësinë të kërkesëve, në pritje të konfirmimeve nga institucionet përkatëse për të përfituar bursa financiare | 10 | 900,000 | 0 | 0 | 10 | 900,000 |
| | Total Bursat 2021-2022, a1+a2 | 644 | 57,960,000 | 192 | 17,280,000 | 452 | 40,680,000 |
| b 1 tarifit | Numri i studenteve që përfitojnë nga ulësimi i tarifës vjetore të shkollimit për vitin akademik 2021-2022 sipas VKM nr. 289 datë 21.05.2018, i ndryshuar (Çkë i pare i studimeve), viti i parë, i regjistruar 2021-2022 | 848 | 9,390,000 | 848 | 9,390,000 | 0 | 0 |
| b 2 tarifit | Numri i studenteve që përfitojnë nga ulësimi i tarifës vjetore të shkollimit për vitin akademik 2021-2022 sipas VKM nr. 288 datë 21.05.2018, i ndryshuar (Çkë i pare i studimeve), viti i dytë e viti tretë me mesatare mbi 6 | 720 | 7,960,000 | 720 | 7,960,000 | 0 | 0 |
| | Total b1+b2 | 1,568 | 17,350,000 | 1,568 | 17,350,000 | 0 | 0 |
| b 3 tarifit | Numri i studenteve që përjashtohen nga tarifa vjetore e shkollimit (për vitin akademik 2021-2022) sipas VKM nr. 269, datë 29.03.2017, i ndryshuar me VKM nr 40 date 23.01.2019 Me Vendum BA | 685 | 15,412,500 | 192 | 4,320,000 | 493 | 11,092,500 |
